



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

**RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM**

**Programi i Studimit të Ciklit të Dytë Master Profesional në “Mësuesi në  
Arte”**

**ofruar nga**

**Universiteti “Barleti”**

**Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:**

Prof Asoc Nada Kallciu

Prof Asoc Dorian Cene

Nëntor, 2024

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

1

## RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

### Për Programin e studimit Master Profesional në “Mësuesi në Arte” ofruar nga Universiteti “Barleti”

Nr.		
1	IAL aplikues:	Universiteti “Barleti”
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Shkencave të Edukimit dhe Trajnimit Profesional
3	Emërtimi i programit të studimit:	Master Profesional në “Mësuesi në Arte “
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	UAMS, nr. 505, datë 06.09.2022.
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	-
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	-
8	Cikli i studimit:	Cikli i dytë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	2 vite akademike
10	Kreditet në total (ECTS):	120 kredite (ECTS)
11	Forma e studimit:	Kohë e plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Gjuha Shqipe
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 7 (Shtatë)
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	v.a 2022-2023:6 PAE/ 0 PAK v.a 2023-2024: 6 PAE/ 2 PAK
18	Numri i studentëve:	v.a 2022-2023:7 studentë v.a 2023-2024:2 studentë
19	Komente / të tjera:	-

## **PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM**

Programi i studimit “Master Profesional” në “Mësues në Arte” është hapur me Urdhër Ministri Nr Prot, Nr. 505, datë 06.09.2022 dhe ofrohet nga Departamenti i Shkencave të Edukimit dhe Trajnimit profesional, Fakulteti i Shkencave Sociale, Turizmit dhe Sportit në Univeristetin “Barleti”.

Njësia bazë e Departamentit të Shkencave të Edukimit dhe Trajnimit Profesional funksion në strukturën organizative të fakultetit të shkencave Sociale, Turizmit dhe Sportit, të krijuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 571, datë 12.08.2005. Programi i ofruar është i organizuar sipas nivelit 7 të kornizës Shqiptare të Kualifikimeve, forma e studimeve është me kohë të plotë me një kohëzgjatje të studimeve në 2 (dy) vite akademike, përgjatë të cilave studenti fiton 120 ECTS. Programi i studimit është organizuar në dy vite me nga 60 kredite në secilin vit, përkatësisht 1500 orë mësimore të organizuara në modalitetet e verpimtarive të pavarura dhe veprimtarive në auditor.

Ky program studimi ofrohet në gjuhën shqipe dhe është i organizuar në lëndë dhe module lëndore sipas tipeve të veprimtarive formuese të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendas dhe Sistemin Europian të transferimit dhe të grumbullimit të krediteve (ECTS). Në përfundim të programit të studimeve studentët pajisen me diplomën Master Profesional në “Mësuesi në Arte” dhe me suplementin përkatës në gjuhën Shqipe dhe Angleze në përputhje me elementët e përcaktuar në Udhëzimin Nr. 11. datë 2.4.2020 të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit për përcaktimin e përmbajtjes dhe të formës së suplementit të diplomës.

Kurrikula e programit të studimit është hartuar dhe organizuar në përputhje me zhvillimet e fushës dhe në përgjigje të interesave dhe nevojave kombëtare. Gjatë zhvillimit të programit të studimit ofrohet literaturë e pasur në gjuhën shqipe dhe në gjuhë të huaj, duke mundësuar ndërthurjen e përvojave studimore vendase dhe ndërkombëtare të fushës së studimit në mësuesi dhe në shkencë sociale. Programi i studimit “Master Profesional” në “Mësues në Arte” është hartuar dhe ofrohet në zbatim dhe në përputhje me strategjinë për zhvillim institucional të Univeristetit “Barleti”, në përputhje me fushat dhe drejtimet akademike të Departamentit të Shkencave të Edukimit dhe Trajnimit Profesional si dhe në përputhje me fushën akademike të Fakultetit të Shkencave Sociale, Turizmit dhe Sportit të Univeristetit “Barleti”.



## **PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM.**

Në zbatim të Ligjit Nr. 80/2015, Kreu X: Sigurimi i cilësisë në arsimin e lartë, mbështetur në VKM nr. 109 për organizimin e ASCAL dhe në Manualin për Procedurat dhe Afatet për Vlerësimin e Cilësisë në kuadër të akreditimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe programeve të studimit 2017, për realizimin e vlerësimit të jashtëm të cilësisë për programin e studimit Master Profesional në “Mësuesi në Arte” ofruar nga Departamenti i Shkencave të Edukimit dhe Trajnimit Profesional në Fakultetin e Shkencave Sociale, Turizmit dhe Sportit të Universitetit “Barleti” ASCAL ka ngritur grupin e vlerësimit të jashtëm (GVJ) të përbërë nga ekspertët e jashtëm të vlerësimit Prof. Asoc. Dr. Nada Kallçiu dhe Prof. Asoc. Dr. Dorian Cene. Gjatë procesin të vlerësimit të jashtëm grupi i ekspertëve është asistuar nga koordinatorja teknike e ASCAL, Alma Arapi.

Grupi i vlerësimit të jashtëm për hartimin e raportit të vlerësimit të jashtëm është bazuar në Raportin e vlerësimit të brendshëm (RVB) të grupit të vlerësimit të brendshëm për programin e studimit në vlerësim, dokumentacionin shoqërues të RVB-së dhe informacionin e grumbulluar përgjatë takimeve të organizuara me aktorë të ndryshëm të përfshirë në ofrimin e programit të studimit Master Profesional në “Mësuesi në Arte” gjatë vizitave në Institucion të mbajtura në data 26-27 mars 2024. Vizitat në institucion janë mbajtur sipas agjendës së miratuar nga ASCAL, e cila i është njoftuar paraprakisht Univeritetit “Barleti” sipas parashikimeve të akteve rregullatorë të ASCAL.

GVJ ka vlerësuar në mënyrë të kujdesshme RVB-në dhe dokumentacionin shoqërues të saj, përpara vizitave të institucion në mënyrë që të zhvillonte një takim të mirëinformuar paraprakisht me aktorët e programit të studimit. Gjatë vizitës dy ditore (26-27 mars 2024) në Univeritetin “Barleti” u mbajtën takime me drejtuesin e njësisë kryesore dhe drejtuesin e njësisë bazë ku ofrohet programi i studimit në vlerësim, me grupin e vlerësimit të brendshëm, me studentët e programit të studimit, me personelin akademik efektiv dhe me kontratë të angazhuar në mësimdhënie në programin e studimit, me sekretarinë mësimore, me përfaqësues të zyrës së kurrikulave dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, me përfaqësues të Zyrës së këshillimit të karrierës dhe Alumni, me përfaqësues të strukturave institucionale të sigurimit të standarteve dhe të cilësisë në IAL, me përfaqësues të strukturave të koordinimit dhe marrëdhënieve me jashtë, me përfaqësues të drejtorisë së burimeve njerëzore, gjithashtu u zhvilluan vizita në mjedise të FSHSTS dhe UniBA si në biblioteka, mjedise studimi, auditore, laboratorë, në mjediset e shërbimeve të ndryshme për studentë, etj.

Universiteti "Barleti", është njohur me Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm më datë 09.10.2024, përmes sistemit AMS, si dhe në formë zyrtare me anë të shkresës me Nr. 99 / 29 Prot, datë 09.10.2024. Universiteti "Barleti" njofton në ASCAL më datë 11.10.2024, me anë të shkresës me Nr.1264 Prot, datë 11.10.2024 "Kthim përgjigje për Draft Raportin e Vlerësimit të Jashtëm për programin e studimit", IAL përcolli komentet me shkresë zyrtare Nr. 1264 Prot, Datë 11.10.2024.

Në bazë të shkresës me komentet mbi analizën e vlerësimit nga ana e ekspertëve për programin e studimit Master profesional në " Mësuesi në Arte", vlerësojnë të drejtë komentin mbi pikën II.6 që adresohet nga Universiteti "Barleti"

Vlerësimi përfundimtar për standartin II.6 rishikohet dhe vendoset të jetë Përbushet plotësisht.

Gjithsesi vlerësimi, në tërësi, për Standartin II mbetet Përbushet Kryesisht.

Kjo për arsye se, në gjykimin tonë, Departamenti i Shkencave të Edukimit dhe Trajnimit Profesional, pranë të cilit zhvillohet programi i studimit, nuk përmbush kriteret minimale prej 7 pedagogësh me kohë të plotë, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Kjo problematikë u evidentua edhe gjatë vizitës së Grupit të Vlerësimit të Jashtëm pranë Universitetit "Barleti".

**Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master Profesional në “Mësuesi në Arte”**

**I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT**

<b>Standardi I.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare, si dhe në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të tij.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	<p>Universiteti “Barleti” është institucion jo publik i arsimit të lartë, i cili zhvillon veprimtarinë e tij bazuar në Ligjin Nr. 80/15. Universiteti “Barleti” është hapur bazuar në VKM Nr. 571, datë 12.08.2005 (<b>Evidenca 1.4.a Hapja e UniBa Vendim</b>). Gjithashtu në vitin 2020, bazuar në Urdhërin e MAS Nr. 213, datë 03.07.2020 (<b>Evidenca 1.4.d Urdhër MASR Nr. 213 dt.3.7.2020</b>), Universiteti “Barleti” është riorganizuar në IAL me 3 (tre) njësi kryesore, pjesë e të cilave është edhe Fakulteti i Shkencave Sociale Turizmit dhe Sportit, ku bën pjesë edhe Departamenti i Shkencave të Edukimit dhe Trajnimit Profesional, i cili ofron programin “Mësuesi në Arte” Cikli II, Master Profesional. Në statutin e këtij institucioni të arsimit të lartë, Neni. 4, përcaktohet qartë misioni i vetë institucionit i cili ka të bëjë me kontributin në formimin e studentëve të aftë për tu përballur me sfidat që kalon vendi dhe rrjedhimisht edhe me ruajtjen e interesave kombëtarë.</p> <p><b>(Evidenca 1.1 Statuti i Universitetit Barleti).</b> Njëherazi, në po të njëjtin statut, Neni. 9 përcaktohet si vijon:  <i>UniBa (Universiteti Barleti) ka detyrimin të mundësojë zhvillimin e procesit mësimor dhe kërkimor sipas standardeve të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi në Republikën e Shqipërisë si dhe normave dhe standardeve ndërkombëtare.</i></p> <p>Rrjedhimisht për sa kohë që programet e studimit të UniBa i përmbahen përcaktimeve të legjislacionit në fuqi, ato janë në përputhje me interesat kombëtarë dhe ruajtjen e vlerave akademike sikurse dhe atyre kulturore të vendit.</p>
<b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe	Programi i studimit Master Profesional në “Mësuesi në Arte” zhvillohet në Fakultetin e Shkencave Sociale Turizmit dhe Sportit dhe ofrohet nga Departamenti i Shkencave të Edukimit dhe Trajnimit Profesional. Ky program zhvillohet në dy vite akademike






<p>misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.</p>	<p>me 120 kredite (ECTS) (<b>Evidenca 2.1.b Plani Mësimor për progrmin e studimit</b>). Në Statutin e Universitetit “Barleti”, Neni 4 përcaktohet si më poshtë:  <i>UniBa ka për mision që të përgatisë studentët si profesionistë novatorë, krijues e sipërmarrës të aftë për sfidat e së tashmes dhe të së ardhmes, si qytetarë të angazhuar të një bote në ndryshim dhe zhvillim të vazhdueshëm.</i> (<b>Evidenca 1.1 Statuti i Universitetit Barleti</b>). Ndërkohë në po të njëjtin statut Neni 6, institucioni parashikon shtyllat kryesore të veprimtarisë së tij. Njëherazi në Rregulloren e Fakultetit të Shkencave Sociale Turizmit dhe Sportit Neni. 11, (<b>Evidenca 1 Rregullore e Fakultetit FSHSTS</b>) përcaktohen fushat e studimeve të ofruara nga ky fakultet, pjesë e të cilit është edhe Departamenti i Shkencave të Edukimit dhe Trajnimit Profesional. Fushat e studimit të ofruara nga ky fakultet përputhen me programin e studimit Master Profesional në “Mësuesi në Arte”.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit dhe në përputhje me fushat e drejtimet akademike së Institucionit.</p>	<p>Programi i studimit Master Profesional në “Mësuesi në Arte” zhvillohet në përputhje me strategjinë e zhvillimit të Universiteti “Barleti” për periudhën 2020-2030. Në Strategjinë e Zhvillimit Institucional 2020-2030 të Uniba, veç të tjerash, parashikohet si objektiv edhe...<i>të zhvillojë programe formuese dhe trajnuese si dhe të realizojë shërbime arsimore, sociale dhe kulturore në një perspektivë të gjerë evropiane dhe ndërkombëtare.....Në kuadër të të nxënit gjatë gjithë jetës, ai ka për qëllim të ofrojë programe studimi afatshkurtra për kualifikime e specializime, për përditësimin e dijeve të fituara, si dhe për zhvillimin e vijueshëm profesional gjatë karrierës.</i> Njëherazi, po atje, në pikën III.4, parashikohet se Uniba në programet dhe veprimtaritë e tij akademike dhe aplikative, merr në konsideratë edhe ndryshimet social-kulturore, ekonomike të vendit, por edhe të rajonit.... (<b>Evidenca 10 Strategjia e Zhvillimit Institucional 2020-2030</b>). Programi i studimit Master Profesional në “Mësuesi në Arte”, sipas rregullores së vetë programit parashikon formimin e mësuesve të aftë të sigurojnë edukim në fushat e arteve (art pamor, muzikë dhe skenik) çka është në përputhje me një nga fushat e studimit që mbulon Fakulteti i Shkencave Sociale Turizmit dhe Sportit, ku bën pjesë edhe Departamenti i Shkencave të Edukimit dhe Trajnimit Profesional, i cili ofron programin “Mësuesi në Arte” Cikli II, Master Profesional. Fushat që mbulon fakulteti i sipërpërmendur janë parashikuar në rregulloren e tij Neni 11 (<b>Evidenca 1 Rregullore e Fakultetit FSHSTS</b>).</p>



<p><b>Kriteri 4.</b> Programi i studimit hartohet e zhvillohet në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe prirjet globale të zhvillimit mbështetur në dokumentacionin përkatës vendas dhe atë ndërkombëtar.</p>	<p>Programi i studimit Master Profesional “Mësuesi në Arte” zhvillohet në përputhje me Strategjinë e Zhvillimit Institucional 2020-2030 të Uniba. Njëherazi, duke qenë se ky program bazuar në rregulloren e tij Neni. 2, pika 4 (<b>Evidenca 3 Rregullore e programit MP Mesuesi në Arte</b>) parashikon si objektivi të tij ...një formim profesional, bashkëkohor në këtë fushë (Arte), si dhe ofron një përgatitje tërësore, profesionale për të gjitha profilet e mësuesisë lidhur me ofrimin e identifikimit, mbështetjes dhe zhvillimit të fëmijëve-nxënës me aftësi të kufizuara në arsimin parauniversitar, ai është në një linjë me Draft Strategjinë Kombëtare të Arsimit 2021-2026 <a href="https://arsimi.gov.al/draft-strategjia-kombetare-e-arsimit-2021-2026/">https://arsimi.gov.al/draft-strategjia-kombetare-e-arsimit-2021-2026/</a>. Gjithashtu vërehet, bazuar në parashikimet e rregullores së këtij programi, se ky program zhvillohet në përputhje me Guidën e Unesco-s për arsimin Unpacking Sustainable Development Goal 4 Education 2030 <a href="https://www.sdg4education2030.org/unpacking-sustainable-development-goal-4-education-2030-unesco-2017">https://www.sdg4education2030.org/unpacking-sustainable-development-goal-4-education-2030-unesco-2017</a></p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p>GVJ në bazë të dokumentave të vëna në dispozicion nga UniBA dhe në bazë të takimeve të zhvilluara gjatë vizitës në institucion, konstaton se Universiteti Barleti ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij të cilat synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare, si dhe në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të tij.</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p><b>Standardi I.2</b></p>	
<p><b>Programi i studimit është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.</p>	<p>Universiteti Barleti është një institucion i arsimit të lartë me eksperiencë 19 vjeçare në tregun arsimor (<b>Evidenca 1.4.a Hapja e UniBa Vendim Nr. 571 dt 12.08.2005</b>). Bazuar në të dhënat e Rregullores së Uniba, ai është i organizuar në 4 (katër) Fakultete mes të cilëve bën pjesë edhe Fakulteti i Shkencave Sociale Turizmit dhe Sportit (<b>Evidenca 1.2 Rregullore e UNIBA</b>). Ky i fundit, në rregulloren e tij Neni 2 përcakton strukturimin në 4 (katër) departamente, nga 3 që parashikon më së paku ligji i arsimit të lartë, mes të cilëve është edhe Departamenti i Shkencave të Edukimit dhe</p>






Trajnimit Profesional (**Evidenca 1 Regullore e Fakultetit FSHSTS**). Nisur nga dokumentacioni i dorëzuar, dëshmohej se mënyra e organizimit institucional, kapacitetet akademike, infrastruktura në shërbim të mësimdhënies dhe mësimnxënies, plotëson kriteret e kërkuara, arsye kjo për të cilën Universiteti Barleti ka kaluar akreditimin institucional me vlerësim maksimal duke u akredituar për 6 (gjashtë) vite. (**Evidenca 1.4.c Akreditimi institucional UMB**). Gjithashtu, institucioni disponon, bazuar në dokumentacionin e paraqitur, literaturë të përditësuar në fushën e mësimdhënies (**Evidenca 30 Lista e teskteve periodikëve në bibliotekë**). Në Fakultetin e Shkencave Sociale Turizmit dhe Sportit rezultojnë të angazhuar për vitin akademik 2022-2023:

36 pedagogë me kohë të plotë mes të cilëve:

- 1 me titullin dhe gradën Prof. Dr.
- 4 me titullin dhe gradën Prof.Asoc. Dr.
- 11 me gradën Dr.
- 19 MSC

dhe 34 pedagogë me kohë të pjesëshme (**Evidenca 23 Të dhëna tabelore për personelin akademik MPMA**) mes të cilëve:

- 1 me titullin dhe gradën Prof. Dr.
- 3 me titullin dhe gradën Prof. Asoc. Dr
- 12 me gradën Dr.
- 18 MSC.

**Për vitin akademik 2023-2024 rezultojnë të angazhuar:**

38 pedagogë me kohë të plotë mes të cilëve:

- 1 me titullin dhe gradën Prof. Dr.
- 5 me titullin dhe gradën Prof.Asoc. Dr.
- 13 me gradën Dr.
- 19 MSC

dhe 41 pedagogë me kohë të pjesëshme (**Evidenca 23 Të dhëna tabelore për personelin akademik MPMA**) mes të cilëve:

- 1 me titullin dhe gradën Prof. Dr.
- 4 me titullin dhe gradën Prof. Asoc. Dr
- 23 me gradën Dr.
- 13 MSC



	<p>Ndërkohë pranë departamentit që ofron programin e studimit, referuar tabelës në nivel departamenti për vitin akademik 2022-2023 (<b>Evidenca 23 Të dhëna tabelore për personelin akademik MPMA</b>[e përditësuar me Tabelat përmbledhjese MP, Arte) ushtrojnë detyrën e tyre 6 (shtatë pedagogë me kohë të plotë) dhe 2 (dy pedagogë me kohë të pjesëshme. Vlen për tu theksuar fakti se të gjithë pedagogët me kohë të plotë pranë këtij departamenti janë me grada shkencore dhe tituj akademik. Koncretisht 1 (një) pedagog mban titullin akademik Prof. Asoc. Dr, ndërkohë që 4 (katër) të tjerë zotërojnë gradën shkencore Doktor, 2 (dy) zotërojnë gradën Msc. Ndërkohë edhe pedagogët me kohë të pjesëshme janë 1 (një) me titullin akademik Prof. Asoc dhe 1 (një) me gradën shkencore Doktor. <i>Megjithatë Departamenti që ofron këtë program studimi duhet të shikojë me prioritet plotësimin e tij me staf akademik sipas parashikimeve të Ligjit 80/2015, Neni 55, pika 4. sikurse dhe me pedagogët me kohë të plotë për fushën specifike të arteve për arsye se studentët që do të diplomohen në këtë program i përkasin specifikisht kësaj fushe.</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	<p>Programi i studimit Master i Arteve në “Mësuesi në Arte”, bazuar në Planin Mësimor (<b>Evidenca 2.1.b Plani Mësimor për programin e studimit</b>) duhet të përputhet me fushën e gjerë 01, atë të ngushtë 011 dhe atë të detajuar, në gjykimin tonë, 0119, bazuar në VKM Nr. 330, datë 11.05 2022 <i>Për specifikimet dhe përmbajtjen e kodifikimit të programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë në republikën e Shqipërisë.</i> Njëherazi kjo përputhshmëri evidentohet edhe në raport me standartin ndërkombëtar ISCED (<a href="https://circabc.europa.eu/sd/a/286ebac6-aa7c-4ada-a42b-ff2cf3a442bf/ISCED-F%202013%20-%20Detailed%20field%20descriptions.pdf">https://circabc.europa.eu/sd/a/286ebac6-aa7c-4ada-a42b-ff2cf3a442bf/ISCED-F%202013%20-%20Detailed%20field%20descriptions.pdf</a>).</p> <p>Referuar Rregullores së Programin e Studimit të Ciklit II Master Profesional (120 ETC) në “Mësuesi në Arte”, Neni 2, ky program synon formimin e mësuesve në fushën e arteve, me një fokus të veçantë në mbështetjen e nxënësve me aftësi të kufizuara. Njësia kryesore, që ofron këtë program studimi, në rregulloren e saj, neni 11 (<b>Evidenca 1 Rregullore e Fakultetit FSHSTS</b>) parashikon ndër fushat e veprimtarisë së saj...<i>studime në fushën e mësimdhënies e edukimit, edukimit fizik e sporteve, turizmit e rekreacionit.....</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet</p>	<p>Programi i studimit Master i Arteve në “Mësuesi në Arte”, bazuar në Planin Mësimor (<b>Evidenca 2.1.b Plani mësimor për programin e studimit</b>) duket të përputhet me fushën e gjerë 01, atë</p>



të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.	të ngushtë 011 dhe atë të detajuar 0119, bazuar në VKM Nr. 330, datë 11.05 2022 <i>Për specifikimet dhe përmbajtjen e kodifikimit të programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë në republikën e Shqipërisë.</i> Njëherazi kjo përputhshmëri evidentohet edhe në raport me standartin ndërkombëtar ISCED ( <a href="https://circabc.europa.eu/sd/a/286ebac6-aa7c-4ada-a42b-ff2cf3a442bf/ISCED-F%202013%20-%20Detailed%20field%20descriptions.pdf">https://circabc.europa.eu/sd/a/286ebac6-aa7c-4ada-a42b-ff2cf3a442bf/ISCED-F%202013%20-%20Detailed%20field%20descriptions.pdf</a> ).								
<b>Kriteri 4.</b> Në rastet kur institucioni ofron program “Master profesional” në një drejtim specifik, jashtë profilit të institucionit, cilësia e tij garantohet nga institucionet partnere.	Programi studimit Master Profesional në “Mësuesi në Arte” ofrohet nga universiteti “Barleti”, Fakulteti i Shkencave Sociale, Turizmit dhe Sporteve, Departamenti i Shkencave të Edukimit dhe Trajnimit Profesional. Programi i ofruar bën pjesë në një fushë që mbulohet nga Departamenti i sipërpërmendur.								
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni i arsimit të lartë ofron trajnime profesionale të mëtijshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.	Bazuar në dokumentacioni e dorëzuar nga Universiteti “Barleti”, verifikohet se pranë këtij institucioni egziston Barleti Training and Testing Center (BTTC) ( <b>Evidenca 32.e Projektet e zbatuara dhe në proces të grupit Barleti</b> ). Nëpërmjet kësaj qendre trajnimesh Unviersiteti “Barleti” siguron trajnime profesionale në një sërë fushash, mes të cilave është edhe ajo e edukimit. Për çdo trajnim të ofruar grumbullohet një numër i caktuar kreditesh (ECTS), ndërkohë që trajnimet ofrohen qoftë me prani fizike e qoftë nëpërmjet ndjekjes online.								
<b>Konkluzione</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• <i>Departamenti që ofron këtë program studimi duhet të shikojë me prioritet plotësimin e tij me staf akademik sipas parashikimeve të Ligjit 80/2015, Neni 55, pika 4. sikurse dhe me pedagog më kohë të plotë për fushën specifike të arteve për arsye se studentët që do të diplomohen në këtë program i përkasin specifikisht kësaj fushe.</i></li> <li>• <i>Gjithashtu, konstatojmë se nuk është dorëzuar Rregullorja e Departamentit të Shkencave të Edukimit dhe Trajnimit Profesional.</i></li> </ul>								
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td>X</td> <td></td> </tr> </tbody> </table>	Përmbushet kryesisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			X	
Përmbushet kryesisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
		X							

### Standardi I.3



**Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësimit profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njërive e personelit, marrjes së përgjegjësi përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>Programi i studimit Master Profesional në “ Mësuesi në Arte” administrohet nga Departamenti i Shkencave të Edukimit dhe Trajnimit Profesional. Ky departament mban përgjegjësi për organizimin dhe mbarëvajtjen e programit të studimit. Ndërkohë Universiteti “Barleti” sipas përcaktimeve të rregullores së tij Neni. 13 (<b>Evidenca 1.2 Rregullore e UNIBA</b>) ka parashikuar organizimin e Komisionit të Vlerësimit të Performancës, një organ kolegjal i cili vlerëson punën e departamentit sikurse dhe stafit akademik. Gjithashtu, për të orientuar punën e organeve përkatëse në hapjen dhe vlerësimin e programeve të studimit është hartuar edhe <i>Manuali.....vlerësimit të programeve të studimit</i> (<b>Evidenca 16 Manuali i hartimit, riorganizimit, mbylljes dhe vlerësimit të programit të studimit</b>).</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendas dhe/ose të huaj.</p>	<p>Universiteti “Barleti” ka nënshkruar një sërë marrëveshjesh në funksion të mbarëvajtjes së procesit mësimor, sidomos përsa i përket realizimit të praktikave mësimore. Marrëveshjet janë nënshkruar me një sërë insitucionesh si institucione të arsimit parauniversitar, OJF, njësi të qeverisjes vendore, qendra komunitare etj. (<b>Evidenca 22 Lista e marrëveshjeve të partneritetit në funksion të programit të studimit</b>).</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj, dhe bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e</p>	<p>Zhvillimi i veprimtarive të programit të studimit Master Profesional në “Arte dhe Mësuesi” pasqyrohet në planin mësimor (<b>Evidenca 2.1.b Plani mësimor për programin e studimit</b>). Ky i fundit, veç të tjerash parashikon edhe praktika profesionale. Programi i studimit, sikurse u evidentua më sipër, ka nënshkruar një sërë marrëveshjesh me institucione të ndryshme mes të cilëve edhe qendra komunitare dhe institucione të arsimit parauniversitar (<b>Evidenca 22 Lista e marrëveshjeve të partneritetit në funksion të programit të studimit</b>). Praktikave profesionale zhvillohen pranë institucioneve të arsimit parauniversitar. Ndërkohë, sikurse dëshmohet nga dokumentacioni i dorëzuar (<b>Evidenca 32 c Të dhëna mbi mobilitetin e stafit dhe studentëve</b>), institucioni zhvillon aktivitete të mobilitetit të stafit akademik në kuadër të</p>



praktikës, për realizimin e kërkimeve shkencore dhe mobilitetit të personelit akademik dhe studentëve.	shkëmbimeve Erasmus+. Në dokumentacionin e dorëzuar nuk rezultojn të ketë evidencë për mobilitetin e studentët të këtij programi studimi për arsye se programi Master Profesional në “Mësuesi në Arte” sapo është çelur.			
<b>Kriteri 4.</b> Në mënyrë periodike, njësi përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.	Marrëveshjet e bashkëpunimit mes Universitetit “Barleti” dhe institucioneve të arsimit parauniversitar zhvillohen me synim mbarëvajtjen e praktikave profesionale edhe për studentët e programit Master Profesional në “Mësuesi në Arte”. Lidhur me sa më sipër, institucioni ka hartuar edhe Paketën e Praktikës për programet e ciklit II e cila parashikon detyrimet dhe të drejtat e secilit prej institucioneve që nënshkruajnë marrëveshjen, sikurse dhe mënyrën e vlerësimit të studentit pjesëmarrës në praktikë ( <b>Evidenca 2.3 UniBa paketa e praktikës Master</b> ). Njëherazi institucioni paraqet të dhëna të plota për pjesëmarrjen e përfaqësuesve të tij në programet e mobilitetit Erasmus + ( <b>Evidenca 32 e Të dhëna mbi mobilitetin e stafit dhe studentëve</b> ). Gjithashtu duhet theksuar se institucioni ka paraqitur të dhëna analitike (sasiore) rreth pjesëmarrjes së njësisë kryesore, pranë të cilës zhvillohet ky program studimi, në aktivitete ndërkombëtare (Evidenca 6 Të dhëna tabelore për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuar në sigurimin të brednshëm të cilësisë).			
<b>Konkluzione</b>	<i>GVJ në bazë të dokumentave të vëna në dispozicion nga UniBA dhe në bazë të takimeve të zhvilluara gjatë vizitës në institucion, konstaton se institucioni ka siguruar marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësimit profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I</b>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X





## II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË

Standardi II.1	
Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi dhe akteve të brendshme rregullatore.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, veprimtaritë formuese, të vlerësuara në kredite, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p>	<p>Elementët përbërës të programit të studimit Master Profesional në “Mësuesi në Arte” janë pasqyruar në Planin Mësimor (<b>Evidenca 2.1.b Plani mësimor për programin e studimit</b>). Hartimi i planit mësimor është realizuar në përputhje me VKM Nr. 41, datë 24.1.2018 <i>Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë</i> të ndryshuar. Gjithashtu në rregulloren e programit të studimit (<b>Evidenca 3 Rregullore e programit MP Mësuesi në Arte</b>) Neni. 13, është përcaktuar totali i krediteve (60 ECTS) që duhet të grumbullojë studenti gjatë një viti akademik sikurse dhe orët e punës së nevojshme për fitimin e 1 (një) krediti (25 orë/1 ECTS) . Të gjitha këto janë parashikuar sipas sistemit Evropian të Transferimit të Krediteve. Për më tepër, në të njëjtën rregullore Neni 7, është parashikuar edhe mënyra e frekuentimit të mësimit në përputhje me Udhëzimin e MAS Nr. 13, datë 20.06.2022. Programi i studimit Master Profesional në “Mësuesi në Arte”, në planin mësimor, ka të pasqyruara shpërndarjen e veprimtarive formuese në Module sipas parashikimeve të VKM Nr. 41, datë 24.1.2018 të ndryshuar. Konkretisht Moduli A – 11 ECTS (ca. 9 %), Moduli B – 49 ECTS ( ca. 40%), Moduli C – 36 ECTS ( 30%), Moduli D – 12 ECTS (10%) dhe Moduli E – 12 ECTS (10%). Shpërndarja e lëndëve, sikurse vërehet, është brenda përqindjeve të parashikuara nga VKM e sipërpërmendur. Plani mësimor përmban një sërë veprimtarish formuese si leksione, seminare, projekte/detyra kursi, sikurse dhe praktika profesionale, ndërkohë që sasia e orëve të punës individuale të studentit është në total 1,950.36 orë.</p> <p><i>Në planin mësimor të paraqitur nuk mund të verifikohen lëndët e parashikuara me zgjedhje nga studenti, sikurse dhe vërehet një shpërndarje jo proporcionale e lëndëve specifike të arteve (ndërkohë që programi aftëson mësuesinë pikërisht në fushën e arteve) përkundër atyre të formimit psiko-pedagogjik. Konkretisht të gjitha lëndët specifike të arteve janë parashikuar në modulin C, ndërkohë që ky modul i takon Lëndëve Ndërdisiplonore. Njëherazi, nisur edhe nga mënyra e formatimit të Planit Mësimor, është e</i></p>



	<i>pamundur të verifikohet nëse këto lëndë janë parashikuar si të detyruara apo si lëndë me zgjedhje.</i>
<p><b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale e specialitetesh, jep njohuri të përparura në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparura në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p>Programi i studimit Master Profesional në “Mësuesi në Arte” është i strukturuar në lëndë të cilat, kryesisht, adresojnë formimin psiko-pedagogjik të mësimeve dhe atë specifik të fushës së arteve. Ky program i pajis studentët me njohuritë e nevojshme teorike dhe aftësitë e duhura praktike për t’ju përgjigjur kërkesave të tregut dhe për të përmbushur synimet e arritjeve kryesisht përsa i përket aspektit pedagogjik.</p> <p>Nëpërmjet veprimtarive formuese, parashikuar në planin mësimor, studentët e këtij programi, sigurojnë formimin e duhur të mësimeve. Për më tepër programi i studimit mbështet:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>Aplikimin e reflektimit teorik dhe analizës kritike;</li> <li>Aplikimin e aftësive artistike;</li> <li>Aftësimin pedagogjik</li> </ol> <p>Aftësitë akademike në fushën e mësimeve realizohen nëpërmjet lëndëve Psikologji Edukimi, Zhvillim Kurrikule dhe Mendim Kritik, Teoritë e të Nxënës dhe Modelet e Mësimeve, Menaxhim Klase, Kompetencat Kyçe Evropiane për Arsimin Parauniversitar, Vlerësim për të Nxënës dhe i të Nxënës, Edukimi, dhe Bashkëpunimi me Prindërit. Për më tepër, ky program synon të aftësojë studentin edhe drejt kërkimit shkencor nëpërmjet lëndës Metodatat e kërkimit shkencor.</p> <p>Ndërkohë që lëndët e parashikuara për formimin artistik të mësimeve janë Didaktika e Arteve (Art pamor, skenik dhe muzikor), Kurrikula e Arteve, Aftësim praktik në Arte (Art pamor, skenik dhe muzikor). <b>(Evidenca 2.1.b Plani mësimor për programin e studimit).</b></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.</p>	<p>Programi i studimit, në Planin Mësimor <b>(Evidenca 2.1.b Plani mësimor për programin e studimit)</b> ka parashikuar 6 kredite (ECTS) për realizimin e praktikave profesionale, ndërkohë që detyrimet përmbyllëse janë parashikuar me 12 kredite (ECTS).</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Programet e ciklit të dytë “Master” në Mësuesi, që formojnë mësues të arsimit fillor janë plotësim i ciklit të parë Bachelor në arsimin Fillor. Programet Master në</p>	<p>Nga vizita e kryer në Universitetin “Barleti” u vërjet se pjesa më e madhe e studentëve të regjistruar në këtë program studimi, kishin përfunduar studimet pranë Universitetit të Arteve, pra nuk vinin nga një formim i dedikuar arsimit fillor. <i>Gjithashtu, bazuar në rregulloren e programit të studimit Neni. 24 (Evidenca 3 Rregullore e programit MP Mësuesi në Arte), vërehet se zotërimi i një diplome Bachelor në arsimin fillor nuk përbën</i></p>



<p>Mësuesi për formimin e mësuesve të arsimit të mesëm të ulët dhe të lartë organizohen si programe të ciklit të dytë të studimeve “Master”, sipas fushave përkatëse të formimit.</p>	<p><i>prioritet. Gjithsesi, nisur nga përmbajtja lëndore e Planit Mësimor të programit të studimit Master Profesional “Arte në Mësuesi” (Evidenca 2.1.b Plani mësimor për programin e studimit)konstatohet se ky program studimi i formon studentët me një fokus më të gjerë duke përfshirë të gjithë arsimin parauniversitar. Kjo në mënyrë të veçantë është mjaft e dukshme përse i përket lëndëve të formimit psiko-pedagogjik.</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Programet “Master” në fushën e mësuesisë organizohen me 120 kredite dhe duhet të përmbajnë 25 për qind të krediteve në shërbim të formimit të përgjithshëm psiko-pedagogjik. Programet “Master”, që formojnë mësues të së njëjtës fushë të mësuesisë, duhet të kenë së paku 80 për qind të kurrikulës me përmbajtje të ngjashme.</p>	<p>Programi i studimit Master Profesional “Mësuesi në Arte” është i strukturuar në 2 (dy) vite akademike, 4 (katër) semestra, në përfundim të të cilit studenti grumbullon 120 kredite (<b>Evidenca 2.1.b Plani mësimor për programin e studimit</b>). Ky program studimi përmban mbi 25% të krediteve dedikuar lëndëve në shërbim të formimit psiko-pedagogjik. Krahasuar me programet e tjera të studimit në Republikën e Shqipërisë, ku marrim për bazë programin e studimit Pedagogji Muzikore dhe Mësuesi në Universitetin e Arteve sikurse dhe programet e mësuesisë në arte pranë Universitetit “Luigj Gurakuqi” Shkodër (Mësuesi në Arte Pamore dhe Mësues Muzike), duke qenë të gjitha këto programe Master Profesional me 120 kredite, konstatojmë se mes tyre ka lëndë të përbashkëta <i>por programi ‘Mësuesi në Arte’ i Universitetit “Barleti” nuk përputhet në masën 80% me programet e ngjashme pranë Universitetit të Arteve dhe Universitetit “Luigj Gurakuqi” Shkodër.</i></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara në kuadrin ligjor të ministrisë përgjegjëse për arsimin.</p>	<p>Universiteti Barleti nuk është institucion me status të veçantë.</p>



<p><b>Kriteri 7.</b> Programet e studimit, të ciklit të dytë Master, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, si dhe me të njëjtën emërtësë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.</p>	<p>Krahasuar me programet e tjera të studimit në Republikën e Shqipërisë, ku marrim për bazë programin e studimit Pedagogji Muzikore dhe Mësuesi në Universitetin e Arteve sikurse dhe programet e mësuesisë në arte pranë Universitetit “Luigj Gurakuqi” Shkodër (Mësuesi në Arte Pamore dhe Mësues Muzike), duke qenë të gjitha këto programe Master Profesional me 120 kredite, konstatojmë se mes tyre ka lëndë të përbashkëta por programi ‘Mësuesi në Arte’ i Universitetit “Barleti” <i>nuk përputhet në masën 70% me programet e ngjashme pranë Universitetit të Arteve dhe Universitetit “Luigj Gurakuqi” Shkodër.</i></p>
<p><b>Kriteri 8.</b> Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.</p>	<p>Bazuar në të dhënat e Raportit të Vlerësimit të Brendshëm për programin Master Profesional “Mësuesi në Arte” sikurse dhe në Evidencën Nr. 44, Universiteti “Barleti” ka paraqitur pranë Ministrisë së Arsimit dhe Sportit propozimet e tij për kodifikimin e programeve të studimeve, ndërkohë që është në pritje të konfirmimit të tyre.</p>
<p><b>Kriteri 9.</b> Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.</p>	<p>NA</p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• <i>Sikurse është evidentuar edhe më sipër, programi i studimit Master Profesional “Mësuesi në Arte” në rregulloren e programit të studimit ka evidentuar si treg të mundshëm të studentëve të diplomuar edhe mësimdhënien në arsimin bazë, pra përfshirë edhe atë fillor. Ndërkohë në kriteret hyrëse, bazuar në rregulloren e programit të studimit Neni. 24 (Evidenca 3), vërehet se zotërimi i një diplome Bachelor në arsimin fillor nuk përbën prioritet.</i></li> <li>• <i>Gjithashtu krahasuar me programe të ngjashme (shih Kriteri 5, Standarti II.1) vërehet se përmbajtja e kurrikulës nuk është e ngjashme në masën 80%.</i></li> </ul>





	<ul style="list-style-type: none"> <li><i>Krahasuar me programet e të njëjtës fushë studimi (mësuesi në fushën e arteve për profilet mësues muzike dhe mësues arti pamor) konstatohet se ky program nuk është i ngjashëm në masën 70%.</i></li> </ul> <p><i>Rrjedhimisht GVJ në bazë të dokumentave të vëna në dispozicion nga UniBA dhe në bazë të takimeve të zhvilluara gjatë vizitës në institucion.</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X	

<b>Standardi II.2</b>	
<b>Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.</p>	<p>Programi i studimit Master Profesional “Mësuesi në Arte” zhvillohet pranë Fakultetit të Shkencave Sociale, Turizmit dhe Sportit, pjesë e Universitetit “Barleti”. Ky fakultet bazuar në Ligjin 80/2015 <i>Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë</i> ka përcaktuar në statutin e tij (<b>Evidenca 1.1 Statuti i Universitetit Barleti</b>) organigramën e institucionit sipas së cilës njësia kryesore e sipërpërmendur ka në përbërje 4 (katër) njësi bazë të llojit Departament, të cilat janë:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Departamenti i Shkencave të Edukimit dhe Trajnimit Profesional;</li> <li>2. Departamenti i Edukimit Fizik dhe Sporteve;</li> <li>3. Departamenti i Turizmit, Mikpritjes dhe Rekreacionit;</li> <li>4. Departamenti i Shkencave të Sjelljes dhe Shëndetit;</li> </ol> <p>Dekani i Fakultetit të Shkencave Sociale, Turizmit dhe Sportit zotëron titullin akademik Profesor dhe gradën shkencore Doktor, sipas përcaktimeve në legjislacionin në fuqi.</p> <p>Programi i studimit Master Profesional “Mësuesi në Arte” administrohet në Departamentin e Shkencave të Edukimit dhe Trajnimit Profesional. Drejtuesi i këtij departamenti mban titullin akademik Profesor i Asociuar dhe gradën shkencor doktor sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi (<b>Evidenca 23 Të dhëna tabelore për personelin akademik MPMA[ë përditësuar me Tabelat përmbledhjësë MP, Arte]</b>). Bazuar në Ligjin 80/2015, Neni 45, drejtuesi i departamenti duhet të ketë mandat 4 vjeçar</p>





(pavarësisht mënyrës së caktimit të tij, me zgjedhje ose emërim në institucionet arsimit të lartë jopublike). *Gjithsesi në statutin e Universitetit "Barleti", Neni 33 (Evidenca 1.1 Statuti i Universitetit Barleti) parashikohet emërimi i drejtuesit të departamentit me mandat 2 vjeçar.* Në rregulloren e Universitetit (Evidenca 1.2 Rregullore e UNIBA) janë përcaktuar qartë të gjitha detyrat që duhet të përmbushë përgjegjësi i departamentit. Për më tepër institucioni ka parashikuar edhe angazhimin dhe detyrat specifike të koordinatorit të departamentit. Sipas parashikimeve në Ligjin 80/2015, Neni 25, departamenti duhet të ketë...*të paktën shtatë anëtarë, të punësuar me kohë të plotë, si personel akademik.....nga të cilët të paktën tre me grada shkencore ose tituj akademik.* Nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar (Evidenca 23 Të dhëna tabelore për personelin akademik MPMA[e përditësuar me Tabelat përmbledhjese MP, Arte) , konstatohet se pranë këtij departamenti janë angazhuar me kohë të plotë 6 (gjashtë) pedagogë, ku të gjithë zotërojnë grada shkencore dhe/ose tituj akademik. *Gjithsesi duhet plotësuar parashikimi ligjor sipas Nenit 25 të ligjit 80/2015.*

**Fakulteti i Shkencave Sociale, Turizmit dhe Sportit për dy vite akademike 2022-2023 dhe 2023-2024 ka në strukturën e tij këto të dhëna:**

Personeli i angazhuar në FSHSTS	2022-2023		2023-2024	
	PAE	PAK	PAE	PAK
Prof Dr	1	1	1	1
Prof.Assoc	4	3	5	4
Dr/Doc	12	12	13	23
Msc	19	18	19	13
<b>Në total</b>	<b>36</b>	<b>34</b>	<b>38</b>	<b>41</b>



**Departamenti i Shkencave të Edukimit dhe Trajnimit Profesional** ka në përbërje të tij për dy vite akademike 2022-2023 dhe 2023-2024:

Personeli i angazhuar në DSHETP	2022-2023		2023-2024	
	PAE	PAK	PAE	PAK
Prof Dr	-	-	-	-
Prof.Assoc	2	-	3	1
Dr/Doc	3	-	3	1
Msc	1	-	-	-
<b>Në total</b>	<b>6</b>	<b>0</b>	<b>6</b>	<b>2</b>

**Kriteri 2.** Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.

Programi i studimit Master Profesional “Mësuesi në Arte”, referuar Planit Mësimor (**Evidenca 2.1.b Plani mësimor për programin e studimit**)ka parashikuar edhe zhvillimin e praktikave profesionale. Këto të fundit vlerësohen me 12 kredite duke përbërë 10% të totalit të krediteve në këtë program studimi. Universiteti “Barleti” ka nënshkruar një sërë marrëveshjesh me institucione të tjera në funksion të realizimit të një sërë veprimtarish, mes të cilave edhe zhvillimit të praktikave profesionale (**Evidenca 22 Lista e marrëveshjeve të partneritetit në funksion të programit të studimit**). Për ndjekjen e praktikave të studentëve Universiteti Barleti angazhon staf akademik, bazuar në marrëveshjet e nënshkruara. Përmbajtja e këtyre marrëveshjeve përcakton detyrimet dhe përgjegjësitë e palëve. Mes të tjerave, në këto marrëveshje, vërehet edhe bashkëpunimi me Departamentin e Shkencave të Edukimit në përmbushje të detyrimeve kurrikulare të programeve të studimit që ofrohen nga ky departament. Për zbatimin e këtyre marrëveshjeve, nga ana e Universiteti “Barleti”, është përcaktuar personi përgjegjës për koordinimin e punës.




	<i>Në dokumentacionin e dorëzuar nuk gjenden evidenca për angazhimin e stafit ndihmës akademik apo administrativ për ndjekjen e praktikave.</i>			
<b>Kriteri 3.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.	Administrimi i programit të studimit Master Profesional “Mësuesi në Arte” realizohet nga Departamenti i Shkencave të Edukimit dhe Trajnimit Profesional. Bazuar në legjislacionin në fuqi sikurse dhe në Rregulloren e Universitetit “Barleti”, Neni. 24, përgjegjësi i departamentit ka detyrimin e menaxhimit të programit të studimit. Njëherazi, bazuar në të njëjtën rregullore, Neni. 25, institucioni ka parashikuar edhe angazhimin e Koordinatorit të Departamentit i cili asiston përgjegjësin e departamentit në proceset administruese ( <b>Evidenca 1.2 Rregullore e UNIBA</b> ). Lidhur me sa më sipër Universiteti “Barleti” ka emëruar Dr. A.Qafa në cilësinë e koordinatorit të departamentit ( <b>Evidenca 9 Vendimi për emërimin e koordinatorit të programit tëstudimit</b> ).			
<b>Konkluzione</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li><i>Bazuar në dokumentacionin e dorëzuar nga GVB të programit Master Profesional “Mësuesi në Arte” rezulton se Departamenti i Shkencave të Edukimit dhe Trajnimit Profesional ka në përbërje të tij, në cilësinë e stafit akademik me kohë të plotë, 6 pedagogë, ndërkohë që Ligjin 80/2015, Neni 25, departamenti duhet të ketë....të paktën shtatë anëtarë, të punësuar me kohë të plotë, si personel akademik.....nga të cilët të paktën tre me grada shkencore ose tituj akademik.</i></li> <li><i>Njëherazi duhet riparë Statuti i Universitetit “Barleti”, Neni 33 për arsye se parashikon emërimin i drejtuesit të departamentit me mandat 2 vjeçar, ndryshe nga sa parashikon Ligji80/2015, Neni 45.</i></li> </ul>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			<b>X</b>	

<b>Standardi II.3</b>	
<b>Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të dytë.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit të	Departamenti i Shkencave të Edukimit dhe Trajnimit Profesional pranë të cilit zhvillohet programi i studimit Master Profesional “Mësuesi në Arte” ka hartuar Rregulloren e Programit të Studimit



<p>ciklit të dytë, disponon informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>miratuar me VSA Nr. 21/7, datë 6.10. 2022 (Evidenca 3). Rregullorja e programit parashikon të gjitha të dhënat dhe procedurat që ndiqen përgjatë zhvillimit të studimeve. Pjesë e kësaj rregulloreje janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Plani mësimor (<b>Evidenca 2.1.b Plani mësimor për programin e studimit</b>);</li> <li>• Objektivat e programit (Neni. 3);</li> <li>• Kriteret dhe procedurat e vlerësimit (Neni. 17);</li> <li>• Organizimin e praktikave (Neni. 12);</li> <li>• Tregu i punës (Aneksi II);</li> <li>• Kriteret e pranimit (Neni. 24);</li> <li>• Mënyrën e organizimit të mbrojtjes së diplomës, (Neni. 22)</li> </ul> <p>sikurse dhe të dhëna të tjera. Rregullorja e programit të studimit jep informacionin e nevojshëm duke mundësuar, njëherazi, transparencën e plotë rreth të gjitha procedurave për zhvillimin e programit dhe duke adresuar përgjegjësit e organeve dhe autoriteteve drejtuese, sikurse dhe ato të studentit. Veprimtaritë formuese të parashikuara në planin mësimor, zbërthehen në programet e lëndëve (syllabuset) të disponuara nga departamenti që ofron programin e studimit (<b>Evidenca 2.6 Programet lëndore Syllabuset</b>).</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestral, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.</p>	<p>Programi i studimi Master i Profesional “Mësuesi në Arte”, është i organizuar në lëndë të vlerësuara në kredite, në përputhje me VKM nr. 41, dt. 24.1 2018, e ndryshuar dhe udhëzimet e MAS, legjislacionin vendas në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve. Kuadri i përgjithshëm formues i programit të studimit përcaktohet në planin mësimor (<b>Evidenca 2.1.b Plani mësimor për programin e studimit</b>) të ndarë në vite dhe semestra. Veprimtaritë formuese grupohen në module si më poshtë vijon</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>A. Moduli- Lëndë bazë të programit të studimit, që përcaktojnë formimin e përgjithshëm, përgatitjen metodologjike dhe kulturën e përgjithshme (11 ECTS, ka 9%);</li> <li>B. Moduli - Lëndë karakterizuese, që lidhen me veçoritë e programit të studimit dhe japin një formim specifik, sipas karakteristikave të tij (49 ECTS, ka 40%);</li> <li>C. Moduli - Lëndë ndërdisiplinore dhe/ose integruese në një ose më shumë grupe disiplinash, të ngjashme dhe/ose integruese me disiplinat karakterizuese, profile të programit dhe grup-lëndë me zgjedhje (36 ECTS, ka 30%);</li> </ol>



	<p>D. Moduli -Lëndë plotësuese, të fokusuar në përfitim të aftësive në gjuhë të huaj, aftësive informatike dhe telematike, aftësive komunikuese e prezantuese, aftësive që lehtësojnë hyrjen në tregun e punës dhe në praktikat profesionale (12 ECTS, ka 10%);</p> <p>E. Moduli - Detyrime përmblylëse, që lidhen me provimin përfundimtar (12 ECTS, ka 10%).</p> <p>Në përfundim të studimeve të tyre studentët e këtij programi grumbullojnë 120 ECTS. Plani mësimor përmban të dhënat për:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Kreditet (ECTS) të çdo lënde;</li> <li>• Formën e mësimdhënies;</li> <li>• Mënyrën e kontrollit;</li> <li>• Orët e zhvilluara në auditor;</li> <li>• Orët e përgatitjes individuale;</li> <li>• Ndarjen e lëndëve në semestra;</li> </ul> <p><i>Në planin mësimor të paraqitur nuk mund të verifikohen lëndët e parashikuara me zgjedhje nga studenti, kështu sugjerohet të bëhet një përcaktim më i detajuar i lëndëve me zgjedhje dhe totalin e krediteve të parashikuara për këto lëndë.</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>Në rregulloren e programit të studimit (<b>Evidenca 3 Rregullore e programit MP Mësuesi në Arte</b>), janë përcaktuar, në Nenet 24, 25, 26 kriteret e pranimit dhe dokumentacioni që duhet paraqitur. Gjithashtu, në po të njëjtën rregullore Neni. 14 janë parashikuar edhe kushtet e transferimit të studimeve, ndërkohë që njëherazi me vendimin Nr. 56, datë 10.02.2021, Senati Akademik i Universiteti “Barleti” ka përcaktuar edhe kriterin e mesatares për çdo program studimit.</p> <p>(Evidenca 20.6 Vendim Senati-Kriteret e pranimit të studentëve në 2021-2022).</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikë, seminar apo orë të laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe</p>	<p>Struktura e përmbajtjes së të gjitha veprimtarive të kryera në kuadër të programit të studimit Masteri Profesional “Mësuesi në Arte” pasqyrohet në Planin Mësimor. Në kuadër të këtij programi janë hartuar programet lëndore (<b>Evidenca 2.1.a Tabela e Planit mësimor MPMA sipas veprimtarive</b>) për një pjesë të lëndëve. Përmbajtja e programit të lëndës është hartuar në përputhje me elementët e kërkuar sipas VKM Nr. 41 datë 24.01.2018 i ndryshuar. Praktikë mësimore zhvillohen në marrëveshje me institucionet e arsimit parauniversitar. Çdo student ka dosjen e tij të praktikës ku</p>





jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.	përshihet edhe formulari i vlerësimit. Institucioni cakton një pedagog udhëheqës të praktikës profesionale.			
<b>Kriteri 5.</b> Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë në shqip dhe anglisht.	Hartuesit e raportit të vlerësimit të brendshëm, shprehen se rishikimi i syllabuseve, planit mësimor dhe veprimtarive të tjera është një proces i përvitshëm. Gjithsesi në dokumentacionin e dorëzuar nuk është paraqitur ndonjë evidencë që të vërtetojë një procedurë të tillë. Megjithatë, duke qenë të vetëdijshëm se ky program studimi ka nisur në vitin akademik 2022-2023 dhe në përfundim të këtij viti diplomon studentët e parë, është mëse e pranueshme që rishikimi i programit të studimit të mund të shikohet pasi të ketë përfunduar i gjithë cikli.			
<b>Konkluzione</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li><i>Në planin mësimor të paraqitur nuk mund të verifikohen lëndët e parashikuara me zgjedhje nga studenti, kështu sugjerohet të bëhet një përcaktim më i detajuar i lëndëve me zgjedhje dhe totalin e krediteve të parashikuara për këto lëndë.</i></li> </ul> <p><i>GVJ në bazë të dokumentave të vëna në dispozicion nga UniBA dhe në bazë të takimeve të zhvilluara gjatë vizitës në institucion, konstaton se programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të dytë.</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

#### Standardi II.4

**Struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrin Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.	Emërtesa e programit të studimit “Mësuesi në Arte” përcakton fushën e ngushtë të studimit dhe atë të thellimit të njohurive të mëtejshme sipas kodifikimeve kombëtare (VKM Nr. 330, datë 11.05 2022 ) dhe ndërkombëtare (ISCED), duke qenë ky një program i orientuar për formimin e mësuesve në fushën e arteve. Si i tillë, në planin mësimor janë parashikuar lëndët e dedikuara formimit psiko-pedagogjik, të cilat zënë numrin më të madh të krediteve dhe lëndët e formimit didaktik artistik, kryesisht të grupuara në modulën C (Evidenca 2.1.a Tabela e Planit mësimor MPMA sipas veprimtarive). Gjithashtu plani mësimor ka të

	<p>përckatuara edhe praktika profesionale të cilat zhvillohen në vitin e parë dhe të të dytë, të cilat, bazuar në marrëveshjet e nënshkruara me institucione të arsimit parauniversitar, zhvillohen në funksion të aftësimin praktik në mësimdhënie.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënimit dhe kërkimit shkencor.</p>	<p>Në programin mësimor Masteri Profesional “Mësuesi në Arte”, organizimi i veprimtarisë mësimore shtrihet në 2 (dy) vite akademike dhe 4 (katër) semestra me kohëzgjatje normale 15 javë secili. Shpërndarja e lëndëve në vite dhe semestra, sikurse dhe strukturimi i tyre në module, sipas parashikimeve të VKM 41 datë 24.01.2018 i ndryshuar, mundëson qasjen ndaj objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënimit <b>(Evidenca 2.1.a Tabela e Planit mësimor MPMA sipas veprimtarive)</b>.          Programi i studimit synon të formojë profesionistë të mësimdhënies në fushën e arteve, në të gjitha profilet e mësuesisë, sidomos përsa i përket mbështetjes së fëmijëve-nxënës me aftësi të kufizuara (Evidenca 3, Neni 2).  <i>Gjithsesi nga verifikimi i programeve të lëndëve (Syllabuseve) nuk rezulton të jetë parashikuar ndonjë lëndë specifike për vëmendjen e veçantë ndaj “...mbështetjes së fëmijëve-nxënës me aftësi të kufizuara.”</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare. Në rastet e programit të studimit “Master Profesional”, ky program duhet të sigurojë aftësi, kompetenca dhe formim të thelluar profesional.</p>	<p>Programi është strukturuar me përmbajtje lëndore, kryesisht, të fushës së mësuesisë sikurse dhe lëndë të fushave të arteve (art pamor, skenik dhe muzikë). Praktika (profesionale) vlerësohet në 12 kredite, pra zë 10% të totalit të krediteve. Nga konsultimi i planit mësimor <b>(Evidenca 2.1.a Tabela e Planit mësimor MPMA sipas veprimtarive, (Evidenca 2.1.b Plani mësimor për programin e studimit)</b> vlerësojmë se raporti i lëndëve teorike me ato praktike është i barazpeshur në përmushje të objektivit që lidhet me aftësimin e studentëve në mësimdhënie.  <i>Grupi i Vlerësimit të Brendshëm nuk ka paraqitur modele (plane mësimore) të programeve të studimit të ngjashme me programin Master Profesional “Mësuesi në Arte”. Sugjerohet që të paraqiten disa modele ku është bazuar ngjashmëria.</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve,</p>	<p>Referuar Planit Mësimor <b>(Evidenca 2.1.b Plani mësimor për programin e studimit)</b> dhe bazuar në objektivat e programit të studimit <b>(Evidenca 3 Rregullore e programit të studimit MP Pësuesi në Arte)</b> konstatohet se programi i studimit Master Profesional “Mësuesi në Arte”, kryesisht siguron arritjen e objektivave të parashikuara në rregulloren e tij.</p>

<p>mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p><i>Gjithsesi jemi skeptikë përse i përket aftësimin praktik të studentit në mësimdhënien konkrete të një prej fushave të artit për arsye se programi nuk përmban, të paktën nga të dhënat e syllabuseve, lëndë konkrete për aftësimin në muzikë, arte pamore apo skenike. Rrjedhimisht në funksion të përmirësimit të aspektit të ngushtë artistik (arte pamore, skenike, muzikore) do të sugjerohet përfshirjen në kurrikul të lëndëve konkrete të këtyre fushave. Themi këtë nisur edhe nga fakti se, duke verifikuar dokumentacionin për kriteret hyrëse të studentëve (<b>Evidenca 2.1.b Plani mësimor për programin e studimit</b>), nuk konstatohet ndonjë preferencë apo kushtëzim për pranimin e studentëve të cilët të kenë përfunduar studimet Bachelor (apo të ngjashme) në të paktën një nga fushat e arteve. Aq më tepër që do të ishte e vështirë, edhe nëse një gjë e tillë do të ndodhte, që një student i diplomuar në Bachelor për Arte Pamore apo Skenike, në master të mund të ndiqte këtë program studimi dhe mandej të ishte i aftësuar edhe si Mësues Muzike. Rrjedhimisht gjykojmë që programi duhet ta përqëndrojë më shumë formimin e studentit në lidhje me lëndët specifike që do të japë në arsimin parauniversitar.</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.</p>	<p>Syllabuset, e hartuara në përputhje me legjislacionin në fuqi, përmbajnë edhe literaturën e detyrueshme. Në disa prej lëndëve të zhvilluara, literatura e detyrueshme është ajo e përgatitur enkas nga pedagogu i lëndës, çka nënkupton se kjo literaturë është në përditësim të vazhdueshëm (<b>Evidenca 2.6 Programet lëndore Syllabuset</b>). Dëshirojmë të theksojmë se programi i studimit Master Profesional “Mësuesi në Arte” është çelur në vitin akademik 2022-2023. Pra grupi i parë i studentëve do të diplomohet në përfundim të vitit akademik 2023-2024, kohë kjo pas së cilës, duke parë rezultatet konkrete të këtij programi studimi, mund të ndërmerren hapa konkretë në përditësimin e syllabuseve dhe planeve mësimore.</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Përmbajtja e programit të studimit garanton përfundimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.</p>	<p>Referuar planit mësimor (<b>Evidenca 2.1.b Plani mësimor për programin e studimit</b>) praktikave profesionale të strukturuar (<b>Evidenca 2.3 UniBa paketa e praktikës Master</b>), marrëveshjeve të bashkëpunimit që Universiteti “Barleti” ka me partnerë të tjerë (<b>Evidenca 22 Lista e marrëveshjeve të partneritetit në funksion të programit të studimit</b>) dhe kualifikimit të stafit akademik (<b>Evidenca 7.1 CV e stafit akademik</b>), programi i studimit arrin të sigurojë përfundimin e kompetencave dhe aftësive përse i përket formimit psiko-pedagogjik. Njëherazi, programi i studimit ka të parashikuara edhe lëndë që sigurojnë formimin me qasje ndaj arteve (arte skenike, pamore dhe muzikore).</p>



	<i>Gjithsesi, në funksion të aftësimit më të thelluar në lidhje me mësimdhënien e arteve dhe në mënyrë që të sigurohet garancia e zotërimit profesional në fushën specifike të arteve, sugjerohet që të shikohet mundësia e pasurimit të programit të studimit me lëndë më specifike të fushës së arteve.</i>
<b>Kriteri 7.</b> Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.	Programi i studimit Master i Profesional në “Mësuesi në Arte”, nëpërmjet veprimtarive formuese krijon perspektivën e nevojshme për punësimin e studentëve në fushën e mësuesisë. Qëkurse ky program siguron diplomimin në Master Profesional, nuk krijon mundësinë për vijimin e studimeve në Ciklin III por gjithsesi krijon akses në programet e formimit të vazhduar. Qasja ndaj tregut të punës së mësuesisë realizohet në përputhje me kuadrin ligjor. Diploma e siguruar në përfundim të studimeve i takon Nivelit 7 të Kornizës Europiane të Kualifikimeve. Referuar parashikimeve të Universitetit “Barleti” për tregun e punës së këtij program studimi <b>(Evidenca 3 Rregullore e programit të studimit MP Mësuesi në Arte)</b> , gjykojmë që programi në tërësi siguron punësimin e studentëve.
<b>Konkluzione</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• <i>Qëkurse ky program studimi parashikon në mënyrë të veçantë mbështetjen e fëmijëve-nxënës me aftësi të kufizuara, këshillohet që në Planin Mësimor të ketë lëndë konkrete për këtë kategori.</i></li> <li>• <i>Universiteti “Barleti” duhet të paraqesë modele (plane mësimore) të programeve të studimit të ngjashme me programin Master Profesional “Mësuesi në Arte”.</i></li> <li>• <i>Në funksion të aftësimit artistik të mësidhënësve këshillojmë që programi duhet ta përqëndrojë më shumë formimin e studentit në lidhje me lëndët specifike artistike që do të japë në arsimin parauniversitar.</i></li> <li>• <i>Duhet të ketë një qasje më konkrete ndaj specifikës së secilës formë të artit (art pamor, skenik, muzikore), në mënyrë që të sigurohet aftësimi konkret i mësuesve sidomos në arte pamore dhe muzikore. Konkretisht: Çfarë garancie ofron IAL për një student të diplomuar në Bachelor në Arte Pamore, në mënyrë që ky të jetë i aftë të japë lëndët e muzikës të cilat, referuar Planit Mësimor, nuk i ka pasur pjesë të formimit të tij.</i></li> <li>• <i>Gjithashtu duhet treguar kujdes në evidentimin e çdo Syllabusi më vete. Konkretisht disa lëndë (të aftësimit artistik) janë strukturuar në një Syllabus të vetëm.</i></li> </ul>





<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X	

### Standardi II.5

**Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përpunje me objektivat e tyre.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.</p>	<p>Sikurse kemi evidentuar edhe më sipër, programi i studimit Master Profesional “Mësuesi në Arte”, në përfundim të vitit akademik 2023-2024, diplomon studentët e parë. Gjithsesi, nga dokumentacioni i dorëzuar, rezulton se Universiteti “Barleti” ka marrë të gjitha masat për përshtatshmërinë e programit me tregun e punës duke analizuar situatën aktuale (<b>Evidenca 4 Studimi i tregut të punës dhe studimi periodik pas daljes së studentëve</b>). Në funksion të thithjes së informacionit nga ana e studentëve rreth të gjitha çështjeve që kanë të bëjnë me programet e studimit, përfshirë programin e marrë në vlerësim, Universiteti “Barleti” ka ngritur Njësinë e Zhvillimit të Kurrikulës dhe Cilësisë e cila funksionon bazuar në rregulloren e saj (<b>Evidenca 16.2 Rregullore e Njësisë së Zhvillimit Kurrikular dhe Cilësisë</b>). Kjo njësi, në përfundim të semestrit/vitit akademik, harton dhe administron një pyetësor, sipas një formati (<b>Evidenca 2.4 Formular vlerësimi i studentëve për lëndën</b>) për studentët, nëpërmjet të cilit siguron informacion rreth vlerësimit të studentëve për një sërë çështjesh që kanë të bëjnë me përmbajtjen e lëndës, organizimin, pedagogun etj. Në përfundim Njësia e Zhvillimit të Kurrikulës dhe Cilësisë harton raportin mbi rezultatet e pyetësorit (<b>Evidenca 16.7 Raporti mbi rezultatet e formularit të studentit 21-22 sem I</b>).</p> <p>Pranë “Departamentin e Shkencave të Edukimit dhe Trajnimit Profesional “ është ngritur edhe Bordi i Karrierës, pjesë e të cilit janë ish-studentët dhe profesionistë të fushave të ndryshme (<a href="https://umb.edu.al/news1166.html">https://umb.edu.al/news1166.html</a>), një mënyrë kjo për të pasur një qasje të drejtpërdrejtë ndaj kërkesave praktike të tregut të punës. Gjithashtu Universiteti “Barleti” mban kontakte me një sërë partnerësh duke organizuar aktivitete të ndryshme të cilat ndikojnë në përmirësimin e programeve të studimit me qasje tregun e punës. <a href="https://umb.edu.al/news5526.html">https://umb.edu.al/news5526.html</a></p>



<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.</p>	<p>Nga dokumentacioni i paraqitur, sikurse dhe nga vizita e kryer pranë Universitetit “Barleti”, rezulton që ky institucion përfshin studentët në vlerësimin e programeve të studimit, pedagogët, organizimin e këtyre programeve etj. Përfshirja e studentëve në vlerësimin e programeve të studimit realizohet nga Njësia e Zhvillimit të Kurrikulës dhe Cilësisë e cila administron plotësimin e pyetësorëve të ndryshëm (<b>Evidenca 2.4 Formular vlerësimi i studentëve për lëndën</b>). Rezultatet e pyetësorëve pasqyrohen në raportet përkatëse të cilat i bëhen me dije stafit akademik dhe studentëve (<b>Evidenca 16.7 Raporti mbi rezultatet e formularit të studentit 21-22 sem D</b>). Gjithashtu konstatohet se institucioni mban kontakte të vazhdueshme me studentët e diplomuar (ALUMNI), në funksion të thithjes së sugjerimeve për përmirësimin e programeve të studimit dhe përshtatshmërinë e tyre me tregun e punës. (<a href="https://umb.edu.al/news1166.html">https://umb.edu.al/news1166.html</a>)</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.</p>	<p>Programi i studimit Master Profesional “Mësuesi në Arte” është hapur në vitin akademik 2022-2023. Kësisoj gjykojmë që, normalisht, ky program pasi të ketë diplomuar studentët mund të ndërmarrë, nëse e shikon të arsyeshme, hapa konkretë për përmirësimin/përditësimin e tij. Gjithsesi, bazuar në dokumentacionin e paraqitur, vërehet se ky program studimi është hapur në përgjigje të nevojës së tregut të punës për mësues të arteve (<b>Evidenca 4 Studimi i tregut të punës dhe studimi periodik pas daljes së studentëve</b>). Në fakt, programi i studimit synon të adresojë një problematikë e cila ka ardhur në përkeqësim gjatë viteve të fundit. Shkurtimi drastik i aplikuar ndaj lëndëve të artit (kryesisht muzikë dhe art pamor) në arsimin parauniversitar, përpos (mos) formimit gjysmak që i rezervon nxënësve ka krijuar një vështirësi të jashtëzakonshme në adresimin e tregut të punës për mësuesit e muzikës dhe vizatimit. Rrjedhimisht një pjesë e mësuesve duhet të aktivizohen në disa shkolla njëkohësisht për të plotësuar normën, çka sjell mungesë motivimi tek mësuesit dhe pamundësi në rritjen e nivelit. Ky program studimi adreson pjesërisht këtë problematikë duke u munduar të sigurojë një formim gjithëpërfshirës për artin pamor, skenik dhe atë muzikor.</p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>GVJ në bazë të dokumentave të vëna në dispozicion nga UniBA dhe në bazë të takimeve të zhvilluara gjatë vizitës në institucion, konstaton se universiteti “Barleti” nxit përfshirjen e studentëve, partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.</i></p>



Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

## Standardi II.6

### Programi i studimit garanton orientim në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Programi i studimit përcakton qartë prioritetet dhe objektivat kryesorë të studimit dhe kërkimit shkencor në përputhje me objektivat madhorë të institucionit.</p>	<p>Objektivat e programit të studimit janë parashikuar në rregulloren e këtij programi (<b>Evidenca 3 rregullore e programit të studimit MP Mësuesi në Arte</b>) Neni 3. Kryesisht, bazuar në objektivat e parashtruara, programi i studimit synon aftësimin e studentit në mësimdhënie cilësore dhe profesionalizëm psiko-pedagogjik në adresimin e problematikave që mund të shfaqen gjatë instruktimit të nxënësve. Objektivat e këtij programi janë paraqitur kryesisht në terma teknikë të cilat gjithsesi qartësojnë formimin e një mësuesi të aftë dhe të gatshëm për të përballuar kërkesat e tregut të punës. Nisur nga sa më sipër vërehet që programi i studimit përputhet me objektivat e Universitetit “Barleti” të parashtruara në strategjinë e tij (<b>Evidenca 10 Strategjia e Zhvillimit Institucional 2020-2030</b>) në atë që konsiderohet:</p> <p><i>-Shtylla akademike dhe Shtylla e studentit në qendër.</i></p> <p>Për më tepër programi i studimit i përcakton prioritetet e tij në përputhje me misionin e Universitetit “Barleti” sipas përcaktimeve në strategjinë e sipërpërmendur.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Njësia kryesore/bazë nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore ose artistike, duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik dhe fushën e veçantë të studimit.</p>	<p>Fakulteti i Shkencave Sociale Turizmit dhe Sportit, sikurse dhe Departamenti i Shkencave të Edukimit dhe Trajnimit Profesional, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies dhe veprimtaritë kërkimore duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik. Më konkretisht bazuar në rregulloren e universitetit Rregulloren e Universitetit “Barleti”, Neni. 24, përgjegjësi i departamentit ka detyrimin e administrimit të programit të studimit. Ndërkohë në funksion të një menaxhimi sa më efektiv, spas parashikimeve të Neni. 25 të së njëjtës rregullore, institucioni ka parashikuar edhe angazhimin e Koordinatorit të Departamentit i cili asiston përgjegjësin e departamentit në proceset administruese (<b>Evidenca 1.2 Rregullore e UNIBA</b>).</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Programi i studimit mundëson, nxit dhe motivon studentët të angazhohen në studime,</p>	<p>Universiteti “Barleti” ka siguruar një sërë mekanizmash për motivimin dhe rritjen e angazhimit të studentëve. Ndër më të spikaturat janë klubet studentore si :</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Klubi i Sipermarresit Barletas;</li> </ul>

<p>projekte dhe aktivitete kërkimore.</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Klubi i Mjekesise;</li> <li>• Klubi i Karrierës;</li> <li>• Klubi i Artit dhe Kulturës;</li> <li>• Klubi i Librit dhe Medias;</li> <li>• Klubi i Psikologjisë;</li> <li>• Klubi i Arkitekteve Barletas;</li> <li>• Klubi Ligj dhe Qeverisje;</li> <li>• Klubi i Vullnetarëve;</li> <li>• Klubi i Sportit dhe Rekreacionit;</li> <li>• Klubi ICT.</li> </ul> <p><b>(Evidenca 20.2 Strategjia e klubeve studentore)</b>  Aktiviteti i këtyre klubeve synon:  - Të motivojnë sipërmarrësit e rinj  - Të shkëmbejnë ide  - Të strukturojnë idenë e tyre  - Të punojë mbi një plan biznesi  - Të prezantojnë idenë përpara një jurie, sipërmarrësve potencial, etj  - Të nisin një biznes  - Të propozojnë zgjidhje për probleme që shtrohen nga institucione partnere të universitetit, (case study), etj.  Njëherazi studentëve ju ofrohen një sërë leksionesh të hapura dhe trajnimesh.  <a href="https://umb.edu.al/news5526.html">https://umb.edu.al/news5526.html</a></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore e shkencore, njësia bazë mbështetet financiarisht nga institucioni dhe administron të ardhurat nga aktivitete të ndryshme.</p>	<p>Universiteti “Barleti” gjatë vitit akademik realizon një sërë veprimtarish në kuadër të sigurimit të rritjes profesionale të stafit akademik dhe promovimit të kërkimit shkencor. Në këto aktivitete, të financuara nga vetë universiteti ose të fituara nëpërmjet projekteve të ndryshme, ofrohet pjesëmarrje për stafin akademik <b>(Evidenca 32.a Lista e konferencave dhe workshop-eve)</b> <a href="http://mb.edu.al/news5099.html#">mb.edu.al/news5099.html#</a>.  Njëherazi programet e shkëmbimeve Erasmus+, krijojnë hapësira për stafin akademik, të cilët mund të shkëmbejnë mendime rreth produkteve të kërkimit shkencor me kolegë nga Universitetet e tjera. <b>(Evidenca 32.b Lista e aktiviteteve ndërmobëtare).</b>  Konkretisht Universiteti “Barleti” ka mbështetur fakultetet dhe departamentet e tij me shkëmbime me Universitetin South Bohemia, Sakarya University etj.</p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>GVJ në bazë të dokumentave të vëna në dispozicion nga UniBA dhe në bazë të takimeve të zhvilluara gjatë vizitës në institucion,</i></p>




	<i>konstaton programi i studimit garanton orientimin në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

### Standardi II.7

#### Programi i studimit garanton njohuri të thelluara, ndërkombëtarizim dhe kërkim shkencor.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Njësia përgjegjëse mbështet grupet lëndore dhe projektet kërkimore-shkencore të reja dhe siguron bashkëpunimin me struktura të tjera kërkimore për realizimin e objektivave të programit të studimit në kërkim shkencor.	<p>Sikurse është përmendur edhe më sipër, diplomat Master Profesional kërkojnë një vëmendje të shtuar në lidhje me formimin praktik të studentit. Kësisoj, Universiteti “Barleti”, dëshmon se ka nënshkruar një sërë marrëveshjesh me disa institucione për aftësimin praktik të studentëve të shumë programeve mes të cilëve dhe programi i studimit Master Profesional “Mësuesi në Arte” <b>(Evidenca 22 Lista e marrëveshjeve të partneritetit në funksion të programit të studimit)</b>. Gjithashtu institucioni dëshmon vëmendjen e veçantë ndaj një sërë veprimtarish në funksion të arritjes së objektivave të programit të studimit. Një pjesë e mirë e tyre dëshmohet nëpërmjet Raportit Vjetor të Punës së Departamentit <b>(Evidenca 21 raporti vjetor i departamentit për vitin akademik 2022-2023)</b>, ndërkohë që parashikimet e mbështetjes së punës kërkimore-shkencore janë të përfaqësuara edhe në strategjinë e zhvillimit të institucionit <b>(Evidenca 10 Strategjia e Zhvillimit Institucional 2020-2030)</b>. Universiteti, veç sa më sipër, ka nënshkruar gjithashtu një sërë marrëveshjesh me institucione të ndryshme në funksion të mbështetjes së veprimtarisë kërkimore në kuadër të të cilave janë realizuar aktivitete të orientuara drejt mësimdhënies si :</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Inovacioni në Edukimin Digjital;</li> <li>• Gjithpërfshirja dhe roli i mësuesit ndihmës;</li> <li>• Gjithpërfshirja në arsim</li> </ul> <p><b>(Evidenca 32.b Lista e aktiviteteve ndërmobëtare).</b></p>
<b>Kriteri 2.</b> Njësia përgjegjëse angazhohet për t’iu përgjigjur kërkesave për analiza, studime e projekte me karakter kërkimor shkencor dhe angazhon personelin akademik dhe	<p>Universiteti “Barleti” është i angazhuar në veprimtari të kërkimit shkencor dhe një sërë veprimtarish të tjera nëpërmjet Fakulteteve dhe Departamenteve të tyre por edhe nëpërmjet organizmave të tjera të ngritura nga ky institucion si:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Instituti i Kërkim Zhvillimit “Barleti” IKZHB (BIRD)</li> <li>- Instituti Shqiptar i Çështjeve Publike ISHÇP (AIPA)</li> </ul>




<p>studentët për realizimin e këtyre objektivave.</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Instituti i Edukimit “Barleti” IEB (BEI)</li> <li>- Instituti ADRIAPOL Kërkim, Zhvillim, Rritje, Inovacion</li> <li>- Qendra YOUTH ACT</li> <li>- Shoqata “Barleti”</li> </ul> <p>Stafi akademik i universitetit angazhohet vazhdimisht në veprimtarinë e instituteve të sipërpërmendura, ndërkohë që nga ky universitet janë fituar një sërë projektesh ku ofrohet ekspertiza e stafit akademik. Ndër më të rëndësishmit është edhe ofrimi i programit të shkollës së drejtorëve, projekt ky i financuar nga Fondacioni Shqiptaro-Amerikan i Zhvillimit (AADF).</p> <p><b>(Evidenca 21 raporti vjetor i departamentit për vitin akademik 2022-2023)</b></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Në fushën e programit të studimit, njësia përgjegjëse organizon konferenca ose aktivitete, të cilat ndihmojnë personelin dhe studentët për arritjen e objektivave.</p>	<p>Referuar vizitës së Grupit të Vlerësimit të Jashtëm pranë Universiteti “Barleti” sikurse dhe dokumentacionit të dorëzuar, rezulton se Departamenti i Shkencave të Edukimit dhe Trajnimit Profesional, prej të cilit organizohet programi i studimit, organizon një sërë aktiviteteve me fokus rritjen e kapaciteteve të stafit akademik dhe të ofertës formuese për studentët. Aktivitetet e zhvilluara nga departamenti realizohen kryesisht bazuar në marrëveshje ndërinstitucionale ose projekte të ndryshme mes të cilave evidentojmë marrëveshjet Erasmus + të cilat kanë mundësuar mobilitetin e stafit akademik dhe studentëve. <b>(Evidenca 32.c Të dhënat mbi mobilitetin e stafit dhe studentëve).</b> Njëherazi po kaq të rëndësishme janë edhe aktivitetet, si programi i shkollës së drejtorëve, sikurse dhe konferencat e mbajtura me angazhimin e departamentit <b>(Evidenca 21 raporti vjetor i departamentit për vitin akademik 2022-2023).</b></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Programi i studimit formon profesionistë konkurrues për tregun kombëtar dhe ndërkombëtar të punës.</p>	<p>Bazuar në të dhënat e planit mësimor të programit të studimit <b>(Evidenca 2.1.a Tabelat e planit mësimor MPMA sipas veprimtarive)</b> Master Profesional “Mësuesi në Arte”, studentët e diplomuar do të jenë të aftë të adresojnë qartë një sërë problematikash lidhur me mësimdhënien dhe mësimnxënien. Kjo mbështetet në evidentimin e disa lëndëve kyçe për formimin e mësuesve të çdo fushe, si Psikologji Edukimi, Metodatat e kërkimit në edukim, TIK në mësimdhënie dhe të nxënë etj.</p> <p><i>Gjithsesi, mbetemi të bindur se, në mënyrë që studentët e këtij programi të kenë një formim sa më profesional në fushat e arteve, duhet të ndërmerret një rishikim i planit mësimor me synim</i></p>






	<i>përfshirjen e disa lëndëve që aftësojnë studentët në formimin artistik (sipas fushave përkatëse).</i>			
<b>Kriteri 5.</b> Njësia përgjegjëse merr parasysh dhe zbaton rekomandimet e nxjerra nga urdhrat, shoqatat profesionale, rrjetet profesionale, për kompetencat e nevojshme për marrjen e licencës së profesionit përkatës, sipas akteve ligjore të fushës.	Programi i studimit “Mësuesi në Arte” synon formimin e profesionistëve të mësimdhënies në arte skenike, pamore dhe muzike. Si i tillë, ky program formon profesionistë të cilët do të ushtrojnë profesionin e rregulluar të mësuesit i cili i nënshtrohet parashikimeve të Ligjit Nr.69/2012 <i>Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë</i> i ndryshuar. Njëherazi përmbajtja e programit të studimit, lëndët formuese dhe detyrimet përmbyllëse janë hartuar në përputhje me Ligjin Nr. 80/2015 <i>Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë</i> Neni. 75, pika 6 dhe Neni. 83, pika 3. Ndërkohë kemi sugjeruar që Universiteti “Barleti duhet të paraqesë një model ku të bazojë pretendimin e ngjashmërisë së programit të studimit në masën 80% me një program të ngjashëm, sipas parashikimit të Pikës 4 në nenin e sipërpërmendur të Ligjit 80/2015.			
<b>Kriteri 6.</b> Programi i studimit për profesionet e rregulluara përputhet me aktet ligjore në vend dhe rekomandimet ndërkombëtare në direktiva dhe rregullore të Bashkimit Evropian (p.sh. <i>Professional Qualifications Directive, 2005/36/EU</i> ).	Programi i studimit, bazuar në parshikimet e Universitetit “Barleti” dhe në dokumentacionin e dorëzuar është hartuar në përputhshmëri me Ligjin Nr.69/2012 <i>Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë</i> i ndryshuar dhe Ligjin Nr. 80/2015 <i>Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë</i> .			
<b>Konkluzione</b>	<i>GVJ në bazë të dokumentave të vëna në dispozicion nga UniBA dhe në bazë të takimeve të zhvilluara gjatë vizitës në institucion, konstaton se programi i studimit garanton njohuri të thelluara, ndërkombëtarizim dhe kërkim shkencor.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II</b>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	



### III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

<b>Standardi III.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënit dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira, me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/ esetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.</p>	<p>Format e mësimdhënies në programin e studimit “Mësuesi në Arte” janë parashikuar në Rregulloren e programit të studimit Neni.11 (<b>Evidenca 3 Rregullore e programit MP mësuesi në Arte</b>) mbështetur në VKM Nr. 41, datë 24.01.2018 të ndryshuar. Në implementimin e formës së mësimdhënies është marrë parasysh:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• lloji dhe përmbajtja e lëndës;</li> <li>• efikasiteti në transmetim;</li> <li>• përmbushja e njohurive dhe kompetencave të synuara;</li> <li>• përmbajtja e programit të lëndës (syllabusi).</li> </ul> <p>Secila prej formave të mësimdhënies respekton procedurën duke pasur në qendër të vëmendjes studentin. Zhvillimi i mësimit, referuar planit mësimor (<b>Evidenca 2.1.b Plani mësimor për programin e studimit</b>) dhe Syllabuseve të Lëndëve (<b>Evidenca 2.6 Promgramet lëndore Syllabuset</b>) aplikohet në format si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Leksioni është shpjegimi i materialit mësimor nga profesori, në përputhje me programin e miratuar</li> <li>• Seminari shërben për të aftësuar studentët të mësojnë në mënyrë aktive dhe efektive. Gjatë seminarit lektori pyet, stimulon, aktivizon dhe ndërvepron me studentët duke përdorur forma të ndryshme dhe teknikat e mësimdhënies;</li> <li>• Detyra kursi të cilat organizohen në formën e bashkëbisedimeve për të stimuluar ndërveprimin mes studentëve.</li> </ul>
<p><b>Kriteri 2.</b> Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi</p>	<p>Personeli akademik është përgjegjës për zhvillimin e procesit mësimor dhe realizimin e kontrollit të dijeve për lëndët që i përcaktohen në çdo fillim viti akademik nga përgjegjësi i Njësisë Bazë. Format e mësimdhënies për secilën prej lëndëve përbërëse të planit mësimor, parashikohet në programin e lëndës (Syllabusi) (<b>Evidenca 2.6 Promgramet lëndore Syllabuset</b>). Format e</p>



<p>alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.</p>	<p>mësimdhënies në këtë program studimi janë parashikuar në rregulloren e tij Neni 11 (<b>Evidenca 3 Rregullore e programit MP mësuesi në Arte</b>). Ndër format e parashikuara të mësimdhënies janë leksione, seminare, detyra kursi, prezantime, projekte kërkimore, praktika etj.</p> <p>Pra sikurse vërehet edhe nga rregullorja e programit të studimit, personelit akademik i është dhënë mundësia e aplikimit të një sërë teknikave të larmishme për mësimdhënien dhe mësimnxënien.</p> <p>Gjithashtu, gjatë vizitës së GVJ në ambientet e Universitetit “Barleti” u vërejt që institucioni ishte i pajisuar me teknologjinë e nevojshme, çka i jep stafit akademik mundësinë për të përdorur metoda inovative në transmetimin e dijes përgjatë procesit mësimor.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit.</p>	<p>Universiteti “Barleti” aplikon një sërë metodash për rritjen profesionale dhe përmirësimin e aftësive mësimdhënëse të stafit akademik. Pikë së pari është për tu vlerësuar iniciativa shumë pozitive për hartimin e një Udhëzuesi për Metodën e Mësimdhënies. Ky udhëzues është një dokument i hollësishëm për metodat më efektive të mësimdhënies me synim transmetimin sa me të qartë të dijeve nga pedagogu tek studenti. Si i tillë, Udhëzuesi përbën një element orientues mjaft me vlerë sidomos për pedagogët e rinj (<b>Evidenca 11 Udhëzues për metodat e mësimdhënies</b>). Për më tepër Universiteti “Barleti” ka siguruar një sërë bashkëpunimesh në funksion të shkëmbimit të stafeve pedagogjike me institucione të tjera të arsimit të lartë, kryesisht jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë. Këto bashkëpunime janë realizuar, kryesisht, në kuadër të programit Erasmus +, ndërkohë që mjaft pedagogë kanë mundur të sigurojnë ballafaqimin e teknikave të tyre mësimdhënëse pranë auditorëve të tjerë (<b>Evidenca 32.c Të dhëna mbi mobilitetin e stafit dhe studentëve</b>). Një praktikë e tillë sigurisht që ka përfitime të mëdha për stafin akademik, të cilat mund të aplikohen më vonë me përfitues të drejtpërdrejtë studentin. Njëherazi institucioni aplikon edhe metoda të tjera për vlerësimin e stafit akademik, atë që GVB e quan teknika “peer to peer”, të cilat materializohen në Formularin e Vlerësimit Peer to Peer (<b>Evidenca 16.5 Formulari Peer Evaluation of Teaching</b>). Nëpërmjet kësaj metode, pedagogët vlerësojnë mësimdhënien e njëri-tjetrit nëpërmjet pyetjeve të orientuara në varësi të informacionit që dëshirohet të merret. Në modelin e paraqitur, dëshmohet se vlerësimi mes</p>



	kolegësh nis prej mënyrës së hartimit të Syllabusit e deri të teknikat e mësimdhënies.
<p><b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë.</p> <p>Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>Stafi akademik i angazhuar në mësimdhëni për programin Master Profesional “Mësuesi në Arte” zotëron gradat dhe titujt, në përputhje me legjislacionin në fuqi (<b>Evidenca Tabelat përmbledhëse MP Marte</b>). Njëkohësisht bazuar në CV e stafit akademik (<b>Evidenca 7.1 CV e stafit akademik 2022-2024</b>) pedagogët e anghazhuar në këtë program studimi kanë eksperiencën dhe formimin e duhur akademik.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Njësia përgjegjëse për ofrimin e progamit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>Njësia Bazë Departamenti i Shkencave të Edukimit dhe Trajnimit Profesional, sikurse është specifikuar edhe më sipër, përdor një sërë metodash për vlerësimin e mësimdhënies dhe marrjen e masave për përmirësimin e tij. Ndër këto metoda evidentojmë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Vlerësimi i studentëve për lëndën (<b>Evidenca 2.4 Formular vlerësimi i studentëve për lëndën</b>). Konkretisht hartohet një formular ku studenti ka të drejtën të japë vlerësimet dhe sugjerimet e tij për lëndë specifike.</li> <li>• Vlerësimi i mësimdhënies ndërmjet kolegëve (<b>Evidenca 16.5 Formulari Peer Evaluation for Teaching</b>). Formulari i vlerësimit Peer Evaluation of Teaching shërben si një mjet për të thithur mendimin e stafit akademik për mësimdhënien në një lëndë të caktuar.</li> </ul>
<p><b>Kriteri 6.</b> Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të</p>	<p>Universiteti “Barleti” aplikon disa metoda për përmirësimin e aftësive mësimdhënëse të stafit akademik. Pikë së pari është për tu vlerësuar iniciativa shumë pozitive për hartimin e një Udhëzuesi për Metodatat e Mësimdhënies. Ky udhëzues është një dokument i hollësishëm për metodatat më efektive të mësimdhënies me synim transmetimin sa më të qartë të dijeve nga pedagogu tek studentit. Si i tillë, Udhëzuesi përbën një element orientues mjaft me vlerësidomos për pedagogët e rinj (<b>Evidenca 11 Udhëzues për metodatat e mësimdhënies</b>). Gjithashtu, stafi akademik</p>



<p>cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.</p>	<p>inkurajohet të marrë pjesë në konferenca të ndryshme në funksion të rritjes profesionale e rrjedhimisht edhe përmirësimit të aftësive mësimdhënëse. Po ashtu Universiteti “Barleti” promovon stafin e tij akademik në aktivitete të shkëmbimeve profesionale mes stafeve akademike, kryesisht në kuadër të programit Erasmus +. Organizimi i veprimtarive të tjera, mes të cilave evidentohet Shkolla e Drejtorëve, është një tjetër investim i drejtpërdrejtë i Departamentit të Shkencave të Edukimit dhe Trajnimit Profesional në rritjen profesionale të stafeve akademike dhe përmirësimit të aftësive mësimdhënëse (<b>Evidenca 21 Raporti vjetor i departamentit për vitin akademik 2022-2023</b>).</p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>GVJ në bazë të dokumentave të vëna në dispozicion nga UniBA dhe në bazë të takimeve të zhvilluara gjatë vizitës në institucion, konstaton se Universiteti Barleti garanton procesin e të nxënit dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira, me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

**Standardi III.2**

**Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore dhe garanton zbatimin e tyre.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.</p>	<p>Në rregulloren e programit të studimit Master Profesional “Mësuesi në Arte” Neni. 17, (<b>Evidenca 3 Rregullore e programit MP Mësuesi në Arte</b>) janë përcaktuar mënyrat e vlerësimit të njohurive që studentët zotërojnë në përfundim të lëndës/lëndëve të programit. Për të siguruar vlerësimin e studentëve janë parshikuar një sërë parametrash si: Provim me shkrim, me gojë dhe i kombinuar, detyra kursi, projekte etj. Gjithashtu në të njëjtën rregullore është përcaktuar edhe vlerësimi me pikë dhe konvertimi i tyre në notë. Njëherazi vlen për tu theksuar se Universiteti “Barleti” ka siguruar përcaktimin e vlerësimit të çdo lënde edhe në syllabuset e lëndëve specifike (<b>Evidenca 2.6 Programet lëndore Syllabuset</b>). Bazuar në modelin e MAS, në syllabus janë përcaktuar në mënyrë të detajuar, kriteret që duhet të përmbushë studenti për frekuentimin e lëndës dhe përqindja e vlerësimit të çdo detyrimi. Rregulloret e</p>



	Universitetit "Barleti" janë lehtësisht të verifikueshme nga studentët apo çdo i interesuar tjetër <a href="https://umb.edu.al/dossier-uniba.html">https://umb.edu.al/dossier-uniba.html</a> .			
<b>Kriteri 2.</b> Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Gjatë vizitës së mbajtur në Universitetin "Barleti", grupi i vlerësimit të jashtëm pati mundësinë të intervistonte qoftë drejtues të Fakultetit dhe Departamentit pranë të cilit zhvillohet ky program, qoftë pedagogë ligjërues në lëndët e këtij programi sikurse dhe studentë. Të gjithë të intervistuarit konfirmuan se studentëve iu bëheshin me dije të gjitha detyrimet, mënyrat e vlerësimit, kriteret sikurse dhe metodologjitë e përdorura në vlerësim.			
<b>Kriteri 3.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.	Në syllabusin e lëndëve, sikurse përmendëm edhe më sipër, janë parashikuar një sërë mënyrash të diversifikuara për vlerësimin e studentit ( <b>Evidenca 2.6 Programet lëndore Syllabuset</b> ). Format më të shpeshta për vlerësimin e studentit, sipas parashikimeve të verifikuara në syllabuset e lëndëve janë: <ul style="list-style-type: none"> <li>• Provimi i ndërmjetëm (në masën 20%);</li> <li>• Aktivizimi në orën e mësimit (në masën 10%);</li> <li>• Detyrat e kursit (në masën 20%);</li> <li>• Provimi përfundimtar (në masën 50%).</li> </ul>			
<b>Konkluzione</b>	<i>GVJ në bazë të dokumentave të vëna në dispozicion nga UniBA dhe në bazë të takimeve të zhvilluara gjatë vizitës në institucion, konstaton se Universiteti "Barleti" harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore dhe garanton zbatimin e tyre.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

### Standardi III.3

**Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin	Vlerësimi i studentit kryhet në mënyrë të vazhdueshme dhe shtrihet përgjatë gjithë vitit akademik. Mënyra e vlerësimit të studentit dhe pesha që zë secili element, si pjesë e shumatores së vlerësimit me notën përfundimtare, përcaktohen në programin e lëndës (syllabus). Qoftë mënyra e vlerësimit e qoftë raporti mes

<p>përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>elementëve përbërës, është specifike për çdo lëndë por në përgjithësi provimet zënë 70% të vlerësimit dhe detyrat e kursit, sikurse dhe aktivizimi i studentit zënë 30% të vlerësimit përfundimtar. Të gjitha format e vlerësimeve të pjesëshme, të zhvilluara përgjatë vitit akademik, sikurse dhe vlerësimi përfundimtar, janë hartuar në përputhje me parashikimet e rregullores së studimit për programin Master Profesional “Mësuesi në Arte” dhe rregulloret e tjera të institucionit. <b>(Evidenca 3, Evidenca 2.6, Evidenca 1.2 të sipërcituara).</b></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.</p>	<p>Gjatë vizitës së kryer në Universitetin “Barleti”, grupit të vlerësimit të jashtë ju pohua nga stafi akademik dhe drejtuesit se Universiteti “Barleti”, gjatë kohës së funksionimit të sistemit të mësimdhënies online nëpërmjet Google Classroom, Google Meet dhe Zoom, janë aplikuar testime online. Në fakt në dokumentacionin e dorëzuar, rezulton të jetë hartuar një Manual për sistemin Google Classroom. <b>(Evidenca 36 Manuali i përdorimit të Google Classroom për pedagogët).</b></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.</p>	<p>Forma e vlerësimit përfundimtar për lëndët e programit të studimit Master Profesional në “Mësuesi në Arte” janë parashikuar në rregulloren e programit të studimit Neni 17 <b>(Evidenca 3 Rregullore e programit MP Mësuesi në Arte)</b> sikurse dhe në syllabusin e secilës prej lëndëve <b>(Evidenca 2.6 Programet lëndore Syllabuset)</b>. Pedagogu i lëndës vlerëson përfundimisht studentin, në përputhje me parashikimet e rregullores së programit të studimit dhe programit të lëndës (syllabusit), bazuar në:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Vlerësimet e pjesëshme të sigurara përgjatë vitit akademik;</li> <li>2. Vlerësimin e komisionit, ose pedagogut sipas parashikimeve të Nenit 19 të rregullores së programit të studimit, në provimin përfundimtar.</li> </ol> <p>Vlerësimi i punimit të diplomës realizohet në përputhje me parashikimet e rregullores së studimit Neni. 22. Praktikat profesionale vlerësohen nga pedagogu i ngarkuar me monitorimin e praktikave dhe koordinatori i institucionit pritës <b>(Evidenca 2.3 UniBa paketa e praktikës Master).</b></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me</p>	<p>Universiteti Barleti ka hartuar një Udhëzues për Mësimdhënien dhe të Nxënërit në Shkollën e Lartë <b>(Evidenca 11 Udhëzues për metodat e mësimdhënies)</b>. Nëpërmjet këtij dokumenti është krijuar një mundësi shumë e mirë për orientimin e pedagogëve në mësimdhënie dhe metodologjitë e përdorura, sikurse dhe në</p>

<p>këshilla mbi procesin e të nxënit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>	<p>mënyrën e diversifikuar të vlerësimit të studentit. Manuali orienton stafin akademik që të diskutojë me studentët arsyet e vlerësimit duke ndikuar ndjeshëm në ndërgjegjësimin e tyre rreth rezultateve.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.</p>	<p>Universiteti “Barleti” dhe Fakulteti i Shkencave Sociale, Turizmit dhe Sporteve, nëpërmjet rregulloreve të miratuara dhe kodit të etikës (<b>Evidenca 33 Kodi i Etikës</b>), ka marrë të gjitha masat për të minimizuar kopjimin gjatë provimit dhe plagjiaturën e detyrave dhe temave të diplomës. Masat e marra parashikojnë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Miratimin e tezave të provimit nga përgjegjësi i departamentit, çka shmang favorizimet e mundshme.</li> <li>• Sekretimin e provimit me shkrim për të ruajtur anonimatën e studentit dhe favorizimet e mundshme.</li> </ul> <p>Për më tepër rregullorja e Universitetit Barleti Neni. 111 (<b>Evidenca 1.2 Rregullore e UNIBA</b>) konsideron shkelje të rëndë, mes të tjerash, edhe plagjiaturën. Për më tepër, Universiteti Barleti është i detyruar ti përmbahet parashikimeve të VKM Nr. 879, datë 18.12.2019.</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.</p>	<p>Vlerësimi përfundimtar i studentit përcaktohet bazuar në një sërë kriteresh sipas parashikimeve në rregulloren e programit të studimit dhe syllabusit. Gjithashtu, rregullorja (<b>Evidenca 3 Rregullore e programit Mp Mësuesi në Arte</b>) Neni. 21 parashikon qartë se brenda 5 (pesë) ditësh nga mbajtja e provimit përfundimtar, ose detyrës së kursit, pedagogu duhet të dorëzojë në sekretari procesverbalin e vlerësimit.</p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t’u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.</p>	<p>Në të gjitha format e organizimit të provimit, studenti merr vlerësimin përkatës nga komisioni jo më vonë se 5 (pesë) ditë pune nga data e dhënies së provimit. Komisioni/pedagogu, sipas raportimeve gjatë vizitës në institucion, shpall rezultatet e vlerësimit, para plotësimit të dokumentacionit përkatës në mënyrë që të studenti të vihet në dijeni në lidhje me vlerësimin e bërë, duke ballafaquar përgjigjet e dokumentuar të studentit me tezën e zgjidhur. Studenti ka të drejtë të sqarohet për çdo paqartësi nga ana e tij, dhe/ ose të kontestojë rezultatin e marrë (<b>Evidenca 1.2 Rregullore e UNIBA</b>) sipas parashikimeve të Rregullores së Universitetit Barleti Neni 89, 90 . Në rastet e kontestimit të rezultatit, përgjegjësia e zhvillimit të procedurës së ankimimit i takon përgjegjësit të departamentit dhe dekanit.</p>
<p><b>Kriteri 8.</b> Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më</p>	<p>Bazuar në parashikimet e Regullores së Universitetit “Barleti” (<b>Evidenca 1.2 Rregullore e UNIBA</b>) , ankimimi i studentit nuk shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit provimit. Gjithsesi, në po të</p>

<p>pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.</p>	<p>njëjtën rregullore është parashikuar një procedurë e detajuar përsa i përket shqyrtimit të ankesave. Në rastet kur studenti nuk është dakort me vlerësimin përfundimtar të komisionit, ka të drejtë të ankohet tek përgjegjësi i departamentit dhe nëse ky i fundit nuk ofron zgjidhjen e duhur, mund ti drejtohet dekanit i cili ndjek procedurat sipas parashikimeve të Rregullores së Universitetit “Barleti” Neni. 90.</p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>GVJ në bazë të dokumentave të vëna në dispozicion nga UniBA dhe në bazë të takimeve të zhvilluara gjatë vizitës në institucion, konstaton se Universiteti “Barleti” siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

**Standardi III.4**

**Programi i studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët dhe synojnë zhvillimin e thelluar të kompetencave profesionale e shkencore tek studentët.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta shkencore të studentëve.</p>	<p>Programi i studimit Master Profesional “Mësuesi në Arte” është hartuar si një vazhdimësi llogjike e thellimit të njohurive të siguruar nga studenti në Ciklin e Parë Bachelor, në programe të fushës së arteve. Ky program realizohet me 120 kredite dhe kohëzgjatja normale e tij është 2 vite. Sikurse është parashtruar edhe më sipër, përmbajta e planit mësimor (<b>Evidenca 2.1b Plani Mësimor për programin e studimit</b>) dhe programi i lëndëve të tij (<b>Evidenca 2.6 Programet lëndore Syllabuset</b>), të organizuara në përputhje me VKM Nr. 41 të ndryshuar, zhvillojnë aftësitë profesionale të studentit sikurse dhe ato teorike-shkencore në fushën e mësimdhënies sikurse dhe krijojnë mundësi për qasje më të shpejt drejt tregut të punës. Kësisoj vazhdimësia e thellimit të njohurive në raport me ciklin e parë, në vija të përgjithshme, është e zbatueshme edhe për studentë që mund të vijnë nga vende të tjera dhe plotësojnë kushtet e regjistrimit në konkurs.</p> <p>Programi i studimit Master Profesional “Mësuesi në Arte” thëllon aftësitë e studentit duke rritur kapacitetin e tyre profesional në:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Përgatitjen e mësuesve për arsimin parauniversitar në fushat e arteve;</li> </ul>





	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Përgatitjen e studentëve në praktikimin e mësimdhënies në kuadrin e vlerave bazë dhe standardeve etike të profesionit të mësuesit;</li> <li>• Të ofrojë një bazë të qëndrueshme edukimi për studentët, të cilët mund të jenë të interesuar për transferimin dhe vazhdimin e studimeve në nivele të tjera të dëshiruara.</li> </ul> <p><i>Gjithsesi, konstatojmë se, bazuar edhe në Raportin e Vlerësimit të Brendshëm për këtë kriter, ky program nuk ka në përmbajtje të tij lëndë për aftësimin e a) Drejtuesit Artistik, b) Redaktorit të Muzikës, c) Konsulentit artistik, d) Punonjësit të administratës në institucionet e kulturës. Kjo për arsye se lëndët e parashikuara në Planin Mësimor i përmbahen vetëm aftësimin në mësimdhënie. Gjithashtu, ritheksojmë se , duke verifikuar dokumentacionin për kriteret hyrëse të studentëve (Evidenca 3), nuk konstatohet ndonjë preferencë apo kushtëzim për pranimin e studentëve të cilët të kenë përfunduar studimet Bachelor (apo të ngjashme) në të paktën një nga fushat e arteve, çka do të ishte një element i rëndësishëm i konfirmimit të thellimit të njohurive përsa i përket arteve. Aq më tepër që do të ishte e vështirë, edhe nëse një gjë e tillë do të ndodhte, që një student i diplomuar në Bachelor për Arte Pamore apo Skenike, në master të mund të ndiqte këtë program studimi dhe mandej të ishte i aftësuar edhe si Mësues Muzike. Rrjedhimisht gjykojmë që programi duhet ta përqëndrojë më shumë formimin e studentit në lidhje me lëndët specifike që do të japë në arsimin parauniversitar.</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).</p>	<p>Programi i studimit Master Profesional “Mësuesi në Arte” e aftëson studentin për tu zhvilluar në fushën e teknologjisë duke parashikuar lëndë konkrete në Planin Mësimor (<b>Evidenca 2.1b Plani Mësimor për programin e studimit</b>). Konkretisht pjesë e planit mësimor janë edhe lëndë si TIK në mësimdhënie dhe të nxënë.</p> <p><i>Konstatojmë që plani mësimor i këtij programi studimi nuk ka parashikuar zhvillimin e ndonjë lënde në gjuhë të huaj.</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Kompetencat dhe aftësitë që fiton studentit, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të</p>	<p>Në përfundim të zhvillimit të leksioneve, apo formave të tjera të mësimdhënies, bazuar në raportimet e stafit akademik gjatë vizitës së grupit të vlerësimit të jashtëm, realizohen përmbledhje të koncepteve bazë të fituara gjatë zhvillimit të lëndës. Stafi akademik i këtij programi një procedurë të tillë e ka përcaktuar edhe në Syllabusin e lëndës (<b>Evidenca 2.6 Programet lëndore Syllabuset</b>). Gjithashtu, sikundër e kemi përmendur edhe më lart, kompetencat, aftësimi teorik dhe praktik i studentëve</p>



<p>rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre, si dhe për detyrimet përmbyllëse.</p>	<p>kontrollohet përmes vlerësimit të vazhduar gjatë vitit për elementet e përcaktuar në programin e studimit dhe vlerësimit përfundimtar në provimet e çdo fundviti, si dhe në mbrojtjen e diplomave. Njëherazi, në raportin e vlerësimit të brendshëm, është evidentuar qartë se arrijtet dhe problematikat e hasura gjatë vitit akademik trajtohen në Raportin Vjetor të Departamentit (<b>Evidenca 21 Raporti vjetor i departamentit për vitin akademik 2022-2023</b>). Në mënyrë që hartimi i syllabuseve, organizimi i procesit mësimor dhe orientimi i studentëve në përfundim të lëndës, të jetë sa më i qartë dhe transparent, Universiteti “Barleti” ka hartuar Formularin e Vlerësimit të Mësimdhënies mes kolegëve (<b>Evidenca 16.5 Formulari Peer Evaluation for Teaching</b>) ku secili prej pedagogëve mund të vlerësojë kolegun e tij lidhur me sa më sipër.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t’u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.</p>	<p>Programi i studimit Master Profesional “Mësuesi në Arte” është ndërtuar në funksion të zhvillimit të kompetencave të përgjithshme dhe atyre të veçanta në fushën e mësimdhënies në arte. Gjatë zhvillimit të këtij programi, sipas parashikimeve të rregullores së vetë programit (<b>Evidenca 3 Rregullore e programit MP Mësuesi në Arte</b>), studenti duhet të aftësohet në:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• planifikimin dhe zhvillimin e kurrikukës së Arsimit Parauniversitar për fushat e arteve;</li> <li>• përdorimin e metodave dhe strategjive specifike për mësimdhënien në fushat e arteve;</li> <li>• aftësimin drejt metodologjive efektive për krijimin e</li> <li>• analizën dhe zbatimin në praktikë të modeleve të të nxëniet duke pasur një qasje kritike ndaj metodave të diversifikuara;</li> <li>• zbatimin në praktikë të modeleve dhe teknikave të menaxhimit të klasës;</li> <li>• përdorimin e metodave të ndryshme për motivimin e nxënësve dhe vlerësimin e dijeve të tyre;</li> </ul> <p>sikurse dhe të tjera aftësi sipas parashikimeve të Nenit 3 në rregulloren e programit të studimit.</p> <p>Zhvillimi i praktikave mësimore, nisur nga dualiteti formues i këtij programi, parashikon të mundësojë përdorimin e kompetencave të fituara gjatë procesit mësimor në një kontekst praktik profesional. Për të plotësuar kërkesat e parashikuara studentët duhet të zhvillojnë praktikë në një ose disa institucione sipas parashikimeve dhe marrëveshjeve të arritura me institucionet arsimore. Një pjesë</p>

	<p>e mirë e kompetencave të sipërpërmendura, sikurse dhe aftësi të tjera, janë përcaktuar në Paketën e Praktikës (<b>Evidenca 2.3 UniBa paketa e praktikës Master</b>) e cila është një dokument për vlerësimin e studentit praktikant. Sikurse është përmendur edhe më sipër, në këtë program studimi nuk ka pasuar mobilitet studentësh për shkak se programi ndodhet tashmë në vitin e tij të dytë.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Personeli akademik efektiv dhe me kontratë realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.</p>	<p>Universiteti “Barleti” përveç realizimit të mësimdhënies sipas parashikimeve të programit të studimit dhe syllabuseve, zhvillon një aktivitet të konsiderueshëm edhe përsa i përket mbajtjes së konferencave dhe leksioneve të hapura me pjesëmarrjen e stafit të tij akademik dhe ekspertëve jashtë universitetit. Nga dokumentacioni i shqyrtuar, referuar periudhës kur është hapur programi i studimit Master Profesional “Mësuesi në Arte”, rezultojnë të jenë mbajtur 5 aktivitete ndërkombëtare . <b>(konferenca, leksione të hapura, seminare) (Evidenca 32.a Lista e konferencave dhe workshop-eve).</b></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Institucioni nxit zhvillimin e ideve inovative, studimeve të përparuara kërkimore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato.</p>	<p>Universiteti “Barleti” vlerëson në mënyrë specifike nxitjen e ideve inovative dhe punimeve kërkimore. Lidhur me këtë, aktiviteti i këtij institucioni, ka hapur njësi specifike të cilat merren me organizimin e aktiviteteve të ndryshme. Një prej tyre është edhe Barleti Training and Testing Center (<b>Evidenca 32.e Projektet e zbatuara dhe në proces Grupi Barleti BTTC</b>) i cili zhvillon një sërë aktivitete ku mund të marrin pjesë të gjithë studentët. Trajnimet e ofruara nga kjo qendër, gjatë të cilave studentët kanë mundësi të shprehin idetë e tyre inovative dhe të avancojnë punën kërkimore, janë të fushave të ndryshme mes të cilave edhe Edukimi dhe Mësimdhënia.</p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• <i>Ky program nuk ka në përmbajtje të tij lëndë për aftësimin e a) Drejtuesit Artistik, b) Redaktorit të Muzikës, c) Konsulentit artistik, d) punonjësit të administratës në institucionet e kulturës. Kjo për arsye se lëndët e parashikuara në Planin Mësimor i përmbahen vetëm aftësimin në mësimdhënie.</i></li> <li>• <i>Gjithashtu, ritheksojmë se, duke verifikuar dokumentacionin për kriteret hyrëse të studentëve (Evidenca 3), nuk konstatohet ndonjë preferencë apo kushtëzim për pranimin e studentëve të cilët të kenë përfunduar studimet Bachelor (apo të ngjashme) në të paktën një nga fushat e arteve, çka do të ishte një elementë i rëndësishëm i konfirmimit të thellimit të njohurive përsa i përket arteve. Aq më tepër që do të ishte e vështirë, edhe</i></li> </ul>

	<p><i>nëse një gjë e tillë do të ndodhte, që një student i diplomuar në Bachelor për Arte Pamore apo Skenike, në master të mund të ndiqte këtë program studimi dhe mandej të ishte i aftësuar edhe si Mësues Muzike. Rrjedhimisht gjykojmë që programi duhet ta përqëndrojë më shumë formimin e studentit në lidhje me lëndët specifike që do të japë në arsimin parauniversitar.</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <i>Konstatojmë që plani mësimor i këtij programi studimi nuk ka parashikuar zhvillimin e ndonjë lënde për gjuhën e huaj.</i></li> </ul>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X	

<b>Standardi III.5</b>	
<b>Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton procedurë të posaçme për detyrimet përmbyllëse, para realizimit të tyre dhe i bën ato publike dhe e bën atë publike.	Detyrimet përmbyllëse në programin e studimit Master Profesional “Mësuesi në Arte” janë përcaktuar, pikë sa pari, në planin mësimor të vetë programit me 12 ECTS ( <b>Evidenca 2.1b Plani Mësimor për programin e studimit</b> ). Gjithashtu, bazuar në parashikimet e rregullores së programit të studimit Neni 16 ( <b>Evidenca 3 Rregullore e programit MP Mësuesi në Arte</b> ), studentit për të përmbyllur studimet duhet të realizojë provën finale e cila konsiston në Provim të Përgjithshëm Formimi. Kriteret për tu pranuar në provimin e përgjithshëm, parashikohen në nenin e sipërpërmendur dhe janë të verifikueshme nga të gjithë studentët. Njëherazi, Departamenti i Shkencave të Edukimit dhe Trajnimit Profesional, mbështetur në Rregulloren e programit të studimit Neni 22, 23 ka parashikuar procedurat e diplomimit.
<b>Kriteri 2.</b> Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të të detyrimeve përmbyllëse.	Në rregulloren e programit Master Profesional “Mësuesi në Arte”, institucioni ka marrë parashikuar procedurat e mbajtjes së provimeve dhe detyrimeve të tjera, përfshirë ato të lidhura me diplomimin e studentëve ( <b>Evidenca 3 Rregullore e programit MP Mësuesi në Arte</b> ). Rrjedhimisht, studentëve iu janë ofruar të gjitha mundësitë për të qenë në dijeni të detyrimeve të tyre përmbyllëse.

<p><b>Kriteri 3.</b> Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.</p>	<p><i>Në raportin e vlerësimit të brendshëm, për kriterin 2, Standardi III 5, është argumentuar se institucioni për programin e studimit Master Profesional “Mësuesi në Arte”, informon studentin në lidhje me pyetjet e provimit formues. Nga verifikimi i Evidencës shtesë 3 Rregullore për provimin e diplomimit, të përdorur si dokumentacion për justifikimin e kësaj të dhëne, rezulton se kjo Evidencë i takon programit të studimit Master Profesional në Mësuesi në “Teknologji Informacioni dhe Komunikimi”. Institucioni duhet të paraqesë të dhënat e lëndëve të provimit final për programin e studimit Master Profesional “Mësuesi në Arte”.</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik/Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi i asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e punimit përmbyllës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t’u paraqitur para komisionit.</p>	<p>Diplomimi në programin e studimit Master Profesional në “Mësuesi në Arte”, bazuar në rregulloren e programit të studimit Neni 16 (Evidenca 3 Rregullore e programit MP Mësuesi në Arte), realizohet me provim final dhe jo me temë diplome.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.</p>	<p>Diplomimi në programin e studimit Master Profesional në “Mësuesi në Arte”, bazuar në rregulloren e programit të studimit Neni 16 (Evidenca 3 Rregullore e programit MP Mësuesi në Arte), realizohet me provim final dhe jo me temë diplome.</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Në përfundim të provimit përfundimtar të përgjithshëm ose të mbrojtjes së punimit të diplomës, studentin vlerësohet me notë.</p>	<p>Në përfundim të procesit të provimit të formimit, studentin vlerësohet me notë nga komisioni i provës finale bazuar në parashikimet e rregullores së programit të studimit. Aktualisht programi i studimit Master Profesional “Mësuesi në Arte”, në kohën e dorëzimit të dokumentacionit dhe vizitës në institucion, nuk ka diplomuar ende studentët e parë për asye se, këta të fundit, duhet të diplomohen në përfundim të vitit akademik 2023-2024. Rrjedhimisht institucioni e ka pasur të pamundur të dorëzojë Evidenca për mënyrën e vlerësimit të studentëve.</p>



<p><b>Kriteri 7.</b> Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.</p>	<p>Në përfundim të studimeve, studenti që ka plotësuar të gjitha parashikimet e planit mësimor dhe ka realizuar me sukses provimin final, do të pajiset me diplomën përkatëse, të shoqëruar me suplementin e diplomës të miratuar nga senati akademik, hartuar në përputhje me Udhëzimin e MAS Nr. 11, datë 2.4.2020 <i>Për përcaktimin e përmbajtjes dhe formës së suplementit të diplomës dhe listën e rezultateve të studimeve.</i> Diploma plotësohet në zbatim me Udhëzimin nr. 25, datë 10.11.2017 <i>Për regjistrimin e formave të diplomave dhe certifikatave në regjistrin shtetëror të diplomave dhe certifikatave për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor.</i> Në përfundim të studimeve, bazuar në kërkesën e tij, studentit mund ti vihet në dipsozicion edhe një kopje e plotë e programit të studimit të zhvilluar prej tij.</p>			
<p><b>Kriteri 8.</b> Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.</p>	<p>Informacioni i veprimtarisë akademike në Universitetin “Barleti” ruhet arkivat e këtij institucioni për një afat të pacaktuar. I gjithë dokumentacioni i studentit është i mundshëm për të verifikuar sipas rastit dhe në përputhje me Ligjin Nr. 9887, datë 10.03.2008, i ndryshuar, <i>Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.</i></p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• <i>Bazuar në parashikimet e rregullores së studimit, në programin e studimit Master Profesional “Mësuesi në Arte”, studenti diplomohet me provim final. Ndërkohë në RVB është parashikuar se studenti mund të diplomohet edhe me mbrojtje teme, në varësi të notës mesatare.. Gjithashtu, në RVB përcaktohet se, diplomimi nëpërmjet hartimit të temës së diplomës mund të bëhet bazuar në një vendim specifik të Senatit Akademik.</i></li> <li>• <i>Institucioni duhet të paraqesë të dhënat e lëndëve të provimit final për programin e studimit studimit Master Profesional “Mësuesi në Arte”.</i></li> </ul>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes sëstandardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

**Standardi III.6**  
**Në rastin e programit të studimit në “Master Profesional” institucioni ndjek një procedurë të qartë të zbatimit të njohurive nëpërmjet praktikës laboratorike, praktikës profesionale, praktikave klinike dhe stazheve.**





Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Njësitë përgjegjëse, në funksion të mësimdhënies dhe përfutimit të njohurive, garantojnë mjedise brenda ose jashtë institucionit, të përshtatshme për realizimin e praktikës laboratorike, praktikës profesionale.</p>	<p>Universiteti “Barleti”, nëpërmjet dokumentacionit të dorëzuar, dëshmon se ka nënshkruar marrëveshje me rreth 30 institucione të arsimit parauniversitar (<b>Evidenca 22 Lista e marrëveshjeve të partneritetit në funksion të programit të studimit, 22.3 Lista e praktikave të studentëve</b>). Praktikave profesionale të studentëve të programit të studimit Master Profesional “Mësuesi në Arte” zhvillohen pranë këtyre institucioneve të cilët sigurojnë edhe ambientet përkatëse të përshtatshme për zhvillimin e praktikave. Në funksion të vlerësimit të praktikave profesionale, Universiteti “Barleti” ka hartuar edhe Paketën e Praktikës e cila jep të dhëna të plota për frekuentimin e praktikës nga studenti, vlerësimin e tij, vlerësimin nga pedagogu mbikëqyrës etj (<b>Evidenca 2.3 UniBa Paketa e praktikës Master</b>).</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni, në bashkëpunim dhe partneritet, garanton realizimin e praktikave klinike dhe stazheve me format dhe teknologjinë më të fundit bashkëkohore me qëllim përfutimin më mirë të njohurive dhe kompetencave profesionale.</p>	<p>Universiteti “Barleti”, nëpërmjet dokumentacionit të dorëzuar, dëshmon se ka nënshkruar marrëveshje me rreth 30 institucione të arsimit parauniversitar nënshkruar marrëveshje me rreth 30 institucione të arsimit parauniversitar (<b>Evidenca 22 Lista e marrëveshjeve të partneritetit në funksion të programit të studimit, 22.3 Lista e praktikave të studentëve</b>). Insitucionet pranë të cilave zhvillohet praktika profesionale sigurojnë teknologjinë e nevojshme si bazë materiale egzistuese në ambientet (klasat dhe laboratorët) e tyre.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Praktikave profesionale, klinike dhe stazhet e zhvilluara gjatë studimeve, ekuivalentohen në kredite dhe dokumentohen në dokumente të posaçme duke e shoqëruar me mendimin e trajnerëve dhe vlerësimin përkatës.</p>	<p>Kryerja e praktikës profesionale në programin Master Profesional “Mësuesi në Arte” vlerësohet me notë dhe kreditet përkatëse, nëse studenti përmbush të gjitha detyrimet e praktikës sipas Paketës së Praktikës (<b>Evidenca 2.3 UniBa Paketa e praktikës Master</b>). Sikurse u evidentua edhe më sipër më Paketën e Praktikës Profesionale, janë përcaktuar kriteret e vlerësimit të praktikës së studentit. Nëpërmjet këtij dokumenti sigurohet:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1) Vlerësimi i vetë studentit për praktikën;</li> <li>2) Vlerësimi i personit përgjegjës në institucionin pritës;</li> <li>3) Vlerësimi i pedagogut mbikëqyrës.</li> </ol> <p>Në përfundim të praktikës pikët e siguruara nga studenti, si rrjedhojë e vlerësimeve, konvertohen në notë. Të gjitha vlerësimet e parashikuara në Paketën e Praktikës Profesionale, janë organizuar me pyetje të orientuara.</p> <p><i>Institucioni nuk ka paraqitur një Syllabus për praktikën profesionale.</i></p>



<b>Konkluzione</b>	<i>GVJ në bazë të dokumentave të vëna në dispozicion nga UniBA dhe në bazë të takimeve të zhvilluara gjatë vizitës në institucion, konstaton se universiteti "Barleti" ndjek një procedurë të qartë të zbatimit të njohurive nëpërmjet zhvillimit të praktikave.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

#### IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

<b>Standardi IV.1</b>	
<b>Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Personeli akademik efektiv dhe me kontratë, personeli ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbush kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e duhur të kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve mësimore të programit. Ka fushë kërkimore në përputhje me programin e	<p>Për zhvillimin e programit të studimit Master Profesional (120 ECTS) në Mësuesi në Arte (MPMA) për vitin akademik 2022-2023 janë angazhuar 6 pedagogë me kohë të plotë, ndërsa për zhvillimin e programit të studimit për vitin akademik 2023-2024 janë 6 pedagogë me kohë të plotë dhe 2 me kohë të pjesshme si më poshtë:</p> <p>a) Për vitin akademik 2023-2024 janë 6 personel akademik me kohë të plotë, nga të cilët 3 me gradën Prof.As.Dr dhe 3 me gradën Dr</p> <p>b) Personel akademik me kohë të pjesshme për vitin akademik 2023-2024 janë 2 taf akademik, 1 Prof.As.Dr dhe 1 me gradën Dr.</p> <p>Gradat dhe titujt e stafit akademik përputhen me fushën e studimit, me lëndët dhe modulet. Personeli akademik i angazhuar në programin e studimit Mp. MA rezulton të jenë të angazhuar në kërkime, studime e projekte kërkimore shkencore në të cilin angazhojnë edhe student dhe personel ndihmës akademik.</p>

studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.

Mjediset e UniBa janë të përshtatshme për kryerjen e angazhimeve mësimore dhe kërkimore shkencore të personelit në mënyrë profesionale, bazuar në profilin e programit të studimit, natyrës dhe veçorive të lëndëve dhe moduleve që mbulon secili punonjës.

Kualifikimi i stafit akademik për programin MPMA	2022-2023		2023-2024	
	PAE	PAK	PAE	PAK
Prof.Dr.	-		-	-
Prof. Asoc.	2		3	1
Dr./PhD.	3		3	1
MSc.	1		-	-
<b>Totali</b>	<b>6</b>	<b>0</b>	<b>6</b>	<b>2</b>

[Evidenca 31.1. Të dhëna për infrastrukturën]

**Kriteri 2.** Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.

Zyra e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore ka në fokusin dhe detyrat e saj hartimin e politikave e strategjive për mirëfunksionimin e BNj, si dhe rekrutimin e një stafi të kualifikuar në përputhje me politikat e organizatës dhe legjislacionin në fuqi, sikurse dhe zbatimin e procedurave insitucionale [Evidenca 41. Ligji Nr. 80/2015, dt. 22.07.2015 Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë] dhe aktet e brendshme rregullatore lidhur me punësimin e stafit.

[Evidenca 7: Manuali i Menaxhimit të Burimeve Njerëzore].

Në Departamentin e Shkencave të Edukimit dhe Trajnimit Profesional, për zhvillimin e programit të studimit Master Profesional (120 ECTS) në Mësuesi në Arte (MPMA) janë 6 pedagogë me kohë të plotë dhe 2 pedagogë me kohë të pjesshme. Personeli i punësuar me kohë të plotë përbën 87.5% të personelit akademik të angazhuar dhe specifikisht:

Personel akademik efektiv janë 3 personel akademik me titullin Prof. Asoc. Dr dhe 3 me gradën DR, 1 personel akademik me kohë



	<p>të pjesshme PAK janë dy, një me titullin Prof. Asoc. Dr, dhe një me gradën shkencore Dr.</p> <p>UniBa ka angazhuar personel ndihmës mësimor shkencor për realizimin e orëve të ushtrimeve, laboratorëve, etj. Personeli administrativ dhe akademik është gjithmonë në shërbim të studentëve për të siguruar mbarëvajtjen e procesit mësimor.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.</p>	<p>UniBa garanton dhe dëshmon qëndrueshmërinë e personelit akademik efektiv të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit. Ai bazohet në Ligjin Nr.80/2015 datë 22.07.2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, Kodin e Punës së Republikës së Shqipërisë, Ligji për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë.</p> <p>Për rekrutimin e personelit, institucioni harton procedura e kritere specifike bazuar edhe në “manualin e menaxhimit të burimeve njerëzore”, procedura të cilat administrohen nga drejtoria e burimeve njerëzore dhe bëhen publike në faqen zyrtare të UniBa.</p> <p><a href="https://umb.edu.al/news5146.html">https://umb.edu.al/news5146.html</a></p> <p><i>[Evidenca 34. Të dhëna nga faqja zyrtare web e UniBa. Shpallja e vendeve të lira].</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>UniBa harton dhe zbaton procedura për rekrutimin e personelit akademik, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore.</p> <p>Njësia bazë evidenton nevojat çdo fillim viti akademik dhe këto kërkesa depozitohen pranë zyrës së burimeve njerëzore, e cila pas miratimit i publikon në faqen zyrtare, bazuar në kriteret e përgjithshme dhe specifike të punësimit të personelit akademik në përputhje me natyrën, strukturën, lëndët mësimore dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p> <p>UniBa ndjek gjithashtu një politikë vlerësimi të performancës që mat rezultatet e punës në raport me standardet dhe qëllimet e cila realizohet mbi krietet dhe procedurat e përcaktuara në dokumentacionin e brendshëm rregullativ. Stafi akademik është i punësuar sipas përcaktimeve të kuadrit ligjor në fuqi dhe akteve rregullatore të brendshme të institucionit.</p> <p><i>[Evidenca 7. Manuali i Menaxhimit të Burimeve Njerëzore].</i></p> <p><i>[Evidenca 12: Rregullore për Vlerësimin dhe Administrimin e Performancës].</i></p>



<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.</p>	<p>UniBa siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe ushtrimore si edhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore në programin e studimit të ciklit të dytë Master profesional” (120 ECTS) në “Mësuesi në Arte”, (MPMA)</p> <p>Pjesë përbërëse e programit të studimit dhe specifikës së tij është edhe angazhimi i personeli ndihmës akademik, të cilët zotërojnë aftësitë e nevojshme profesionale për vëndin përkatës të punës. Personeli ndihmës akademik dhe administrativ është në shërbim të studentëve dhe në përmbushjen e objektivave të programit të studimit në “Mësuesi në Arte”, (MPMA).</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.</p>	<p>Të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit mbledhen, ruhen dhe përditësohen rregullisht dhe janë të detajuara përsa i përket përfshirjes së anëtarëve të personelit akademik të angazhuar në program, të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.</p> <p>Zyra e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore është struktura përgjegjëse për mbledhjen, ruajtjen dhe përditësimin e të dhënave të personelit akademik, ndihmës-akademik dhe administrativ parashikuar në rregulloren e saj.</p> <p><b>[Evidenca 7. Manuali i Menaxhimit të Burimeve Njerëzore].</b></p> <p>Këto të dhëna përfshijnë CV e personelit, kartën e identitetit, pozicionin e punës, diplomat dhe listat e notave, gradat shkencore dhe titujt akademik, dëshmi të gjuhëve të huaja, dëshmi të trajnimeve dhe kualifikimeve të ndryshme, dëshmi penaliteti, raport mjeko ligjor etj.</p> <p><b>[Evidenca 7.4. Formati i dosjes personale</b></p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën</p>	<p>Një element i rëndësishëm i procesit mësimor janë praktikat profesionale.</p> <p>Institucioni e ka të rregulluar me akte të brendshme zhvillimin e praktikave profesionale dhe ka nënshkruar marrëveshje të posaçme për realizimin e praktikave profesionale për programin e studimit, me institucione në të cilat studentët mund të kryesjnë praktikat profesionale. Mbikëqyrja bëhet nga anëtarët e stafit akademik të cilët ndjekin zhvillimin korrekt të praktikës dhe japin vlerësimin përkatës.</p> <p><b>[Evidenca 2.3 UniBa Paketa e praktikës]</b></p>

<p>profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>Për zhvillimin e saj më mënyrë efektive UniBa ngarkon kryesisht personel akademik me kohë të plotë si përgjegjës të mbarvajtjes së këtij procesi. Të gjithë studentët pajisen me elementët e rregullores së praktikës profesionale që është një udhërrëfyes për zhvillimin e praktikës dhe vlerësimin e saj.</p> <p>UniBa ka përmbytur detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme, me karakter mësimor, për realizimin e praktikave mësimore. Plani mësimor i programit të studimit MPMA si dhe Rregullorja e Programit të studimit përcakton qartë detyrimet përmbyllëse.</p> <p><i>[Evidenca 2.3 UniBa Paketa e praktikës]</i></p> <p>Bazuar në aktet rregullatore të brendshme institucionale dhe të programit të studimit, studentët e ciklit të dytë të studimeve MPMA, diplomohen me provim të përgjithshëm përfundimtar i cili mbikëqyret dhe realizohet nga anëtarët e stafit akademik, që kanë detyrë të përgatisin një fond pyetjesh dhe pas miratimit nga njësia bazë, ja përcjell studentëve për tu përgatitur. Procesi zhvillohet sipas programit të miratuar.</p> <p><i>[Evidenca 2.4. Fondi i pyetjeve provim formimi MPMA]</i></p> <p><i>[Evidenca 2.3: UniBa Paketa e praktikës]</i></p> <p><b>Evidenca shtese 3. Rregullore për provimin e diplomimit</b></p>
<p><b>Kriter 8.</b> Personeli mbikqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbyshjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimin të tyre për praktikën profesionale.</p>	<p>Personeli mbikqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale (drejtuese, mësuese të arsimit parauniversitar, ekspertë, etj) në bazë të marrëveshjeve të realizuara, i cili ndihmon studentët në përmbyshjen e detyrimeve, në hartimin e raportit përfundimtar të praktikës si edhe është pjesë e procesit të vlerësimin të studentëve për praktikën profesionale përmes një protokollit të konsoliduar në këtë drejtim.</p> <p>Pedagogu i praktikës viziton institucionin pritës katër herë gjatë periudhës së praktikës, por nqs është e nevojshme dhe kërkohet nga studenti, realizohen takime të tjera përveç atyre të planifikuara.</p> <p>Në fund të praktikës studenti dorëzon raportin e praktikës sipas formatit dhe vlerësimi realizohet sipas evidencës 2.3, dhe përfshin raportin e praktikës të hartuar nga studenti, vlerësimin e mbikëqyrësit të institucionit pritës dhe vlerësimin e pedagogut përgjegjës.</p> <p><i>[Evidenca 2.3. UniBa Paketa e praktikës]</i></p>



	<p><i>[Evidenca 27. Raporti i mbledhjes se departamentit, dt. 21.09.2022, caktimi i udhëheqësve të praktikës]</i></p> <p><i>[Evidenca 27.1. Komunikime me stafin për zhvillimin e mbledhjeve të departamentit]</i></p>			
<b>Konkluzione</b>	<p><i>GVJ në bazë të dokumentave të vëna në dispozicion nga UniBA dhe në bazë të takimeve të zhvilluara gjatë vizitës në institucion, konstaton se programi Master Profesional në “Mësuesi në Arte”, ka personel akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur.</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi IV.2</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.</p>	<p>Institucioni ushtron aktivitetin e tij në 2 (dy) godina universitare dhe zotëron kushtet optimale në infrastrukturë dhe logjistikë për zhvillimin e mësimdhënies, trajnimeve dhe çdo nevojë tjetër. Korpusi është ndërtuar me materiale cilësore bashkëkohore të cilat plotësojnë kushtet higjieno-sanitare për studentët dhe personelin akademik e administrativ dhe standartet teknike, si dhe të gjitha ambientet ofrojnë akustikë të mirë dhe janë të izoluara nga zhurmat, luhatjet e temperaturës dhe lagështirës. Sallat kanë hapësirën e nevojshme për të ushtruar mësimdhënien komode për studentët. UniBa i plotëson normativat teknike të ndriçimit natyral dhe ndriçimi është i orientuar nga krahu i majtë i studentit, dhe lartësia e ambienteve është jo më e vogël se 3.0 m (tavan-dysheme). Çdo godinë është e pajisur me sinjalizues dhe në hollin e godinës së korpusit janë të instaluar bombola kundra zjarrit si dhe hidratantë, të cilët janë të shoqëruar edhe me sinjalistikën përkatëse. Institucioni siguron në salla dhe zyra sisteme ajri të kondicionuar, përmes sistemin të ngrohjes së centralizuar. Godina garanton kushte infrastrukturore bashkëkohore, në aspektin teknik dhe didaktik.</p> <p><i>[Evidenca 31:Raport i ekspertit për infrastrukturën]</i></p> <p><i>[Evidenca 31.1:Të dhëna për infrastrukturën.Planimetria ]</i></p> <p><i>[Evidenca 31: Raporti i ekspertit për infrastrukturën]</i></p>

	<b>[Evidenca 31.1: Të dhëna për infrastrukturën. Planimetria ]</b>
<b>Kriteri 2.</b> Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies- mësimnxënies.	Për realizimin e programit të studimit UniBa në mjediset mësimore si klasa, laboratorë, si dhe mjedise të tjera për personelin akademik dhe mndihmës akademik janë vendosur pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që kanë akses të plotë në rrjetin WIFI, në ndihmë të përgatitjes, dhe të realizimit të procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies- mësimnxënies. Të gjithë auditorët janë të pajisur me smartboard dhe sisteme projektimi digjital. I gjithë kampusi është i pasur me të gjitha pajisjet e nevojshme elektronike dhe të teknologjisë së informacionit. <b>[Evidenca 31, Raporti i ekspertit për infrastrukturën]</b> <b>[Evidenca 31.1. Te dhena per infrastrukturen.Planimetria]</b>
<b>Kriteri 3.</b> Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.	Për plotësimin e kërkesave të lëndëve mësimore, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit janë në dispozicion jo vetëm mjediset didaktike dhe laboratorike sipas llojit dhe profilit të degës por edhe të njësive të tjera ku zhvillohen aktivitete nga personeli i angazhuar në këtë program studimi. Zhvillimi i programeve lëndore nga personeli akademik janë konform të gjitha standardeve të kërkuara. UniBa gjithashtu ka ndërtuar faqen <u>Barleti Online</u> ku pasqyron të gjithë agjendën e trajnimeve dhe aktivitetet të karakterit akademik të zhvilluara. <b>[Evidenca 31, Raporti i ekspertit për infrastrukturën]</b> <b>[Evidenca 31.1. Të dhëna për infrastrukturën.Planimetria]</b> UniBa ka hartuar gjithashtu manualin për zhvillimin e procesit mësimdhënës online. <b>[Evidenca 39 a. Manual i mësimdhënies online]</b> <b>[Evidenca 36. Të dhëna nga faqja zyrtare web - Barleti online]</b>
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.	Për realizimin e programit të studimit UniBa siguron 3 laboratorë të karakterit pedagogjik që janë në funksion dhe mbështetje të studentëve, të cilët janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit dhe kanë akses të plotë në rrjet dhe WiFi Internet. Ato kanë në dispozicion edhe videoprojektor në kuadër të ilustrimit dhe shpjegimit për pedagogun dhe studentin, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodave teknologjike bashkëkohore të mësimdhënies dhe mësimnxënies.



	[Evidenca 31, Raporti i ekspertit për infrastrukturën] [Evidenca 31.1. Të dhëna për infrastrukturën.Planimetria]			
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera (vërtetuar nëpërmjet marrëveshjeve të posaçme të bashkëpunimit), që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike. Në rastet e programeve të studimit në fushën mjekësore, institucioni duhet të sigurojë strukturat spitalore dhe ambulatorore me kapacitetet e nevojshme.	Një element i rëndësishëm i procesit mësimor janë praktikat profesionale për të cilat UniBa vendos në dispozicion një listë me shkolla publike dhe private si edhe zyra arsimore në të cilat studentët mund të kryesjnë praktikat profesionale. Programi i studimit në strukturën e tij ka në vitin e dytë praktikë profesionale, e cila për nga specifika zhvillohet në mjediset shkollore të arsimit parauniversitar apo institucione arsimore. Bazuar në marrëveshjet e nënshkruara, praktikat mësimore të studentëve kryhen pranë institucioneve të arsimit parauniversitar, pra jashtë mjediseve të UniBa. Për realizimin e saj janë në dispozicion marrëveshjet institucionale dhe korespondencën e vazhdueshme institucionale.  [Evidenca 31, Raporti i ekspertit për infrastrukturën] [Evidenca 31.1. Të dhëna për infrastrukturën.Planimetria]			
<b>Konkluzione</b>	GVJ në bazë të dokumentave të vëna në dispozicion nga UniBA dhe në bazë të takimeve të zhvilluara gjatë vizitës në institucion, konstaton se mjediset mësimore dhe infrastruktura e vënë në dispozicion janë të përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit Master Profesional në "Mësues në Arte" dhe për formimin praktik të studentëve në përputhje me natyrën dhe fushën e programit të studimit.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

### Standardi IV.3

Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).



Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.</p>	<p>Literatura bazë e detyrueshme përbëhet nga tekstet mësimore dhe ciklet e leksioneve. Literatura bazë dhe ndihmëse e lëndëve që i përkasin fushës së edukimit ofrohet kryesisht në gjuhën shqipe ose cikle leksionesh të përgatitura nga lektorët mbi bazën e eksperiencave të universiteteve partnere brenda dhe jashtë vendit. Syllabuset të zhvilluara në këtë program studimi, azhurnohen çdo fillim viti akademik duke përcaktuar literaturën më të përditësuar. Literatura bazë dhe ndihmëse miratohet nga Njësia Bazë me propozimin e titullarit/pedagogut të lëndës. Kjo literaturë e cila ofrohet kryesisht në gjuhën shqipe pasqyrohet në programet lëndore dhe u vihet në dispozicion studentëve në formë fizike dhe/ose elektronike, dhe garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme të parashikuara në këtë program studimi. Gjithashtu dhe fondi i literaturës fizike dhe online gjendet në bibliotekë.</p> <p><i>[Evidenca 2.6. Programet lëndore (Syllabuset)]</i>  <i>[Evidenca 30: Lista e teksteve/periodikëve në Bibliotekë në funksion të programit të studimit]</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësimin të literaturës me botime të viteve të fundit.</p>	<p>Njësia bazë, përpara miratimit të buxhetit vjetor institucional, paraqet propozimin e tij për përditësimin e literaturës me botime të viteve të fundit. Propozimet e Njesisë Bazë miratohen sipas procedurave përkatëse të Institucionit. Edhe Biblioteka paraqet kërkesat e saj për pasurimin e fondit të saj në çdo fillim viti akademik. Përveç pasurimit periodik, literatura e bibliotekës pasurohet edhe përmes donacioneve të shtëpisë botuese Dudaj dhe partnerëve të tjerë.</p> <p><i>[Evidenca 30.b. Kërkesë për tituj librash DSHETP]</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.</p>	<p>UniBa vë në dispozicion të studentëve dhe personelit akademik, në mbështetje të procesit mësimor dhe dhe formimit të tyre profesional. Biblioteka është e plotë nga pikëpamja e numrit të librave që vë në dispozicion dhe disponon 1 sallë leximi, të pajisur me kompjutera dhe me mjete audio vizive. Biblioteka ka një fond librash në gjuhën shqipe dhe gjuhë të huaj, në të cilat gjendet një numër tekstesh të fushës së programit të studimit. Biblioteka shërben edhe si sallë interneti me gjithë mjetet e nevojshme ku janë ofruar mundësi për lexime të qeta apo leximi dhe punë në grup. Sistemi i menaxhimit dhe kontrollimit të librit nëpërmjet platformës digjitale mundëson depozitimin total të titujve që disponojë dhe kategorizimin e librave sipas fushave përkatëse. Të gjithë studentët kanë mundësi të barabarta në përdorimin e saj. Literatura mësimore mund të</p>

	<p>shfrytëzohet në ambientet e bibliotekës ose dhe jashtë saj. Studenti disponon një kartelë personale digjitale të përdoruesit, përmes të cilës siguron literaturën. UniBa ka vënë në dispozicion edhe përdorimin e librarive elektronike ku studentët mund të shfrytëzojnë edhe materiale ndërkombëtare.</p> <p><i>[Evidenca 31, Raporti i ekspertit për infrastrukturën]</i></p> <p><i>[Evidenca 31.1. Te dhena per infrastrukturen.Planimetria]</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikes së programit të studimit.</p>	<p>Biblioteka Shkencore i ofron koleksionet dhe shërbimet e saj nëpërmjet</p> <p>Mjediseve si:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Salla me fond të hapur. Salla është komode dhe është në shërbim të plotë të studenteve, pedagogëve, e studiuesve çdo ditë të javës, nga ora 9:00 - 20:00. Në kompjuterat e saj janë instaluar programe specifike për disiplinat e studimit, ku studentët studiojnë. Salla me fond të hapur ofron: literaturë referenciale, periodikun, literaturë print, literaturë prej burimeve elektronike të bibliotekës; literaturë prej burimeve elektronike të huaja; akses në internet.</li> <li>- Fondi i mbyllur. Fondi i mbyllur ofron: Literaturë në gjuhë të huaj, revista, gazeta, fjalorë dhe enciklopedi, arshivën akademike, arshivën digjitale.</li> <li>- Fondi i bibliotekës pasurohet me tituj të rinj nga donatorë të huaj dhe vendas, shtëpia botuese partnere Dudaj apo autorë.</li> </ul> <p>Literatura e ofruar, përmes Bibliotekës është multidisiplinare, pasi në të gjenden tituj nga fusha të ndryshme. UniBa ka vënë në dispozicion përdorimin e librarive elektronike ku studentët mund të konsultohen me materiale ndërkombëtare.</p> <p><i>[Evidenca 30: Lista e teksteve/periodikëve në Bibliotekë në funksion të programit të studimit.]</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.</p>	<p>Studentët dhe stafi akademik kanë të drejtën e shfrytëzimit falas të mjediseve dhe fondit të bibliotekës. Studentët dhe stafi akademik që janë përdorues të bibliotekës pajisen me kartelën individuale. Biblioteka është e pajisur me fotokopje që ofrohet falas për fotokopje e printime në interes të studentëve.</p> <p><i>[Evidenca 30.a. Të dhëna të plota për platformat online të Bibliotekës]</i></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë</p>	<p>Spektori i Informatikës mundëson integrimin e teknologjisë së informacionit në Bibliotekën Shkencore. Ai administron dhe kujdeset për funksionimin e mirë të rrjetit të bibliotekës, si dhe funksionimin të Hardware dhe Softwaret e të gjithë kompjuterave që disponon biblioteka.</p>



shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.	Në bibliotekë funksionon sistemi qëndror i Arkives Dixhitale, i cili është i lidhur me serverin online të bibliotekës duke mundësuar arkivimin dhe ruajtjen në format elektronik të fondit të Bibliotekës, si edhe servirjen e këtij fondi nëpërmjet portalit web. <i>[Evidenca 30.c. Platforma e bibliotekës online]</i>
<b>Kriteri 7.</b> Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.	Biblioteka është e hapur çdo ditë në orarin 09.00 – 20.00 Këto orare bëjnë të mundur që biblioteka të aksesohet nga të gjithë studentët sipas mundësive dhe nevojave. Në këto orare biblioteka plotëson maksimalisht kërkesat dhe nevojat për t'iu përgjigjur çdo studentit të interesuar. Biblioteka ka një përgjegjës të angazhuar me menaxhimin dhe koordinimin e bibliotekës fizike dhe digjitale.
<b>Kriteri 8.</b> Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.	Institucioni e ka të rregulluar me akte të brendshme funksionimin e bibliotekës. Njësitë përgjegjëse ka detyrë të ndjekë dhe raportojë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallës së studimit, duke nxjerrë në pah cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik duke hulumtuar mbi domosdoshmërinë që ka ekzistenca e literaturës përkatëse në bibliotekë <i>[Evidenca 30.b. Kërkesë për tituj librash DSHETP]</i> <i>[Evidenca 30: Lista e teksteve/periodikëve në Bibliotekë në funksion të programit të studimit.]</i>
<b>Konkluzione</b>	GVJ në bazë të dokumentave të vëna në dispozicion nga UniBA dhe në bazë të takimeve të zhvilluara gjatë vizitës në institucion,



	<i>konstaton se programi i studimit Master Profesional në "Mësues në Arte" përmban literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjediset të posaçme).</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

#### Standardi IV.4

**Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	UniBa disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve. Departamenti disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve. Të dhënat e studentëve dhe e gjithë ecuria e tyre gjatë ndjekjes së programit të studimit mbahen nga Sekretaria Mësimore dhe hidhen në regjistrin themeltar dhe në regjistrin e programit mësimor përkatës. Sekretaria ruan të dhënat në versionin fizik dhe i hedh elektronikisht në siflstem. Sekretaria mësimore administron regjistrin themeltar të studentëve; regjistrin e arritjeve akademike; regjistrin e lëshimit të diplomave dhe certifikatave.
<b>Kriteri 2.</b> Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.	UniBa disponon të dhëna të detajuara, si përsa i përket ngarkesës mësimore të stafit akademik me kohë të plotë ose jo që është i angazhuar në mësimdhënie. Menaxhimi i dokumentacionit të personelit akademik, ndihmës akademik dhe administrativ realizohet nga sistemi i brendshëm i menaxhimit, ky sistem përbëhet nga departamenti i burimeve njerëzore, sekretaria mësimore, bordet e Karrierës, koordinatori Menaxhimit të Performancës dhe zyra e Menaxhimit të Logjistikës dhe Operacioneve. Çdo dokumentacion ruhet dhe arkivohet me kujdes dhe sektori përkatës ka çdo evidencë si: ngarkesën vjetore mësimore, marrëveshjet e realizimit të kohës vjetore të punës, syllabuset etj. Departamenti i Burimeve Njerëzore mban dosjet e personelit me kohë të plotë, me të gjithë informacionin e duhur: CV, diploma

	<p>universitare, diploma grada shkencore, dëshmi tituj akademikë, vërtetime punësimi, etj. Gjithashtu, mban edhe dosjet e personelit me kohë të pjesshme, me të gjithë informacionin e duhur: CV, diploma universitare, diploma grada shkencore, dëshmi tituj akademikë, vërtetime punësimi, kontrata, etj.</p> <p>Procesi i rekrutimit të stafit është gjithashtu i dokumentuar dhe ruhet në Departamentin e Burimeve Njerëzore.</p> <p>Spektori i kërkimit shkencor dhe marrëdhënieve me jashtë administron dhe përditëson bazën e të dhënave të kërkimit shkencor të personelit akademik dhe kërkimor.</p> <p>Këto njësi me anë të koordinimit në kuadër të funksioneve, përgjegjësi dhe ndërveprimit me njera tjetren, realizojnë të gjitha proceset, aktivitetet dhe veprimtaritë e domosdoshme të administrimit të institucionit.</p> <p><b>Evidenca: "Shared" Intranet <u>shared on '192.168.1.3'</u></b>  <b>[Evidenca 7.1. Dosja-pedagog i brendshëm]</b></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Studentët kanë akses në informacion që lidhet me: kurrikulën e detajuar mësimore, listën e notave dhe kreditet, orarin mësimor, mungesat, faturat dhe pagesat e kryera, regjistrimi në provime. Stafi akademik hedh të dhëna dhe ka akses lidhur me procesin e vlerësimit të studentëve, plotësimin e listëprezencës së tyre dhe listën e studentëve që ndjekin kursin.</p> <p>Çdo personel akademik e ndihmës akademik (sekretaria mësimore) ka akses në llogarinë e tij ku shfaqen të dhëna rreth lëndëve, sezoneve të provimeve, oraret e tyre dhe listën e studentëve që janë regjistruar për të frekuentuar këto lëndë. Ndërsa studentët mund të aksesojnë informacione dhe të dhëna rreth statusit të tyre, lëndëve që mund të frekuentojnë, vlerësimet e çdo forme kontrolli në çdo lëndë etj. Secili përdorues e menaxhon në mënyrë të pavarur llogarinë e tij. Gjithashtu informacionet dhe dokumentacionet në lidhje me programin e studimit si Rregullore e programit të studimit, Misioni i programit të studimit, plani mësimor, struktura mësimore, oraret mësimore etj janë në faqen zyrtare web të universitetit.</p> <p><b>[Evidenca: "Shared" Intranet <u>shared on '192.168.1.3'</u></b></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit</p>	<p>Sistemi i komunikimit dhe format e komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve përfshijnë përveç faqes Web dhe postës elektronike zyrtare edhe platformat elektronike si: Google Classroom, Google Meet, Teams etj. Ky komunikim realizohet edhe në kontaktet</p>

të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.	individuale të personalizuar të pedagogut dhe studentëve, sekretarisë apo koordinatorëve të programeve me studentët. <i>[Evidenca 36.b. Manuali i përdorimit të Google Classroom për studentët]</i> <i>[Evidenca 36.c. UniBa-google-classroom-manual-pedagogu]</i>			
<b>Kriteri 5.</b> Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.	UniBa bën analizën vjetore të veprimitarisë së aktivitetit akademik e administrativ të institucionit. Njësia bazë monitoron dhe raporton veprimtarinë shkencore të stafit akademik si edhe realizon raportime të rregullta mujore lidhur me veprimtarinë e tij drejt titullarit direkt, burimeve njerëzore dhe zyrës së performancës. Platformat elektronike gjithashtu garantojnë monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese. Sipas nevojave, këto sisteme mundësojnë raportime individuale mbi ecurinë akademike të studentëve, pagesën e tarifës së studimit, monitorimin dhe afatet e hedhjes së vlerësimeve nga ana e personelit akademik etj			
<b>Kriteri 6.</b> Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.	Faqet zyrtare të internetit të institucionit janë të përditësuara me të gjithë informacionin në kohë reale. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen zyrtare të internetit të UniBa dhe rrjetet sociale përkatëse si Facebook, Instagram, YoutUniBa, Twitter në gjuhën shqipe dhe angleze. <a href="http://www.umb.edu.al">www.umb.edu.al</a> ; <a href="http://www.ieb.edu.al">www.ieb.edu.al</a> ; <a href="http://www.bttc.edu.al">www.bttc.edu.al</a>			
<b>Konkluzione</b>	<i>GVJ në bazë të dokumentave të vëna në dispozicion nga UniBA dhe në bazë të takimeve të zhvilluara gjatë vizitës në institucion, konstaton se, UniBA disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit Master Profesional "Mësuesi në Arte".</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

**Standardi IV.5**

**Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.</p>	<p>UniBa harton çdo vit një raport financiar të kostove dhe mbështetjes financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit i mbështetur në raportet financiare të nevojave dhe të të ardhurave që vijnë nga njësitë bazë mbi programet e studimit që ato mbulojnë. Njësia Bazë ka për detyrë të paraqesë në dekanat kërkesën për përmbushjen e nevojave financiare të njësisë bazë lidhur me programet e studimit.</p> <p>Projekt buxheti vjetor hartohet mbi bazën e propozimeve të njësive kryesore dhe njësive bazë, mbështetur në planin strategjik të zhvillimit të UniBa</p> <p><i>[Evidenca 38: Të dhëna, Plani i financimit të programit të studimit]</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.</p>	<p>Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit përmban financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.</p> <p><i>[Evidenca 40.a. Burimet Financiare UniBa]</i></p>





<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.</p>	<p>Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij, për çdo vit. Auditit vlerëson efikasitetin financiar dhe mbarëvajtjen afatgjatë institucionale, për një administrim të kujdesshëm në zëra të të ardhurave dhe shpenzimeve, duke i paraprirë në këtë formë çdo problematike. <i>[Evidenca 39: Të dhëna nga Raporti financiar vjetor institucional]</i></p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.</p>	<p>Institucioni ka krijuar zinxhirin hierarkik të raportimit, në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi, institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike. Kjo formë raportimi evidenton nevojat, si dhe jep konkluzione mbi rezultatet e financimit të programit të studimit. Ndihmon në vendosjen e pritshmërive dhe planifikimet në vijim. <i>[Evidenca 39: Të dhëna nga Raporti financiar vjetor institucional]</i></p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programeve të studimeve.</p>	<p>Institucioni ka ngritur strukturat e duhura dhe zotëron të ardhurat e nevojshme që garantojnë qëndrueshmërinë financiare. Zbaton procedura dhe ndjek procese vendimmarrje dhe bën auditim të rregullt lidhur me situatën e qëndrueshmërisë financiare të programeve të studimit. Burimet e financimit janë tarifata e studentëve, të ardhura nga projekte, të ardhura nga donacione, dhe të ardhurat nga shërbime të tjera që ofron institucioni. Më qëllim mirë menaxhimit të këtyre fondeve dhe sigurimit të një qëndrueshmërie financiare, gjatë analizës financiare vjetore shqyrtohet edhe realizimi i treguesve mbi zbatimin e politikës financiare të vet institucionit. <i>[Evidencë: 39: Të dhëna nga Raporti financiar vjetor institucional]</i></p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>GVJ në bazë të dokumentave të vëna në dispozicion nga UniBA dhe në bazë të takimeve të zhvilluara gjatë vizitës në institucion, konstaton se, UniBA garanton me risk financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit Master Profesional "Mësuesi në Arte" UniBA duhet në vazhdim të garantojë një numër minimal 10(dhjetë) të studentëve për çdo vit akademik</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

## V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

### Standardi V.1

**Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.</p>	<p>Universiteti “Barleti” prezantohet me vizionin strategjik, pararojë në mësimdhënie dhe në kërkimin shkencor, i aftë të udhëheqë studentët në tregun e punës, si dhe i aftë të përballojë sfidat e bashkësisë shkencore ndërkombëtare.</p> <p>Harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore Ligjin nr. 80/2015 si dhe VKM nr. 41, dt. 24.01.2018 ndryshuar me VKM nr. 879, dt. 18.12.2019, statutin e institucionit, rregulloren akademike UniBA, rregulloren e programit të studimit. Pranimet e studentëve bëhen në përputhje me standardet shtetërore, të kapaciteteve akademike dhe infrastrukturore, kuotave dhe kriterëve të propozuara nga Njësia bazë si dhe legjislacionin në fuqi.</p> <p>Kohëzgjatja normale e studimeve në programin Master Profesional (120 ECTS) “Mësuesi në Arte” (MPMA) është 2 (dy) vite akademike. Programi i studimit është i organizuar në lëndë dhe i vlerësuar me kredite sipas Sistemit European të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS) Programi i referohet nivelit 7-të të Kornizës Shqiptare të Kualifikimit. Studenti në përfundim të programit të studimit duhet të grumbullojë 120 kredite. Studentët në programet e ciklit të dytë të studimeve diplomohen me provim përfundimtar Në përfundim të programeve të ciklit të dytë lëshohet diploma: Diplomë universitare Master Profesional (120 ECTS) “Mësuesi në Arte”.</p> <p><i>[Evidenca 1.2. Rregullore e Universitetit Barleti]</i></p>



<p><b>Kriteri 2.</b> Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Barazia dhe të drejtat e njëjta në hyrje, për të gjithë kandidatët, garantohen nga zbatimi i kuadrit ligjor dhe akteve të brendshme rregullatore të insitucionit. Procesi dhe procedurat e ndjekura në përcaktimin e kriterëve të pranimit në të gjitha ciklet janë të përcaktuara në Statutin dhe në rregulloret e programeve të studimit. Statuti i Universitetit “Barleti” përshkruan qartë kriteret e pranimit të studentëve në ciklin e dytë të studimeve si dhe të drejtat dhe detyrimet e studentëve gjatë studimeve universitare, të cilat udhëhiqen nga parimi i barazisë. Rregullorja e Universitetit, rregullore e programit, manuali i bursave e të gjithë aktet e tjera rregullatore të UniBa-s. përmbajnë në mënyrë të detajuar procedurat dhe praktikrat e trajtimit të studentëve që nga regjistrimi i tyre, e deri në përfundim të studimeve, apo procedurat dhe praktikrat e transferimit të tyre, gjë që garanton qartësisht politika dhe procedura transparente për trajtim të barabartë dhe të drejtë për të gjithë kandidatët dhe studentët e programit Master Profesional” Mësuesi në Arte” (MPMA).</p> <p>[Evidenca 1.1.Statuti i Universitetit “Barleti”, Kreu VI]; [Evidenca 1.2. Rregullore e Universitetit “Barleti”, Kreu IX] [Evidenca 3 . Rregullore e Programit MPMA]</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t’u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse.</p>	<p>Institucioni harton kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t’u pranuar në programin e studimeve, duke ndjekur procedurat standarde dhe duke zbatuar të gjitha shkallët hierarkike të vendimmarrjes. Kriteret përcaktohen duke u bazuar në kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi Institucioni dokumenton të gjitha hapat dhe vendimet e marra lidhur me kriteret e pranimit të studentëve dhe ato janë lehtësisht të aksesueshme, transparente dhe publike.</p> <p><i>[Evidenca 20.6. Vendim Senati - Kriteret e pranimit të studentëve në 2022-2023 dhe 2023-2024]</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së</p>	<p>Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë të aksesueshme lehtësisht dhe janë transparente për publikun. Pranimi studentëve realizohet sipas sistemit meritë-</p>

<p>studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>preferencë ku kriteret e studimit të ofruara nga UniBa u bëhen të ditura paraprakisht kandidatëve për studentë në faqen zyrtare. Universiteti vë në dispozicion të aplikantëve zyrat e veta të informacionit dhe është shumë aktiv me njoftime në web dhe media sociale. Në faqen zyrtare publikohen edhe kriteret e pranimit, të përcaktuara për program të dytë studimi. <i>[Evidenca 20.6. - Kriteret e pranimit të studentëve në 2022-2023 dhe 2023-2024]</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.</p>	<p>Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon studentët dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit. dhe publikohen në faqen zyrtare të institucionit dhe në portalin U-Albania. UniBa përditëson sipas udhëzimeve dhe V.K.M-ve përkatëse portalin U-Albania në sesionin “Kriteret e Pranimit” i cili është i aksesueshëm nga të gjithë të interesuarit. Universiteti nëpërmjet zyrës së Alumnit, sekretarisë dhe njësisë bazë, realizojnë komunikimin me publikun e interesuar për ndjekjen e programit Master nëpërmjet disa formave Kriteret e pranimit të studentëve në çdo program studimi propozohen nga departamenti dhe miratohen me vendim Senati. <i>[Evidenca 20.6. Vendim Senati - Kriteret e pranimit të studentëve në 2020-2023 dhe 2023-2024]</i></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.</p>	<p>Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara. Në programin e studimit Master Profesional (120 ECTS) “Mësuesi në Arte” (MPMA) nuk ka studentë me aftësi të veçanta apo nga shtresat e marginalizuara dhe pakicat.</p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.</p>	<p>Në përgjithësi, institucioni parashikon aplikim nga kandidatë nga shtete të tjera, kriteri është njohja e diplomës paraardhëse në MAS. Për programin e studimit Master Profesional (120 ECTS) “Mësuesi në Arte”, UniBa parashikon kuotat të veçanta për regjistrimin e shqiptarëve nga trojet dhe nuk parashikon kriteret shtesë, përpos atyre që përcaktojnë aktet ligjore e nënligjore në fuqi. <i>[Evidenca 20.6. Vendim Senati - Kriteret e pranimit të studentëve në 2022-2023 dhe 2023-2024]</i></p>
<p><b>Kriteri 8.</b> Institucioni harton politika të</p>	<p>Institucioni ka objektiv strategjik edhe aplikimin e parimeve të barazisë, të gjithëpërfshirjes dhe diversitetit si edhe trajtimin e</p>



<p>ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.</p>	<p>studentëve me bursa financiare të plota ose të pjesshme duke pasur parasysh studentët nga grupet vulnerabël dhe bazuar në kriteret e përcaktuara në aktet e brendshme normative dhe në përputhje me legjislacionin përkatës në fuqi.</p> <p>Në planin strategjik parashikohet që universiteti do të gjejë burimet financiare për vendosjen e bursave dhe stimujve të tjerë për studentët më të mirë. Miratimi përfundimtar i bursave bëhet nga Bordi i Administrimit dhe organizohet me qëllim vlerësimin e aplikimeve nga komisione ad hoc.</p> <p><i>[Evidenca 1.2. Rregullorja e Universitetit Barleti, Neni 84]</i></p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>GVJ në bazë të dokumentave të vëna në dispozicion nga UniBa dhe në bazë të takimeve të zhvilluara gjatë vizitës në institucion, konstaton se politikat e hartuara dhe procedurat e ndjekura dhe të zbatuara nga institucioni për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit janë në përmbushje të plotë të kuadrit ligjor në fuqi dhe standardeve të cilësisë.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>

<p><b>Standardi V.2</b>  <b>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.</p>	<p>Insitucioni publikon në web-in zyrtar informacionin lidhur me:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Programet e studimit që ofron në të dyja ciklet e studimit;</li> <li>• Kriteret e pranimit;</li> <li>• Lëndët, modulet dhe kreditet që përmban çdo program studimi, midis tyre edhe Master Profesional (120 ECTS)“ Mësuesi në Arte”</li> <li>• Kalendarin akademik për të dyja ciklet e studimit;</li> </ul> <p>Përmes një bookleti të përgatitur jepet informacion orientues për studimet në UniBa. Përmes koordinatores së departamentit dhe sekretarisë mësimore, studentët njihen me të gjithë dokumentacionin zyrtar dhe shërbimet në funksion të tyre.</p> <p><i>[Evidenca 3. Rregullore e Programit të studimit MPMA]</i></p>

<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjeshme.</p>	<p>UniBa pranon transferime të studentëve nga institucionet e tjera të arsimit të lartë, vendase ose të huaja, publike ose jopublike, gjithashtu lejon transferimin e studentëve të tij në institucione të tjera të arsimit të lartë. Studentët informohen në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjeshme përmes:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Rregullore e UniBa;</li> <li>• Rregullore e Njesisë Kryesore;</li> <li>• Rregullore e njesisë bazë</li> <li>• Rregullore e programit të studimit Master Profesional Mësuesi në Arte (MPMA)</li> <li>• Rregulloren e Transferimeve,</li> <li>• Manuali Rekrutim-Aplikim-Rregjistrim- Transferim, kreu VII</li> </ul> <p><i>[Evidenca 19. Rregullore për Transferimin dhe Regjistrimin në Programe të Dyta]</i></p> <p><i>[Evidenca 3. Rregullore e Programit]</i></p> <p><i>[Evidenca 18. Manual - Rekrutim-Aplikim-Regjistrim-Transferim]</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.</p>	<p>Kriteret dhe procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit, kriteret e shlyerjes së detyrimeve vjetore, e drejta për të hyrë në provim, zhvillimi i provimeve, komunikimi i vlerësimeve dokumentimi i vlerësimeve dhe pragu i kalimit të vitit akademik janë të përcaktuara në aktet e brendshme rregullatore të insitucionit:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Rregullore e UniBa;</li> <li>• Rregullore e Njesisë Kryesore;</li> <li>• Rregullore e Njesisë bazë</li> <li>• Rregullore e programit të studimit “Master profesional” në “Mësuesi në Arte”</li> <li>• Syllabuset e lëndëve</li> </ul> <p><i>[Evidenca 3. Rregullore e Programit te studimit]</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.</p>	<p>Kriteret e procedurat e diplomimit në programin e studimit Master Profesional “Mësuesi në Arte “ janë të përcaktuara në rregulloren e programit të studimit, si edhe në:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Rregullore e UniBa</li> <li>• Rregullore e Njesisë Kryesore</li> <li>• Rregullore e Njesisë bazë</li> <li>• Paketa e Provës Finale</li> </ul> <p>Paketa e provës finale cilëson të gjithë procedurat e provës finale dhe të temës së diplomës. Prova finale zhvillohet në trajtën e provimit të</p>

	<p>formimit dhe me punim diplome. Studentët me mesatare mbi 9.5 mund të përgatisin punim diplome.</p> <p><i>[Evidenca 3. Rregullore e Programit te studimit]</i></p> <p><i>[Evidenca 2.4. Fondi i pyetjeve provim formimi MPMA]</i></p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.</p>	<p>Çdo fillim viti akademik si edhe në mënyrë periodike gjatë vitit institucioni organizon një plan të detajuar rekrutimi e mbështetur nga një plan vjetor aktiviteteve, që synon të orientojë studentët potencial drejt programeve të studimit apo t’iu vijë në ndihmë studentëve të viteve të para që të njihen dhe takohen me studentët e tjerë të rinj, të familjarizohen me ambientet dhe infrastrukturën e Universitetit dhe të përgatiten për kryerjen e studimeve. Plani vjetor i aktiviteteve, përfshin konferenca me maturantët, konferenca me mësuesit e karrierës nëpër gjimnaze, vizita të stafit të UniBa në shkollat e mesme, konkurset, etj. Në fillim të vitit të ri akademik, UniBa zhvillon Javën e Orientimit, ku studentët marrin informacione të rëndësishme në lidhje me Universitetin, shërbimet mbështetëse, këshilla për programin e studimit dhe kursin, zhvillimin e aftësive akademike, shkëmbimet studentore përmes programeve Erasmus +, aktiviteteve, klubet dhe përfitimet e jetës studentore</p> <p>Studentët prezantohen me mjediset universitare (auditorë, sekretari, Biblioteka, shërbimet e IT-së etj.). Gjithashtu ata njihen me profesorët dhe kurset që studentët do të marrin gjatë vitit të parë, si dhe planprogramin e secilës lëndë. Studentëve u jepen informacione për sezonet e provimeve, metodat e vlerësimit, të drejtat dhe detyrimet e tyre.</p> <p><i>[Evidenca 49. Axhenda Java e orientimit të studentëve e vitit akademik 2023-2024]</i></p> <p><i>[Evidenca 41. Strategjia e marketingut dhe rekrutimit]</i></p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>GVJ në bazë të dokumentave të vëna në dispozicion nga UniBa dhe në bazë të takimeve të zhvilluara gjatë vizitës në institucion, konstaton se institucioni ka hartuar akte rregullatore dhe zhvillon praktika të mira lidhur me vënien në dispozicion të studentëve të informacionit të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në programin e studimit “Master profesional” “Mësuesi në Arte”</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p><b>X</b></p>

71

<b>Standardi V.3</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.	<p>Përmes Guidës së Studentit, studentët informohen rreth:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• strukturës organizative dhe autoritet vendimmarrëse në universitet, fakultet dhe departament dhe përgjegjësitë e secilit;</li> <li>• strukturat në ndihmë të studentit;</li> <li>• programet e studimit që ofron fakulteti/departamenti, kohëzgjatjen, organizimin e kursit të studimit, kreditet, kërkesat e përmbushjes së detyrimeve, sylabuset e lëndëve, orarin mësimor, etj;</li> </ul> <p>Institucioni ka hartuar një Udhëzues informacioni si; (fletëpalosje, postera, broshura etj., si dhe materiale audio-vizive, si: spote televizive, mesazhe promovionale, etj) që i vlejné studentëve edhe për t'u përgatitur për këshillimin e personalizuar në vazhdim dhe jo vetëm për integrimin e tij në UniBa.</p> <p>Gjatë vitit akademik koordinatori i departamentit jep orientime të nevojshme dhe të vazhdueshme për organizimin e programit të studimit studentor por gjithashtu studentët kanë shumë aktivitete ku ndërthuren projektet e iniciuara nga pedagogët, departamentet si dhe nga vetë studentët nëpërmjet klubeve studentore.</p>
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	<p>Guida e Studentit, Rregullorja e Programit të Studimit Master Profesional “Mësuesi në Arte”, Rregullorja e UniBa, Plani mësimor i programit të studimit dhe Syllabuset e Master Profesional “Mësuesi në Arte” janë dokumenta të prodhuara nga institucioni që vihen në dispozicion të studentëve me qëllim informimin për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese. Përmes web-it zyrtar të UniBa, studentët njihen me sezonet e provimeve, riprovimeve apo të mbartura. Komunikimi i brendshëm midis studentëve, pedagogëve dhe sekretarisë mësimore është i vazhdueshëm dhe dinamik.</p> <p><i>[Evidenca 2.6. Programet lëndore (Syllabuset)]</i></p> <p><i>[Evidenca 3. Rregullore e Programit të studimit]</i></p>
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.	<p>Zyra e Alumnit dhe Karrierës ka si funksion të saj parësor ofrimin e mundësive për vende pune, trajnime dhe praktika profesionale për studentët aktualë dhe ata që janë diplomuar UniBa. Kjo arrihet nëpërmjet vendosjes së kontakteve me ndërmarrje dhe organizata të ndryshme publike dhe private, të cilat veprojnë në tregun e punës. Udhëzuesi përgatitur nga kjo zyrë, u vjen në ndihmë studentëve dhe ish-studentëve në procesin e kërkimit dhe aplikimit për vende pune.</p>





	<p>UniBa ka marrëdhënie me 15 shkolla 9-vjeçare dhe 7 gjimnaze në Tiranë, gjithashtu edhe me Bashkinë Tiranë, që janë një tregues tjetër. UniBa bashkëpunon në projekte të ndryshme në fushën e edukimit, të miratuara nga MAS në Elbasan, Durrës, Shkodër, Peshkopi, Vlorë, Gjirokastrë, Korçë, Kavajë, Roskovec, etj. Informacioni dhe ushtrimet në të u vlejné studentëve edhe për t'u përgatitur për këshillimin e personalizuar nga punonjësit e Zyrës së Alumnit dhe Karrierës. e cila në bashkëpunim me njësitë e tjera zhvillojnë aktivitete dhe trajnime për të afruar studentët me tregun e punës. Në UniBa janë ngritur dhe funksionojné Bordet e Karrierës, në të cilat janë pjesë ekspertë dhe profesionistë të fushës dhe kanë për qëllim mbështetjen e studentëve në këtë proces.</p> <p><i>[Evidenca 22. Lista e marrëveshjeve të partneritetit në funksion të programit të studimit]</i></p> <p><i>[Evidenca 28. Vendim për krijimin e Bordit të Karrierës, DSHETP]</i></p> <p><i>[Evidenca 22.2. Raportim vjetor Alumni ]</i></p> <p><i>[Evidenca 22.1. Tabelë përmbledhëse për trajnimet profesionale me studentë]</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>Java e Orientimit synon t'iu vijë në ndihmë studentëve të viteve të para që të njihen dhe takohen me studentët e tjerë të rinj, të familjarizohen me ambientet dhe infrastrukturën e Universitetit dhe të përgatiten për kryerjen e studimeve. Gjatë kësaj jave, Koordinatori i Departamentit, Dekani i Studentëve dhe Sekretaria Mësimore mbajnë kontakte me studentët dhe ato marrin informacione të rëndësishme në lidhje me Universitetin, shërbimet mbështetëse, këshilla për programin e studimit dhe kursin, zhvillimin e aftësive akademike, shkëmbimet studentore përmes programeve Erasmus +, aktivitetet, klubet dhe përfitimet e jetës studentore. Java e Orientimit, konsiston në prezantimin e studentëve me ambientet universitare (auditorë, sekretari, Biblioteka, shërbimet e IT-së etj.). Gjithashtu ata njihen me profesorët dhe kurset që studentët do të marrin gjatë vitit të parë, si dhe planprogramin e secilës lëndë. Studentëve u jepen informacione për sezonet e provimeve, metodat e vlerësimit, të drejtat dhe detyrimet e tyre. Zyra Alumnit dhe Karrierës, është shumë aktive në çdo aktivitet ku studentët mund të këshillohen në lidhje me karrierën e tyre dhe të informohen për aktivitete të ndryshme studentore.</p> <p><i>[Evidenca 29.a Manual i mësimdhënies online]</i></p> <p><i>[Evidenca 29. Guidë instruktive e mësimi On-line]</i></p> <p><i>[Evidenca 36.a.Udhëzues për përdorimin e Strukturës së Teknologjisë së Informacionit, Aneks 4].</i></p>

<p><b>Kriteri 5.</b> Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.</p>	<p>Informacioni për kurrikulat, aktivitetet dhe kalendarin akademik publikohet edhe në web-in zyrtar të UniBa dhe janë publikisht të aksesueshme.</p> <p>Në platformën Google Classroom publikohen në fillim të çdo semestri programet lëndore, temat e lëndës, literatura, vlerësimi i dijeve, literatura e detyrueshme dhe ajo e rekomanduar. Studentët gjithashtu zotërojnë adresa personale të postës elektronike me domain @umb.edu.al</p> <p>Informacioni i detajuar, sipas viteve dhe semestrave, krediteve, etj. mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe është i publikua në faqen web.</p> <p><i>[Evidenca 29.a Manual i mësimdhënies online].</i></p> <p><i>[Evidenca 29. Guidë instruktive e mësimi On-line]</i></p> <p><i>[Evidenca 2.1.b. Plani mësimor Master Profesional në Mësuesi në Arte].</i></p> <p><i>[Evidenca 38.a. Udhëzues për përdorimin e Strukturës së Teknologjisë së Informacionit]</i></p> <p><i>[Evidenca 11. Udhëzues për metodat e mësimdhënies].</i></p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>GVJ në bazë të dokumentave të vëna në dispozicion nga UniBa dhe në bazë të takimeve të zhvilluara gjatë vizitës në institucion, konstaton se, UniBA disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit "Master profesional "Mësuesi në Arte" (MPMA)</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>

<p><b>Standardi V.4</b>  <b>Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit.</p>	<p>Universiteti "Barleti" disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit Master Profesional në " Mësuesi në Arte " përmes Sekretarisë Mësimore dhe Zyrës së "Alumnit dhe Karrierës" Ato, mbledhin, përpunojnë, ruajnë dhe paraqesin informacione statistikore. Nuk ka</p>

	<p>ende studentë të diplomuar në këtë program, por studentët aktual janë të gjithë të punësuar.</p> <p><i>Evidenca 26.2. Të dhëna të plota për regjistrimin, ecurinë, diplomimin e studentëve, sipas viteve akademike, nota mesatare në hyrje dhe në dalje]</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.</p>	<p>Universiteti “Barleti” disponon dokumentacion të plotë periodik në lidhje me statistikat vjetore të studentëve të regjistruar, klasifikimin e studentëve të rinj në programet e studimeve sipas gjinisë, grupmoshave dhe vendbanimeve, të diplomuar, të tërhequr apo të larguar para përfundimit të programit. Për këtë program studimi nuk ka studentë të diplomuar. Të regjistruar për dy vite akademike janë:</p> <p><i>2022-2023: 7 studentë</i>  <i>2023-2024: 2 studentë</i></p> <p><i>[Evidenca 26.1. Të dhëna të plota për regjistrimin, ecurinë, sipas viteve akademike, nota mesatare në hyrje dhe në dalje].</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p>	<p>Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen manualisht dhe elektronikisht nëpërmjet Sekretarisë Mësimore. Të gjitha proceset e ruajtjes dhe përpunimit të të dhënave personale nga UniBa bazohen në parimin e konfidencialitetit dhe në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi. Këto të dhëna statistikore janë lehtësisht të aksesueshme nga personat e autorizuar (student, pedagogë, drejtues institucioni, etj). Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik të dokumentacionit pranë Njësive bazë, Njësive kryesore dhe Sekretarive mësimore, vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.</p> <p><i>[Evidenca 36.e. Manuali i përdorimit të portalit Studentor për administrimin].</i>  <i>[Evidenca 36.a. Udhëzues për përdorimin e Strukturës së Teknologjisë së Informacionit]</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin</p>	<p>Institucioni ka hartuar akte lidhur me kontrollin periodik për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), si dhe vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse. Çdo</p>

<p>(sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.</p>	<p>student ka dosjen e tij, ku përmbahen të gjitha të dhënat për ecurinë e studimeve dhe rekordet e studentit. Portali studentor, është platforma ku gjenden të hedhura të dhënat mbi notat dhe lëndët e dhëna provim për cdo student.</p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike, mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.</p>	<p>UniBa bazuar në raportet vjetore të Njësive bazë dhe raportet vjetore të Fakulteteve, Sekretarinë mësimore, zyrës së Alumni dhe Karriera dhe Vlerësimit të Vazhduar, harton Raportin vjetor Institucional ku përfshihen veprimtaria mësimore dhe shkencore, ecuria e programeve të studimit, si dhe informacione për cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.</p> <p><i>[Evidenca 35. a. Plani Vjetor i punës së Departamentit të Shkencave të Edukimit dhe Trajnimit Profesional 2022-2023]</i>  <i>[Evidenca 35. Analiza Vjetore së Departamentit të Shkencave të Edukimit dhe Trajnimit Profesional 2022-2023]</i>  <i>[Evidenca 22.1. Tabelë përmbledhëse për trajnimet profesionale me studentët e MPMA]</i></p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>GVJ në bazë të dokumentave të vëna në dispozicion nga UniBa dhe në bazë të takimeve të zhvilluara gjatë vizitës në institucion, konstaton se institucioni mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre. Sistemi i follow up duhet të funksionojnë edhe në vazhdimësi.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

**Standardi V.5**





**Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.</p>	<p>Institucioni ka të rregulluar me akte përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.</p> <p>Institucioni është angazhuar në përfshirjen e studentëve në vendimmarrje përmes pjesëmarrjes së tyre në Senatin Akademik. Gjithashtu, pjesëmarrja e studentëve në grupet e vlerësimit të cilësisë është një tregues i përfshirjes dhe kontributit të tyre në sigurimin e cilësisë së punës së institucionit. Një nga strukturat e ngritura në institucion është edhe Këshilli Studentor. Studentët janë të përfaqësuar gjithashtu edhe në: Këshillin e Etikës dhe Shanseve të Barabarta; Komisionin e Sigurimit të Brendshëm të Standardeve të Cilësisë; Dekanatin e Fakultetit; si edhe Mbledhjet e departamenteve, një herë në muaj të hapura për studentët, etj.</p> <p><i>[Evidenca 1.1. Statuti i Universitetit Barleti]</i>  <i>[Evidenca 1.2. Rregullore e Universitetit Barleti].</i>  <i>[Evidenca 20. Rregullore e zyrave studentore]</i>  <i>[Evidenca 20.1. Rregullore e Organizimit të Zgjedhjeve për Qeverinë Studentore]</i>  <i>[Evidenca 20.2. Strategjia e Klubeve Studentore]</i>  <i>[Evidenca 20.3. Manual Klubet Studentore]</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	<p>Institucioni përmes akteve dhe veprimtarive konkrete garanton përfshirje reale, konkrete, frytdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme, të studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik. Sondazhi që bëhet nga Njësia e Zhvillimit Kurrikular dhe Cilësisë dy herë në vit mbledh të dhëna për secilën lëndë dhe secilin pedagog</p> <p>Institucioni raporton mbi aktivitetet vullnetare të studentëve të UniBa dhe publikon Kalendarin e Aktivitetet Studentore. Studentët organizohen lirisht në Këshillat Studentorë, institucionale dhe njësi kryesore. Studentët janë anëtarë të GVB për akreditimin institucional dhe të programeve të studimit.</p>



	<i>[Evidenca 20.4. Formular vlerësimi i studentëve për lëndën]</i> <i>[Evidenca 45a. Guida për fokus grupin].</i>			
<b>Kriteri 3.</b> Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.	Përmes anketës që Njësia e Zhvillimit të Kurrikulës dhe Cilësisë, kryen dy javë përpara mbarimit të çdo semestri, me secilin grup, në të gjitha programet e studimit, siguron që studentët të përfshihen në vlerësimin e cilësisë së: <ul style="list-style-type: none"> <li>• veprimtarisë akademike dhe shkencore të stafit akademik;</li> <li>• të infrastrukturës akademike dhe shkencore;</li> <li>• të komunikimit dhe marrëdhënieve;</li> <li>• aksesin në informacion për programet e studimit dhe aktivitetet që zhvillohen në institucion dhe jashtë tij;</li> <li>• metodat dhe mjetet e mësimdhënies;</li> <li>• ndihmën dhe mbështetjen e pedagogëve dhe të strukturave të tjera.</li> </ul> <b>[Evidenca 20.4. Formular vlerësimi i studentëve për lëndën]</b>			
<b>Kriteri 4.</b> Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.	Përmes instrumenteve matëse dhe vlerësuese të programit të studimit dhe të stafit akademik, studentët japin mendim mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.  <b>[Evidenca 1.2. Rregullore e Universitetit Barleti, neni 88].</b>			
<b>Konkluzione</b>	<i>GVJ në bazë të dokumentave të vëna në dispozicion nga UniBa dhe në bazë të takimeve të zhvilluara gjatë vizitës në institucion, konstaton se institucioni ka hartuar politika, akte rregullatore për përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe ka ngritur sistemin dhe strukturat përkatëse për të zbatuar përfshirjen dhe angazhimin e studentëve në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

**Standardi V.6**

**Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.</p>	<p>Zyra e Pranimit, Sekretaria Mësimore, Dekani i Studentëve, Zyra “Alumni dhe Karriera” dhe Departamenti, përmes koordinorit të tij, informojmë dhe mbështesin studentët për të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me procesin mësimor në Universiteti “Barleti”, si; shpërndarjen e informacionit për orientimin e aplikantëve dhe studentët e rinj, dhënien e informacioneve për programet, kurrikulat e studimeve, diplomat, këshillimin e studentëve të UniBa që diplomohen në nivelin e dytrë për mundësitë e studimeve në nivelet e tjera, këshillimin e studentëve për mundësitë e punësimit në tregun e brendshëm të punës në sektorin publik dhe privat, bashkëpunon ngushtë me njësitë bazë dhe kryesore për organizimin dhe vijueshmërinë e praktikave profesionale të studentëve, ofron për studentët trajnime, info day, takime të hapura etj.</p> <p><i>[Evidenca 20. Rregullore e Zyrave në Shërbim të Studentëve].</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.</p>	<p>Sistemi i komunikimit të brendshëm Sekretarisë Mësimore dhe Koordinatorit të Departamentit për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor, mundësojnë ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit. Ata mund t’i drejtohen Dekanit të Studentëve dhe Zyrës së “Alumnit dhe Karrierës”, për të marrë informacion dhe këshillim për aktivitete e shërbime mbështetëse brenda e jashtë UniBa</p> <p>Informimi i studentëve bëhet edhe nëpërmjet fazes zyrtare Web të Universitetit dhe njoftimeve në rrjetet sociale. Informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe mbështetjen e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit të realizohet nëpërmjet njësisë bazë</p> <p><i>Evidenca 20.Rregullore e Zyrave në Shërbim të Studentëve</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës</p>	<p>Dekani i Studentëve dhe Zyra “Alumni dhe Karriera” kanë si funksion të saj parësor ofrimin e mundësive për vende pune, trajnime dhe praktika profesionale për studentët aktualë dhe ata që janë diplomuar pranë UniBa. Kjo arrihet nëpërmjet vendosjes së kontakteve me ndërmarrje dhe organizata të ndryshme publike dhe</p>

<p>mirëprehet studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p>	<p>private, të cilat veprojnë në tregun e punës. Udhëzuesi përgatitur nga kjo zyrë, u vjen në ndihmë studentëve dhe ish-studentëve në procesin e kërkimit dhe aplikimit për vende pune. Informacioni dhe ushtrimet në të u vlejné studentëve edhe për t'u përgatitur për këshillimin e personalizuar nga punonjësit e Zyrës së "Alumni dhe Karriera".</p> <p>Nëpërmjet koordinatorit të departamentit dhe pedagogut të përcaktuar për të mbikëqyrur lëndën e praktikës profesionale, studentët orientohen për institucionet ku mund të zhvillojnë praktikën e tyre profesionale. Një ndër strukturat studentore që organizon studentët dhe zhvillon aktivitete lidhur me zhvillimin e karrierës është edhe <u>Klubi i Karrierës</u>.</p> <p><b><i>Evidenca 20.Rregullore e Zyrave në Shërbim të Studentëve</i></b></p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.</p>	<p>Zyra "Alumni dhe Karriera" duke përdorur formularë të dedikuar ka bërë gjurmimim e punësimit të studentëve që janë diplomuar në rang universiteti. Çdo vit, zyra "Alumni dhe Karriera" harton plane dhe raporte vjetore në lidhje me gjurmimin e studentëve</p> <p>Përfshirja e ish-studentëve të UniBa në jetën aktuale universitare realizohet nëpërmjet:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Eventeve dhe aktiviteteve që organizon UniBa;</li> <li>• Promovimit të alumni nëpërmjet programeve edukative, profesionale dhe sociale që ndodhin në UniBa;</li> <li>• Përfshirjes së alumni në programet e ndryshme universitare;</li> <li>• Sigurimi i kontakteve të vazhdueshme midis alumnit dhe UniBa</li> </ul> <p>Grupi Barleti ka një rrjet të gjerë strukturash në kërkim shkencor dhe në angazhimin e studentëve me punëdhënësit e ardhshëm si BTTC dhe AM-Barleti Human Capital.</p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>GVJ në bazë të dokumentave të vëna në dispozicion nga UniBa dhe në bazë të takimeve të zhvilluara gjatë vizitës në institucion, konstaton se institucioni ka hartuar dhe ndjek procedura dhe ka ngritur njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>



Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

## VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT

### Standardi VI.1

**Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.</p>	<p>Investimi në cilësinë e mësimdhënies është një përparësi e Universitetit, me qëllim që procesi i transferimit të dijeve të jetë gjithnjë e më i harmonizuar me njohuritë më të përparuara kombëtare dhe ndërkombëtare. Gjithashtu objektivi i rëndësishëm është edhe favorizimi i metodologjive të reja dhe mësimdhënia inovative, që e pozicionojnë studentin në qendër të procesit duke inkurajuar të menduarin kritik, përgatitjen për tregun e punës dhe promovimin e dialogut student-pedagog.</p> <p>UniBa harton udhëzues, manuale si “Rregullorja e funksionimit të Komisionit të Sigurimit të Standardeve të Cilësisë” dhe “Rregullorja e Njësisë së Zhvillimit Kurrikular dhe Cilësisë” si dhe kryen trajnime në nivel institucional, për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies. UniBa ka hartuar udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies. Bazuar në Rregulloren e Programit të Studimit dhe duke pasur parasysh natyrën e programit të studimit dhe specifikën e çdo lënde të tij, mësimdhënia përfshin përveç metodave didaktike tradicionale edhe metoda didaktike inovative, nëpërmjet përdorimit të teknologjive të informacionit dhe komunikimit në mësimdhënie.</p> <p>[Evidenca 16.2. Rregullore e Komisionit të Sigurimit të Standardeve të Cilësisë]  [Evidenca 16.2. Rregullore e Njësisë së Zhvillimit të Kurrikulave dhe Cilësisë]  [Evidenca 11. Udhëzues për metodat e mësimdhënies]  [Evidenca 38.a. Manuali i mësimdhënies online]</p>




	<p>[Evidenca 38.a. Guidë instruktive e mesimit On-line]</p> <p>[Evidenca 38.a. Udhëzues për përdorimin e strukturës së teknologjisë së informacionit UniBa]</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.</p>	<p>Cilësia e mësimdhënies dhe e stafit akademik monitorohet, matet dhe vlerësohet rregullisht përmes mekanizmave të tillë si pyetsori i vlerësimit të performancës së stafit akademik nga studentët dhe formulari i vetvlerësimit të performancës së personelit akademik. Njësia e Zhvillimit Kurrikular dhe Cilësisë (NjZhKC), Zëvendës Rektori për Çështjet Akademike, Zyra e Vlerësimit të Performancës dhe njësitë bazë bashkërendojnë punën e tyre në vazhdimësi për monitorimin, mbikëqyrjen dhe vlerësimin e mësimdhënies</p> <p>UniBa është përgjegjës për sigurimin e brendshëm të cilësisë në të gjitha njësitë përbërëse organizative. Për këtë funksionon Njësia e Zhvillimit Kurrikular dhe Cilësisë dhe Zyra e Vlerësimit të Performancës ka përgjegjësinë e zbatimit dhe përmirësimit të vazhdueshëm të sistemit të cilësisë në UniBa, mbështetur në Kodin e Cilësisë në Arsimin e Lartë si dhe standardet dhe udhëzimet evropiane për sigurimin e cilësisë në hapësirën Evropiane të Arsimit të lartë.</p> <p><i>[Evidenca 16.5. Formular vlerësimi të mësimdhënies kolegë me kolegë (peer evaluation of teaching)]</i></p> <p><i>[Evidenca 20.4. Formular vlerësimi i studentëve për lëndën]</i></p> <p><i>[Evidenca 14. Format i raportimit të punës semestrale]</i></p> <p><i>[Evidenca 12a. Rregullore për Vlerësimin dhe Administrimin e Performancës]</i></p> <p><i>[Evidenca 20.4. Formulari për transparencë të vlerësimit studentëve]</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimimeve.</p>	<p>Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimimeve përmes pyetsorëve anonimë që plotësohen 2 herë në vit. Ky proces zhvillohet nga Njësia e Zhvillimit Kurrikular dhe Cilësisë dhe Zyra e Vlerësimit të Performancës</p> <p><i>[Evidenca 40.4 Formular vlerësimi i studentëve për lëndën]</i></p> <p><i>[Evidenca 20.4. Raporti i vlerësimit të studentëve për vitin akademik 2022-2023, semestri i I]</i></p>



	<p><i>[Evidenca 20.4. Raporti i vlerësimit të studentëve për vitin akademik 2022-2023, semestri i II]</i></p> <p><i>[Evidenca 1.2. Rregullore e universitetit “Barleti”]</i></p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</p>	<p>UniBa i përmbahet Standardeve Europiane kryesore për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë. NjZHKC mbështetur në Statutin e UniBa hartojnë dhe bëjnë publike rezultatet e vlerësimit duke identifikuar pikat e forta dhe të dobëta, së bashku me rekomandimet përkatëse. UniBa nëpërmjet faqes zyrtare web pasqyron në mënyrë transparente dhe bën publike politikat, strategjinë, organizimin dhe veprimtaritë për studentët dhe të gjithë të interesuarit në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Njësia e Zhvillimit Kurrikular dhe Cilësisë dhe Zyra e Vlerësimit të Performancë harton raportin vjetor për vlerësimin e cilësisë në UniBa.</p> <p><i>[Evidenca 48.1. Raport vjetor për vlerësimin e cilësisë në UniBa]</i></p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p>	<p>UniBa, nëpërmjet strukturave të vlerësimit, promovon praktikat më të mira dhe nxit personelin akademik. Periudha e vlerësimit të performancës së stafit akademik zhvillohet në muajt Mars dhe Shtator që përkojnë edhe me përfundimin e semestrit.</p> <p>Vlerësimi i cilësisë së programeve të studimit sigurohet nëpërmjet të dhënave dhe treguesve të ndryshëm cilësorë dhe sasiorë të cilët analizohen dhe rishikohen nga stukturat e brendshme të sigurimit të cilësisë në shumë nivele.</p> <p>Rezultatet e monitorimit dhe vlerësimit bëhen të ditura përmes raportimeve të NjZHKC, njësive bazë dhe fakultetit.</p> <p><i>[Evidenca 12a. Rregullore për Vlerësimin dhe Administrimin e Performacës]</i></p> <p><i>[Evidenca 13.b. Shkëmbime të stafit Erasmus +]</i></p> <p><i>[Evidenca 51. Promovim i shembuj të praktikave të mira]</i></p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>GVJ në bazë të dokumentave të vëna në dispozicion nga UniBa dhe në bazë të takimeve të zhvilluara gjatë vizitës në institucion, konstaton se institucioni ka hartuar dhe ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies. Struktura përkatëse e sigurimit të cilësisë ka hartuar udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit dhe raporte monitorimi dhe vlerësimi.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

**Standardi VI.2**

**Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.</p>	<p>Sigurimi i brendshëm i cilësisë në UniBa mbështetet në akte të brendshme rregullatore që përcaktojnë politikat, strategjitë, strukturat dhe procedurat e procesit, bazuar në kuadrin ligjor në fuqi. Universiteti “Barleti”, mbështetur në Ligjin e Arsimit të Lartë Nr. 80/2015, Neni. 103, Institucioni ka hartuar politika si dhe ka ngritur struktura në funksion të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Në Universiteti “Barleti” funksionon Komisioni i Sigurimit të Standardeve dhe Cilësisë si edhe, struktura përgjegjëse për hartimin e politikave dhe procedurave për sigurimin e brendshëm të cilësisë, implementimit dhe përmirësimit të vazhdueshëm të sistemit të cilësisë në UniBa, mbështetur në standardet shtetërore të cilësisë (Kodin e cilësisë në arsimin e Lartë) dhe udhëzimeve Europiane për sigurimin e cilësisë në hapësirën Europiane të Arsimit të lartë.</p> <p>Në Statutin e UniBa <i>neni 10, neni 28, Rregulloren e UniBa neni 14, neni 15.</i> si dhe Rregulloren e Njësisë së Zhvillimit Kurrikular dhe Cilësisë, përcaktohen qartë politikat dhe procedurat për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale. Në UniBa është ngritur dhe funksionon edhe Komisioni i Vlerësimit të Performancës, i cili ka në fokus jo vetëm performancën e stafit akademik të UniBa-s <i>neni 15</i>, por dhe struktura përgjegjëse për realizimin dhe sigurimin e vazhdueshëm të cilësisë së mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe zhvillimin cilësor.</p> <p><i>[Evidenca 16.2. Rregullore e Komisionit të Sigurimit të Standarteve të Cilësisë]</i> <i>[Evidenca 16.2. Rregullore e Njësisë së Zhvillimit të Kurrikulave dhe Cilësisë]</i> <i>[Evidenca 1.1. Statuti i Universitetit Barleti]</i> <i>[Evidenca 1.2. Rregullore e universitetit “Barleti”]</i> <i>[Evidenca 17.1. Rregullore për Vlerësimin dhe Administrimin e Performacës]</i> <a href="https://umb.edu.al/sigurimi-i-cilesise.html">https://umb.edu.al/sigurimi-i-cilesise.html</a></p>





<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>Në UniBa është ngritur dhe funksionon sistemi i Sigurimit të Cilësisë, procesi i të cilit është detyrë dhe realizohet nga NjZhKC e cila bashkëpunon me Zyrën e Alumnit dhe Karrierës, Zyrën e Pranimeve, Dekanin e studentëve, njësitë bazë e kryesore.</p> <p>UniBa zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë dhe bashkëpunon me aktorë të ndryshëm ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm. Në bazë të Statutit të UniBa, për vlerësimin e brendshëm të programeve të studimit dhe kërkimit shkencor apo vlerësimin e brendshëm institucional, përfshihet një përfaqësues nga këshilli studentor i programit të studimit. Si pjesë e strategjisë institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, është edhe përfshirja e bashkëpunëtorëve dhe ekspertëve të jashtëm nëpërmjet marrëveshjeve të ndryshme të bashkëpunimit, aktiviteteve dhe eventeve të ndryshme të zhvilluara në bashkëpunim me maturanët, studentët dhe aktorë të tjerë nga tregu i punës, duke ndarë eksperiencat, duke u konsultuar dhe duke marrë parasysh propozimet e tyre. Në strategjinë UniBa 2020 - 2030 janë parashikuar objektivat lidhur me përmirësimin e cilësisë së proceseve akademike si: Punësimi i të diplomuarve, përmirësimi i kurrikulave dhe pasurimi i bibliotekës, mirëfunksionimi i strukturave të menaxhimit dhe organizimit në UniBA, ndërkombëtarizimi etj.</p> <p><i>[Evidenca 10. Strategjia e zhvillimit institucional 2020-2030]</i>  <i>[Evidenca 20. Rregullore e funksionimit të zyrave në shërbim të studentëve pranë UniBa]</i>  <i>[Evidenca 34. Marrëveshje Bashkëpunimi]</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që</p>	<p>Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit. Në funksion të sigurimit të cilësisë Universiteti “Barleti” përdor instrumentat për sigurimin e cilësisë si, riakreditimi institucional dhe ri/akreditimi i programeve të studimit bazuar në metodat e përcakturara nga ASCAL-i. UniBa i është nënshtruar një sërë procesesh riakreditimi institucional, i fundit është realizuar në vitin 2021, i cili ndiqte akreditimin e vitit 2017 nga Agjencia britanike, QAA, Bazuar në Statutin e Universitetit kryhet procesi i vazhdueshëm i monitorimit, vlerësimit dhe promovimit të cilësisë së veprimtarive mësimore dhe atyre kërkimore shkencore, ku organizohen pyetësorë studentorë për cilësinë e mësimdhënies në lëndët e çdo programi</p>




<p>promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.</p>	<p>studimi, realizon studime gjurmuese për të vlerësuar ecurinë e punësimit të studentëve. Programi i studimit Master Profesional “Mësuesi në Arte” (MPMA) nuk është akredituar asnjëherë që nga hapja e tij.</p> <p><i>[Evidenca 16.5. Formular vlerësimi të mësimitdhënies kolegë me kolegë (peer evaluation of teaching) ]</i></p> <p><i>[Evidenca 20.4. Formular vlerësimi i studentëve për lëndën]</i></p> <p><i>[Evidenca 20.4. Formulari për transparencë të vlerësimit studentëve]</i></p> <p><i>[Evidenca 20.4. Raporti i vlerësimit të studentëve për vitin akademik 2022-2023, semestri i I]</i></p> <p><i>[Evidenca 20.4. Raporti i vlerësimit të studentëve për vitin akademik 2022-2023, semestri i II]</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimitdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira në programin e studimit.</p>	<p>Vlerësimi i cilësisë së programeve të studimit sigurohet nëpërmjet:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- përcaktimit të kriterëve dhe afateve të hartimit, ristrukturimit dhe përmirësimit të programeve sipas përcaktimeve ligjore dhe nënligjore,</li> <li>- standardeve dhe kriterëve të cilësisë së programeve të studimit sic përcaktohen në kornizën europiane të sigurimit të cilësisë dhe kodit të cilësisë;</li> <li>- rregullores së studimeve për çdo program;</li> <li>- politikës së përzgjedhjes së teksteve universitare dhe aplikimit të teknologjisë mësimore bashkëkohore;</li> <li>- infrastrukturës mësimore;</li> <li>- ndërkombëtarizimit të programeve;</li> <li>- monitorimit, vlerësimit të brendshëm dhe akreditimit.</li> </ul> <p>Vlerësimi i cilësisë bëhet dhe raportohet mbështetur në standarde cilësie dhe indikatorë sasiorë të matshëm.</p> <p><i>[Evidenca 14. Format i raportimit të punës semestrale]</i></p> <p><i>[Evidenca 7. Manuali i Menaxhimit të Burimeve Njerëzore]</i></p> <p><i>[Evidenca 17.1. Rregullore për Vlerësimin dhe Administrimin e Performacës]</i></p> <p><i>[Evidenca 52. Raporti Vjetor UniBa 2022-2023]</i></p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>GVJ në bazë të dokumentave të vëna në dispozicion nga UniBa dhe në bazë të takimeve të zhvilluara gjatë vizitës në institucion, konstaton se UniBa ka hartuar dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së punës në</i></p>

	<i>institucion. Gjithashtu janë hartuar dokumenta që mbështeten në politikën dhe strategjinë e insitucionit për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi VI.3</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të dytë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim.</p> <p>Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p>	<p>Institucioni parashikon procese për hartimin dhe miratimin e programeve që ofron. Programet hartohen në mënyrë të tillë që të përmbushin objektivat dhe rezultatet e të nxënit. Diploma e dhënë për programin përputhet me nivelin e kornizës kombëtare dhe europiane të kualifikimeve. Institucioni monitoron dhe vlerëson periodikisht programet që ofron dhe garanton se janë përmbushur objektivat e tyre si dhe nevojat e studentëve dhe të shoqërisë. Këto vlerësime çojnë në përmirësimin e vazhdueshëm të programeve. Veprimet e ndërmarra si rezultat i vlerësimit dhe përmirësimit i komunikohen palëve të interesuara.</p> <p>Përmes përcaktimit të kriterëve dhe afateve të hartimit, ristrukturimit dhe përmirësimit si dhe standardeve dhe kriterëve të cilësisë së programeve të studimit, e një sërë procedurash e mekanizmash formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e vazhdueshme të programit të studimit të ciklit të dytë Master profesional “Mësuesi në Arte”, raportimeve për realizimin e programit, raportimeve për sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit, ngritjen e strukturave të sigurimit të brendshëm të cilësisë, etj. UniBa ka krijuar mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të dytë, që i shërbejnë akreditimit të tij.</p> <p><i>[Evidenca 16.2. Raport vjetor për vlerësimin e cilësisë në UniBa]</i> <i>[Evidenca 35. Raporti vjetor i departamentit për vitin akademik 2022-2023]</i></p>

	<p><i>[Evidenca 20.4. Raporti i vlerësimit të studentëve për vitin akademik 2022-2023, semestri i I]</i></p> <p><i>[Evidenca 20.4. Raporti i vlerësimit të studentëve për vitin akademik 2022-2023, semestri i II]</i></p> <p><i>[Evidenca 48.1. Raport vjetor për vlerësimin e cilësisë në UniBa]</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.</p>	<p>Raportet e vlerësimit që hartohen nga NjZhKC përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.</p> <p>NjZhKC harton raporte periodike lidhur me procesin e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, ku analizohen arritjet dhe mosarritjet, adresohen mangësitë dhe mënyrat e përmirësimit</p> <p><i>[Evidenca 16.2. Raport vjetor për vlerësimin e cilësisë në UniBa]</i></p> <p><i>[Evidenca 20.4. Raporti i vlerësimit të studentëve për vitin akademik 2022-2023, semestri i I]</i></p> <p><i>[Evidenca 20.4. Raporti i vlerësimit të studentëve për vitin akademik 2022-2023, semestri i II]</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testimet lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testimet ndërinstitucionale apo kombëtare, si: provimi i</p>	<p>Në të gjitha aktet e brendshme rregullatore institucionale dhe nga dokumentacioni i vënë në dispozicion nga njësia bazë, institucioni përdor metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testimet lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testimet ndërinstitucionale apo kombëtare, si provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera, me qëllim vlerësimin e realizimit dhe të garantimit të cilësisë së programit të studimit.</p> <p>UniBa aplikon metoda të drejtpërdrejta për vlerësimin dhe mbarëvajtjen e cilësisë në programin e studimit Mësuesi në Arte (MPMA) si: raportimi nga pedagogu për punën semestrale; vlerësim i studentëve në fund të çdo semestri nga NJZHKC; vëzhgime në auditor; rezultatet e provimeve, etj.</p> <p><i>[Evidenca 14. Format i raportimit të punës semestrale]</i></p> <p><i>[Evidenca 20.4. Formular vlerësimi i studenteve për lëndën]</i></p>





shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.	<p><i>[Evidenca 16.5. Formular vlerësimi të mësimeve kolegjë me kolegë]</i></p> <p><i>[Evidenca 2.5. Model Teza e provimit të lëndës]</i></p> <p><i>[Evidenca 14. Politika për të mësuarit, mësimeve dhe cilësinë në mësime]</i></p> <p><i>[Evidenca 2.5. Model Teza e provimit të lëndës]</i></p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program.</p>	<p>Siç është përcaktuar qartë në të gjitha aktet e brendshme rregullatore institucionale dhe siç evidentohet nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, UniBa përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: Sondazhe të studentëve që ndjekin programet e studimeve Sondazhe të studentëve që diplomohen; Sondazhe të Qeverisë studentore dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program me qëllim në vlerësimin e realizimit dhe garantimin e cilësisë së programit të studimit Master Profesional “Mësuesi në Arte (MPMA)”.</p> <p><i>[Evidenca 20.4. Raporti i vlerësimit të studentëve për vitin akademik 2022-2023, semestri i I]</i></p> <p><i>[Evidenca 20.4. Raporti i vlerësimit të studentëve për vitin akademik 2022-2023, semestri i II]</i></p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>GVJ në bazë të dokumentave të vëna në dispozicion nga UniBa dhe në bazë të takimeve të zhvilluara gjatë vizitës në institucion, konstaton se institucioni monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënësve. Raportet e arritjeve mbështeten mbi analiza SWOT.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>



<b>Standardi VI.4</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>UniBa parashikon dhe garanton në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</p> <p>Bazuar në statutin e Universitetit struktura përgjegjëse për realizimin dhe sigurimin e vazhdueshëm të cilësisë së mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe zhvillimit cilësor është Njësia e Zhvillimit Kurrikular dhe Cilësisë, si strukturë përgjegjëse për hartimin e politikave dhe procedurave për sigurimin e brendshëm të cilësisë, implementimit dhe përmirësimin të vazhdueshëm të sistemit të cilësisë, mbështetur në standardet shtetërore të cilësisë (Kodin e cilësisë në Arsimin e Lartë) dhe udhëzimeve Europiane për sigurimin e cilësisë në hapësirën Europiane të Arsimit të lartë.</p> <p>Njësia e Zhvillimit Kurrikular dhe Cilësisë mund të angazhojë periodikisht ekspertë të jashtëm për çështje specifike ose/dhe specialistë të nivelit të lartë të fushës së sigurimit të cilësisë sipas nevojës për konsulencë, ekspertizë ose për çështje të tjera. Për vlerësimin e brendshëm të programeve të studimit dhe kërkimit shkencor apo vlerësimin e brendshëm institucional ngrihet grupi i vlerësimit të brendshëm, ku merr pjesë edhe një përfaqësues nga këshilli studentor. Në rast nevojë ftohet një përfaqësues ekspert i jashtëm. Njëkohësisht për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, nga zyra e Alumnit dhe Karrierës realizon kontakte të vazhdueshme me studentët alumni mbi ecurinë në tregun e punës dhe është pjesëmarrëse dhe promovuese e programeve të studimit nëpër eventet e ndryshme të zhvilluar në bashkëpunim me maturantët, studentët dhe aktorë të tjerë nga tregu i punës, duke ndarë eksperiencat, konsultuar dhe marrë parasysh propozimet e tyre.</p> <p><i>[Evidenca 10. Strategjia e zhvillimit Institucional 2020-2030]</i>  <i>[Evidenca 16.2. Rregullore e Komisionit të Sigurimit të Standarteve dhe Cilësisë]</i></p>

	<p><i>[Evidenca 20.4. Rregullore e zyrave studentore dhe këshillimit të karrierës]</i></p> <p><i>[Evidenca 22.2. Plani Strategjik Alumni dhe Karriera 2020 – 2025]</i></p> <p><i>[Evidenca 34. Marrëveshje Bashkëpunimi]</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p>	<p>Universiteti "Barleti" përcakton qartë përgjegjësitë dhe detyrat konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave. Komisionit të Sigurimit të Standarteve dhe Cilësisë dhe Njësia e Zhvillimit Kurrikular dhe Cilësisë, kanë përgjegjësi dhe detyra të cilat specifikohen në Rregulloren e UniBa-s, Rregulloren e Komisionit të Sigurimit të Standardeve të Cilësisë, Rregulloren e Njësisë së Zhvillimit Kurrikular dhe Cilësisë, si dhe në planin e punës së njësisë. UniBa bazohet gjithashtu edhe tek indikatorët që përcillen nga njësitë. NjZhKC ka si indikatorë parësorë monitorimin semestral të respektimit të Kalendarit Akademik dhe vlerësimin e pedagogut. NjZhKC ka përgjegjësinë e menaxhimit në hartimin e programeve cilësore që plotësojnë nevojat e tregut të punës, vlerësimin dhe përmirësimin e cilësisë, akreditimin e programeve të studimit dhe institucionit.</p> <p><i>[Evidenca 1.2. Rregullore e Universitetit Barleti]</i></p> <p><i>[Evidenca 16.2. Rregullore e Njësisë së Zhvillimit të Kurrikulave dhe Cilësisë]</i></p> <p><i>[Evidenca 48. Plani i punës së Njësisë së Zhvillimit të Kurrikulave dhe Cilësisë]</i></p> <p><i>[Evidenca 15. Manuali i cilësisë]</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentëve të programit të studimit.</p>	<p>Statuti i UniBa përcakton përfshirjen e strukturave hierarkike të brendshme në procesin e sigurimit të cilësisë, midis tyre edhe njësisë bazë. Statuti garanton mbështetjen e procesit të sigurimit të cilësisë në parimin e transparencës dhe të gjithëpërfshirjes. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentëve e programit të studimit. Në Statutin e Universitetit është parashikuar dhe ngritja në nivel fakulteti e komisioneve e garantimit të cilësisë së njësisë kryesore dhe programeve të studimit me përfaqësues të personelit akademik dhe atij ndihmës administrativ me karakter mësimor dhe</p>

	<p>përfaqësues të studentëve. Njësia bazë është përgjegjës për programet studimit që ofron, si dhe sigurimin e brendshëm të cilësisë së këtyre programeve në bashkëpunim me të gjitha nivelet e strukturave përbërëse, kjo bazuar në mekanizmat e sigurimit të cilësisë dhe akteve rregullatore që institucioni ka të parashikuar.</p> <p><i>[Evidenca 1.4.f. Dërgohet urdhri i Rektorit Nr. 44 për GVB]</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</p>	<p>E gjithë baza rregullatore e UniBa garanton përfshirjen dhe aktivizimin e aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duke respektuar integritetin akademik, transparencën, shmangien e çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve, në përputhje me Kodin e Etikës</p> <p>Veprimtaria e UniBa me studentët dhe personelin mbështetet në meritat personale dhe përjashton çdo lloj diskriminimi” (Statuti UniBa-s, neni 3, pika 3)</p> <p><i>[Evidenca 1.1. Statuti i Universitetit Barleti]</i> <i>[Evidenca 33. Kodi i Etikës]</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vjera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.</p>	<p>Statuti UniBa, Rregullorja e Njësive Bazë për Funkcionimin dhe Organizimin e Sigurimit të Cilësisë dhe praktika e punës në institucion, sigurojnë pjesëmarrje aktive në proceset e vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, edhe të bashkëpunëtorëve dhe/ose ekspertëve të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vjera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.</p> <p>Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, janë edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vjera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj. Pjesëmarrja dhe promovimi i programeve të studimit nëpër eventet e ndryshme të zhvilluara nga Njësia Bazë në bashkëpunim me zyrën e Alumni, dhe në bashkëpunim me studentët dhe aktorë të tjerë nga tregu i punës u shërben studentëve për një qasje më të mirë ndaj tregut të punës si dhe për mundësi punësimi dhe internshipi.</p> <p><i>[Evidenca 34. Marrëveshje Bashkëpunimi]</i> <i>[Evidenca 28. Vendimi për ngritjen e Bordit të Karrierës]</i></p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>GVJ në bazë të dokumentave të vëna në dispozicion nga UniBa dhe në bazë të takimeve të zhvilluara gjatë vizitës në institucion, konstaton se institucioni përfshin njësitet akademike, personelin</i></p>



	<i>akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

### Standardi VI.5

**Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	Universiteti "Barleti" nëpërmjet faqes zyrtare web dhe programit të transparencës në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë bën publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit mekanizmat kontrollues dhe monitories si; Planet e veprimtarive akademike kërkimore shkencore vjetore, Raporte monitorimi për cilësinë e pogrameve të studimit, Raporte të vlerësimit të brëndshëm për akreditimin institucional, Raporte të vlerësimit të jashtem për akreditimin institucional, Raporte monitorimi të performancës në Universitet etj.  <a href="https://umb.edu.al/sigurimi-i-cilesise.html">https://umb.edu.al/sigurimi-i-cilesise.html</a> <a href="https://umb.edu.al/neës4901.html">https://umb.edu.al/neës4901.html</a>
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.	Universiteti " Barleti" në publikimin e rezultateve dhe vlerësimeve të programeve të studimit, respekton lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale. Raporti vjetor i NjZhKC, publikohet duke respektuar lirinë akademike dhe ruan etikën akademike  [Evidenca 48.1. Raport vjetor për vlerësimin e cilësisë në UniBa]
<b>Kriteri 3.</b> Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.	Rezultatet e vlerësimit adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara si dhe përmirësimin e veprimtarive mësimdhënëse dhe kërkimore shkencore të personelit akademik.  Raportet e vlerësimit që hartohen nga NjZhKC-ja përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe

	<p>përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.</p> <p>Njësia bazë harton raporte periodike lidhur me procesin e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, ku analizohen arritjet dhe mosarritjet, adresohen mangësitë dhe mënyrat e përmirësimit. Programi i studimit Master Profesional “Mësuesi në Arte” (MPMA) i është nënshtruar procesit të vlerësimit të brendshëm të cilësisë, ku midis të tjerave janë evidentuar edhe pikat e forta dhe të dobëta të tij si dhe janë dhënë rekomandime për përmirësim. Ky program nuk i është nënshtruar procesit të akreditimit.</p> <p><i>[Evidenca 48.1. Raport vjetor për vlerësimin e cilësisë në UniBa]</i>  <i>[Evidenca 20.4. Formular i vlerësimit të studentëve për lëndën]</i>  <i>[Evidenca 20.4. Raporti i vlerësimit të studentëve për vitin akademik 2022-2023, semestri i I]</i>  <i>[Evidenca 20.4. Raporti i vlerësimit të studentëve për vitin akademik 2022-2023, semestri i II]</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>NjZhKC-ja dhe njësia bazë vlerësojnë periodikisht rezultatet dhe kërkimet shkencore të UniBa, me synim përmirësimin e vazhdueshëm të tyre në të ardhmen. Edhe rekomandimet e lëna institucionit në kuadër të akreditimit institucional kanë shërbyer për përmirësimin e vazhdueshëm të tyre në të ardhmen.</p> <p>Njësia bazë dhe kryesore, mbështetur në informacionet e mbledhura mund të kërkojë ndryshim pas një cikli të plotë të programit të studimit: në fund të dy viteve për programet <i>Master profesional</i> me 120 ECTS, pas akreditimit të tyre dhe si rregull vetëm njëherë nga një akreditim në tjetrin.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>UniBa dhe Njësia e Zhvillimit Kurrikular dhe Cilësisë organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për t'i informuar në lidhje me sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programeve të studimit nëpërmjet takimeve të drejtpërdrejta me studentët në auditore, plotësimit të pyetësorëve, pjesëmarrjes në Sondazhe Kombëtare të studentëve, publikimit të njoftimeve në rrjetet sociale të Universitetit, njoftimeve në email- et zyrtare etj.</p> <p><a href="https://umb.edu.al/news4901.html">https://umb.edu.al/news4901.html</a>  <a href="https://umb.edu.al/news5125.html">https://umb.edu.al/news5125.html</a>  <a href="https://umb.edu.al/news5030.html">https://umb.edu.al/news5030.html</a></p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>GVJ në bazë të dokumentave të vëna në dispozicion nga UniBa dhe në bazë të takimeve të zhvilluara gjatë vizitës në institucion, konstaton se</i></p>

	<i>institucioni reflekton transparence dhe efektivitet në politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit duke i bërë ato publike me qëllim krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

**Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të dytë Master Profesional “Mësuesi në Arte” ofruar nga Universiteti “Barleti”**

**Pikat e forta dhe afirmime**

1. Universiteti “Barleti” ka infrastrukturë bashkëkohore në funksion të një mjedisi interaktiv të mësuarit dhe aftësimi profesional.
2. Universiteti “Barleti” ka politika të qarta dhe efektive të rritjes së partneriteteve dhe bashkëpunimit me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësimit profesional, praktikave profesionale dhe kërkimit shkencor.

**Pika të dobta**

1. Universiteti Barleti ka probleme serioze në plotësimin e standarteve minimale të stafit akademik për Departament në përputhje me legjislacionin në fuqi. Kjo për arsye se Departamenti i Shkencave të Edukimit dhe Trajnimit Profesional ka në përbërje të tij, në cilësinë e stafit akademik me kohë të plotë, 6 pedagogë, ndërkohë që në Ligjin 80/2015, Neni 25, përcaktohet se *departamenti duhet të ketë....të paktën shtatë anëtarë, të punësuar me kohë të plotë, si personel akademik.....nga të cilët të paktën tre me grada shkencore ose tituj akademik. (Standarti II.2. kriteri 1)*
2. Mungesa e mobilitetit të studentëve nga programi i studimit “Master Profesional” në “Mësuesi në Arte” drejt programeve të ngjashme në universitete jashtë vendit dhe anasjelltas. (standarti I.3. kriteri 3).
3. Mungesa e kriterëve që përcaktojnë profilin e diplomës së ciklit të parë për kandidatët aplikantë në programin e studimit Master Profesional në “Mësuesi në Arte” (Standarti II.7, kriteri 5, kriteri 6).
4. Mungesa e një një studimi tregu pune të mirëfilltë për programin e studimit (Standarti II.7, kriteri 4).
5. Numër shumë i ulët studentësh për çdo vit akademik (Standardi V.4,kriteri 2)

**Rekomandime**

- 1- Të plotësohet në mënyrë urgjente kriteri minimal për numrin e stafit akademik me kohë të plotë për Departamentin e Shkencave të Edukimit dhe Trajnimit Profesional.
- 2- Të përcaktohen në mënyrë eksplicite në kriteret e pranimit për programin e studimit profilet e diplomave të ciklit të parë për kandidatët aplikantë në programin e studimit “Master Profesional” në “Mësuesi në Arte”.



- 3- Hartimi i një studimi tregu pune të mirëfilltë për programin e studimit "Master Profesional" në "Mësuesi në Arte".
- 4- Të garantojë numrin minimal të studentëve për çdo vit akademik sipas dispozitave në fuqi për programin e studimit "Master Profesional" në "Mësuesi në Arte".
- 5- Institucioni të punojë më shumë në drejtim të nxitjes së mobilitetit të studentëve të programit të studimit "Master Profesional" në "Mësuesi në Arte", në mënyrë që të ketë tregues të studentëve përfitues nga programet e shkëmbimit.
- 6- Të përcaktohen në mënyrë eksplicite në kriteret e pranimit për programin e studimit profilet e diplomave të ciklit të parë për kandidatët aplikantë në programin e studimit "Master Profesional" në "Mësues në Arte".

**Conclusions of the Evaluation of the second cycle Master Professional study program "Teacher in Arts" offered by "Barleti" University**

**Strengths and Affirmations**

1. "Barleti" University has modern infrastructure in function of an interactive learning and professional training environment.
2. "Barleti" University has clear and effective policies of increasing partnerships and cooperation with institutions, companies, third parties, domestic and/or foreign business actors in order to realize the study program, within the professional training , professional practices and scientific research.

**Weak points**

1. Barleti University has serious problems in meeting the minimum standards of academic staff for the Department in accordance with the legislation in force. This is because the Department of Education Sciences and Vocational Training has in its composition, as full-time academic staff, 6 lecturers, while in Law 80/2015, Article 25, it is determined that the department must have... ..at least seven members, employed full-time, as academic staff.....of whom at least three hold scientific degrees or academic titles. **(Standard II.2. criterion 1)**
2. The lack of mobility of students from the study program "Professional Master" to "Teacher in Arts" to similar programs in universities abroad and vice versa. **(standard I.3. criterion 3).**




3. The lack of criteria that determine the profile of the first cycle diploma for applicants to the Professional Master study program in "Teacher in Arts" (Standard II.7, criterion 5, criterion 6).
4. Lack of a real labor market study for the study program (Standard II.7, criterion 4).
5. Very low number of students per academic year (Standard V.4,criterion 2)

## RECOMMENDATIONS

- 1- The minimum criterion for the number of full-time academic staff for the Department of Education Sciences and Vocational Training should be urgently fulfilled.
- 2- To define explicitly in the admission criteria for the study program the profiles of the first-cycle diplomas for applicants to the "Professional Master" study program in "Teacher in Arts".
- 3- Drafting a proper labor market study for the "Professional Master" study program in "Teacher in Arts".
- 4- To guarantee the minimum number of students for each academic year according to the provisions in force for the study program "Professional Master" in "Teacher in Arts".
- 5- The institution should work more towards promoting the mobility of students of the study program "Professional Master" in "Teacher in Arts", so that there are indicators of students benefiting from exchange programs.
- 6- To define explicitly in the admission criteria for the study program the profiles of the first cycle diplomas for the applicants in the study program "Professional Master" in "Teacher in Arts".



**Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit**

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
<b>I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT</b>				X
<b>II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË</b>			X	
<b>III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT</b>				X
<b>IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT</b>				X
<b>V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE</b>				X
<b>VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT</b>				X
<b>VLERËSIMI TËRËSOR</b>				X

